

# BIBLA KUR'ANI DHE SHKENCA

Dr. Maurice Bucaille  
Përktheu nga frëngjishtja  
Azra Begiç, Përktheu nga boshnjakishtja  
Nazim Juniku, ecc, Bashkëpunorë: Prof. Agim Jaka ,  
Përshtati: Nazim Juniku, ecc, Korrektor dhe lektor:  
Admir Banaj, Këshilltarë të përkthimit: Dr. Prof. Rasim  
Bejtullahu  
- Kur'ani dhe shkenca bashkëkohore, - Krijimi i qiejve  
dhe i tokës, - Astronomia në Kur'an, - Toka , - Bota  
bimore dhe shtazore, Prim. Dr. Sci. Med. Ali Iljazi, -  
Riprodhimi i njeriut në Kur'an. Tregimet e Kur'anit dhe  
të Biblës,- Kur'ani, hadithet dhe shkenca bashkëkohore.  
Mexhit Yvejsi: - Besëlidhja e vjetër. - Ungjijtë, -  
Origjinaliteti i Kur'anit

## KUSHTIM

Këtë përkthim ua kushtoj lexuesve shqiptarë të cilët e çmojnë lart urtësinë, arsimin dhe diturinë, studentëve, profesorëve, shkencëtarëve dhe intelektualëve të tjerë të sotëm dhe të ardhshëm duke mbajtur parasysht gjithnjë porosinë e Zotit të Gjithësisë nga Kur'ani famëlartë:

"Pasha kohën! Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt. Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri-tjetrin t'i përmbahen të vërtetës dhe që këshilluan njëri-tjetrin të jenë të durueshëm".

(El-

Asr, 1-3)

Ky libër meriton të botohet për shumë arsye. Është përkthyer dhe përshtatur në gjuhën shqipe me shumë kujdes, duke i qëndruar besnik nocioneve shkencore. Është kërkuar një punë e veçantë që me përpikmëri të zbatohen termat shkencore nga shumë fusha të shkencave nartyrore. Në këtë drejtim përkthyesi ja ka arritur plotësisht qëllimit. Stili i gjuhës së përkthimit është i lehtë dhe shumë i afërt për lexuesin dhe për këtë arsye libri fiton një vlerë të veçantë. Kështu një material shumë i ndërlikuar që trajtohet në këtë libër bëhet mjaft i qartë dhe i kuptueshëm për lexuesin.

Prof. Dr. Rasim Bejtullahu  
- Mësimdhënës i elektrodinamikës  
dhe astronomisë pranë FSHMN në Prishtinë.

## PARATHËNIE

Veprën "Bibla Kur'ani dhe shkenca" e ka shkruar shkencëtari Dr. Maurice Bucaille kirurgu dhe profesori i Universitetit të Parisit dhe bën fjalë për studimin e tij që ka bërë mbi Librat Hyjnorë, shikuar nga aspekti i njohurive shkencore bashkëkohore. Ky është një studim objektiv i liru nga çdo paragjykim lidhur me botëkuptimet që përmbajnë këto libra. Autori duke u përpjekur t'i korrigjojë qëndrimet jo të drejta të botës Perëndimore ndaj Kur'anit dhe Islamit, njëherazi bën thirrje për afrimin e Islamit dhe Krishtërit, ashtu siç e kishte filluar dhe Papa Shën Pali i VI, respektivisht rezoluta e Vatikanit e vitit 1970.

Shkencëtari në fjalë në këtë vepër nuk ka gjurmuar anën poetike dhe ligjore fetare, por është thelluar në thellësinë e Librave Hyjnorë (Biblës dhe Kur'anit) në dritën e zbulimeve shkencore bashkëkohore.

Dr. Maurice Bucaille, ose Mubarak Bucaille, si autor i kësaj vepre, pasi e studioi me objektivizëm të plotë ishte mahnitur me Kur'anin dhe ligjet e Islamit. Me qëllim të studimit sa më objektiv ai e mësoi gjuhën arabe burimore të Kur'anit dhe ishte habitur kur dalloi dëshmi të panumërta që rrjedhin nga Kur'ani mbi të gjitha dukuritë e Gjithësisë, dukuri të cilat i ka vërtetuar dhe po i vërteton për çdo ditë shkenca bashkëkohore.

Gjatë katërbëdhjetë shekujve, që nga koha e Shpalljes së Kur'anit famëlartë, e gjer më sot, Islami dhe vendosja e tij në rrjedhat bashkëkohore është paraqitur gabim. Paraqitja e Islamit dhe shpjegimi i Kur'anit në opinionin botëror është bërë në mënyrë sipërfaqësore dhe konservative, duke u shtrembëruar thelbi i tij, jo vetëm në Europë dhe Amerikë, por edhe në disa vende Islamike. Shtrembërimet e Islamit dhe të Kur'anit nga ana e Perëndimorëve, kishin për qëllim zhvlerësimin e realitetit të Kur'anit si Libër Hyjnor, duke e paraqitur në mënyrë jo objektive përmes metodave të pandershme, ndërsa në vendet Islamike si pasojë e mungesës së studimit dhe të zbatimit të mirëfilltë të Kur'anit. Për antiIslamin në Europë dhe Amerikë, autori në fjalë tha : "Gjykimet krejtësisht të gabuara mbi Islamin që janë përhapur dhe akoma përhapen në Perëndim janë pasojë e mosnjohjes së tij dhe shpifjeve sistematike. Por më e rënda nga të gjitha gënjeshttrat e përhapura janë të pavërtetat në raport me faktet, sepse nëse mashtrimet në gjykim janë të falshme, paraqitja e "fakteve" kundër të vërtetës nuk është e falshme... . Pikëpamjet shkencore mjaft të theksuara të Kur'anit, në fazën fillestare më kanë habitur thellë, sepse gjerë atëherë nuk kisha besuar se është e mundur që në një tekst të shkruar 14 shekuj më parë të gjejë aq dëshmi që u përkasin tematikave të shumëllojshme dhe absolutisht të mbështetura në indikacionet e shkencës bashkëkohore. Në fillim nuk kisha kurrëfarë besimi në Islam. Ju afrova këtij studimi të teksteve (Biblës dhe Kur'anit) pa asnjë paragjykim dhe me objektivitet të plotë... . Sikur shumica e njerëzve në Perëndim, dhe unë kam mundur t'i ruaj të njëjtat ide të gabuara dhe aq shumë të përhapura mbi Islamin deri në ditët tona. Kështu, pra, e pranoj se isha injorant i madh para se të krijoja për Islamin pikëpamje të cilat i

kam sot, të drejta dhe objektive. Nëse kam pasur pak ndikim apo kam hezituar në lidhje me Kur'anin, atëherë ka qenë ajo të cilën më kishin mësuar në rininë time; kurrë nuk më flisnin për muslimanët por vetëm për muhamedanët, duke e theksuar posaçërisht atë se është fjala për fenë të cilin e ka themeluar një njeri dhe një besim i cili nuk ka kurrëfarë vlere karshi Zotit... . Në asnjë rast nuk ekziston as më i vogli kundërshtim në mes tekstit kur'anor dhe njohurive shkencore bashkëkohore mbi krijimin e Gjithësisë. Unë e përsëris vlerësimin tim se qëndrimet shkencore të Kur'anit janë dëshmi se në tekstin e tij nuk është futur dora e njeriut, por ai tekst është Shpallje Hyjnore për të cilin s'ka dyshim".

Zoti i të gjitha botëve e porositi tërë njerëzimin me këto fjalë të shenjta që i gjejmë në Kur'anin famëlartë:

"Pra, Unë betohem në atë që e shihni !"

"Edhe në atë që nuk e shihni!"

"Se me të vërtetë ai (Kur'ani) është fjalë (e Zotit) që e lexon i dërguari i ndershëm (Muhammedi a.s.)"

"Ai (Kur'ani) nuk është fjalë e ndonjë poeti, po ju nuk besoni"

"Nuk as fjalë e ndonjë magjistari po ju nuk përkujtoheni."

"(Kur'ani) Është zbritje prej Zotit të botëve!"

"Sikur të trillonte ai (Muhammedi a.s.) për Ne ndonjë fjalë!"

"Ne do ta kapnim atë me fuqinë Tonë"

"E pastaj do t'ja këputnim atij arterien e zemrës."

"Dhe askush prej jush nuk do të mund të ndërhynte për mbrojtjen e tij."

(El-

Hakka, 38-41)

Zoti i botëve njeriun e krijoi në formën më të bukur dhe më të përsosur, duke e dalluar nga krijesat e tjera. Ju dha zgjuarsinë, vetëdijen dhe ndërgjegjen në mënyrë që ta zotërojë natyrën për nevojat e veta. Për këtë gjë njeriut i nevojitet dituria, arsimimi, dhe urtësia, duke bashkëpunuar me njëri-tjetrin në tërë rruzullin tokësor pa marrë parasysh si e quan ai veten: musliman apo i krishterë, europian apo amerikan, arab apo hebre. Ky bashkëpunim kërkon prej njerëzimit mirëkuptim, tolerancë, urtësi dhe dashuri, dhe jo persekutime, luftra, gjakderdhje, padrejtësi, varfëri, degjenerim moral dhe urrejtje shkatërrimtare.

Shkencëtari në fjalë e tha edhe këtë: "Në Islam feja dhe shkenca gjithnjë janë trajtuar si motra binjake... . Zbatimi i këtij parimi ka rezultuar me zhvillimin e hovshëm të shkencës me të cilën dhe vetë Perëndimi është frymëzuar (prej shek. VIII - XII erës sonë). Asgjë nuk është më qartë se mendimi i famshëm i Profetit (Muhammed a.s.:

"Kërkoje shkencën qoftë edhe në Kinë" përfundon autori.

Zoti Fuqplotë i tha mbarë njerëzimit :

"Nuk janë të barabartë i verbëri dhe ai që sheh"

"Po Allahut ia kanë frikën nga robërit e Tij, vetëm dijetarët".

(Fatir, 19,28)

Shkencëtari ateist i brumosur me dituri është më i paditur se i padituri që i beson Krijuesit të vet. Shkencëtari ateist me tërë diturinë e tij prodhon dhe ndërton mjete për shkatërrimin e njerëzimit, pra i shërben djallit për karrierizmin e tij, ndërsa besimtari nuk e ka atë forcë mendore të bëjë shkatërrimin e masës së gjerë. Duke

e pasur këtë parasysh autori thotë: "Sa më shumë të ecim përpara me zhvillimin e diturisë, posaçërisht të asaj që i përket pafundësisë së vogël, aq më të theksuara janë argumentet në favor të ekzistimit të Krijuesit. Por në vend se para fakteve ekzistuese njeriu të pendohet dhe të përulet, ai, përkundrazi, mburret me kryelartësi. Ai beson se është i autorizuar të përdhosë tërë popujt e botës, dhe të tallë çdo ide mbi Zotin, sikurse i nënçmon të gjitha ato vërejtje me të cilat ndeshet në rrugën e vet (djallëzore), nëse ato i janë pengesë në kënaqësitë e tij (shtazarake) dhe në dëshirën e tij për dëshmi. E këtillë është shoqëria materialiste, e cila tani është në përhapje të gjerë në Perëndim... . Një fitues i Çmimit "Nobel" për mjeksi në një libër dedikuar publiku të gjerë, ka paraqitur idenë se materia e gjallë rastësisht dhe vetvetiu është krijuar prej disa pjesëve përbërëse elementare, dhe se duke u nisur nga kjo materie e gjallë primitive, në ndikimin e rrethanave të ndryshme atmosferike, janë formuar gjallesa të ndryshme për të arritur gjer te tërësia e çuditshme e cila është njeriu". Vërtet ky fitues i Çmimit "Nobel", që i takon shoqërisë materialiste, nuk është hiç më tepër se "materie e gjallë primitive". Ja pra, ky është shkencëtari ateist!

Kur'ani si Libër Hyjnor zbriti për njerëzimin si mrekulli me hipotezat e përsosura të ligjeve të Gjithësisë për brezat e ardhshëm, që ta besojnë Kur'anin si fjalë absolute të Gjithëkrijuesit. Përndryshe Gjithëkrijuesi në Kur'an tërheq vërejtjen me këto fjalë :

"Ne do t'u bëjmë atyre të mundshme që të shohin argumentet Tona në horizonte dhe në veten e tyre derisa t'u bëhet e qartë se ai (Kur'ani) është i vërtetë..."

(Fussilet, 53)

Me këto fjalë Zoti i botëve sikur deshi të thotë se do t'i pajisë me dituri (posaçërisht shkencëtarët) duke ua treguar shenjat e Tij në horizonte, si argumente për ata që mendojnë thellë në zbulimin e fenomeneve të shumëllojshme, por duke mos qenë në gjendje të krijojnë as edhe një mizë. Me këtë Gjithëkrijuesi e provokoi gjithë njerëzimin deri në Ditën e Kijametit, duke porositur:

Shkenca, të cilën ju do ta adhuronit përveç Gjithëkrijuesit e në të cilën do të besoni, si edhe të gjithë ata që do të merren me të, nuk do të jenë në gjendje ta krijojnë as edhe një mizë edhe nëse për këtë qëllim bashkohen të gjithë shkencëtarët e mbarë botës në të gjitha epokat që do të vijjnë. Në Kur'an Gjithëkrijuesi la porosi këto fjalë të shenjta:

"...Vërtet ata që po i adhuronit në vend të All-llahut, ata nuk mund ta krijojnë asnjë mizë, edhe nëse tubohen të gjithë për të (krijimin e mizës)..."

(Haxh, 73)

Me të vërtetë njeriu është i pafuqishëm në krahasim me fuqinë absolute të Gjithëkrijuesit, sepse nuk është në gjendje ta krijojë qoftë edhe një mizë me një krah.

Studimi i Kur'anit famëlartë është studim shumëdisiplinor dhe enciklopedik, prandaj është e kuptueshme që gjatë shekujve të kaluar, komentues të ndryshëm të Kur'anit bënin gabime të pashmangshme në interpretimin e ajeteve kur'anore që kanë të bëjnë me shkencën, si pasojë e mos njohjes së shkencës. Në kohën bashkëkohore, me zhvillimin e njohurive shkencore u bë e mundshme që t'i përkthejmë dhe komentojmë me korrektësi e saktësi fragmentet e Kur'anit. Për kuptueshmërinë dhe domethënien e ajeteve që i përkasin shkencës bashkëkohore,

pëveç njohjes së thellë të gjuhës arabe, patjetër nevojitet dhe dituria universale shkencore. Dallimet në përkthimet e Kur'anit në mes përkthyesve janë të dukshme, si në pikëpamjen gjuhësore, ashtu dhe në pikëpamjen shkencore. Shpeshherë ka ndodhur të shtrembërohet porosia e vërtetë e fragmentit kur'anor, edhe pse përkthimet e përkthyesve patën dhe kanë vlerë kapitale për ta përkujtuar fjalën e Zotit.

Autori francez pohon se atë që e lexojmë sot në Bibël është befasuese dhe e habitshme, që para aq shumë kundërthënive dhe papajtushmërive, ekspertët e studimit të këtyre teksteve biblike, si dhe njohësit e argumenteve shkencore të Perëndimit, ose shtiren se nuk dinë për ato kundërthënie, ose i zbulojnë ato mangësi e provojnë t'i fshehin me ndihmën e akrobacive dialektike, pra formulave apologjetike. Prandaj një vlerë e posaçme e veprës "Bibla, Kur'ani dhe shkenca" është ajo me të cilën autori bën thirrje për mbarë njerëzimin e botës, pa dallim feje qofshin ata muslimanë, të krishterë apo hebrej për bashkëpunim. Nga ana tjetër ju bën thirrje dhe shkencëtarëve të mbarë botës që të heqin dorë nga rruga materialiste që është fatale për shoqërinë dhe njerëzimin në përgjithësi.

Kjo vepër është studim objektiv i Librave Hyjnorë, pra i Biblës dhe Kur'anit, me ndihmën e treguesve të shkencës bashkëkohore me qëllim që të kërkohet vërtetësia e Biblës dhe e Kur'anit, por njëherazi dhe të bëhet ndarja e asaj që i takon Shpalljes Hyjnore nga ajo që është prodhim i njerëzimit.

Vepra "Bibla, Kur'ani dhe shkenca" paraqet për të gjithë besimtarët e Zotit Fuqiplotë përjetimin e mendimtarit të Perëndimit, si shkencëtar i mjekësisë. Në kohën tonë, duket se po ndodhin ndryshime të mëdha në nivelin më të lartë të botës së krishterë në favor të unitetit me muslimanët. Dokumenti i Vatikanit i vitit 1970 "Orientimi për dialog në mes krishterëve dhe muslimanëve" i lëshuar pas Këshillit të Dytë të Vatikanit, dëshmoi ndryshimin thelbësor të opinionit për muslimanët. Ky dokument në formë të rezolutës e mori përgjegjësinë e pranimit që i është bërë Islamit në të kaluarën me mesazh të qartë: "të lirohemi nga paragjykimet ndaj Islamit."

Motivi më i fuqishëm që më shtyu ta bëj përkthimin e shkencëtarit francez Maurice Bucaille "Bibla, Kur'ani dhe shkenca" ishte pa dyshim dëshira ime e flaktë që edhe lexuesit shqiptar, të kenë një libër të tillë në gjuhën shqipe.

Në fund po e përmendim kontributin e çmueshëm të atyre që na ndihmuan në realizimin e këtij përkthimi të kësaj vepre kapitale në rradhë të parë Prof. Dr. Rasim Bejtullahut, pastaj Prim. Dr. Sci. Med. Ali Iliazi, Mexhit Yveysit dhe Prof. Agim Jakës. Kontributi i tyre ndikoi në ngritjen e nivelit të cilësisë së përkthimit si në pamjen shkencore, teologjike dhe atë gjuhësore.

Përkthyesi

Nazim

Juniku

## HYRJE

Secili nga të tri besimet monoteiste e ka përmbledhjen e vet të Librave të Shenjtë. Këto dokumenta janë baza e besimit të çdo besimtari, qoftë ai hebre, i krishterë apo musliman. Për secilin prej tyre ato janë përkthim i drejtpërdrejt material i Shpalljes së Zotit, si në rastin e Abrahamit (Ibrahimit a.s.) ose të Moisiut (Musait a.s.), të cilët i morën urdhërat nga vetë Zoti ose të tërthorta, si në rastin e Jezusit (Isait a.s.) dhe të Muhammedit a.s.: i pari deklaroi se flet në emër të Atit, kurse i dyti u transmeton njerëzve Shpalljen që e ka marrë nëpërmjet Kryeengjellit Xhibrilit.

Marrja në shqyrtim e të dhënave objektive nga historia e fesë na detyron që t'i vëmë në shkallë të njëjtë Besëlidhjen e Vjetër, Ungjijtë dhe Kur'anin, si përmbledhje të Shpalljes së shkruar. Por, ky qëndrim, të cilin parimisht e mbajnë muslimanët, nuk pranohet nga besimtarët e vendeve tona Perëndimore, tek të cilët mbizotëron ndikimi judeo-krishterë; ata nuk pranojnë ti japin Kur'anit cilësinë e Librit të shpallur.

Këto qëndrime shpjegohen nga mendimet që kanë secila nga bashkësitë e besimtarëve ndaj dy të tjerave lidhur me Librat.

Judaizmi ka për libër të shenjtë Biblën hebraike. Ajo dallohet nga Besëlidhja e Vjetër e krishterë për aq sa kësaj i janë shtuar disa libra që nuk kanë ekzistuar në hebraishte. Në praktikë, kjo mosmarrëveshje nuk i sjell kurrëfarë ndryshimesh doktrinës. Por Judaizmi nuk e pranon asnjë shpallje që ka ardhur pas të tijës.

Sa i përket krishtërit, ai e ka huazuar Biblën hebraike me disa shtojca, por nuk i ka pranuar të gjitha shkrimet e shpallura në mënyrë që njerëzimi të njëjtojë me misionin e Jezusit (Isait a.s.). Kisha e tij i bëri disa shkurtime tepër të rëndësishme në atë shumësi librash që tregojnë jetën dhe doktrinën e Jezusit (Isait a.s.). Ajo në Besëlidhjen e Re ka ruajtur vetëm një numër të kufizuar të shkrimeve, ndër të cilat më të rëndësishme janë katër Ungjijtë e kanonizuar. Krishtërimi nuk merr parasysh kurrëfarë shpallje që ka ardhur pas Jezusit (Isait a.s.) dhe apostujve të tij. Domethënë, ai me këtë eliminon Kur'anin.

E zbritur gjashtë shekuj pas Jezusit (Isait a.s.), Shpallja e Kur'anit huazon shumë të dhëna nga Bibla hebraike dhe nga Ungjijtë, me që shpesh e citon "Teuratin"<sup>2</sup> dhe "Inxhilin"<sup>3</sup>.

Kur'ani urdhëron çdo musliman që të besojë në çdo Libër të shpallur para tij (Surja En Nisaë, Ajeti 136). Ai e vë theksin mbi vendin që zënë të dërguarit e Zotit në historinë e Shpalljes, siç janë Noa (Nuhu a.s.), Abrahami (Ibrahimi a.s.), Moisiu (Musai a.s.), profetët (të dërguarit) dhe Jezusi (Isai a.s.), i cili zë vend të posaçëm ndër paraardhësit. Lindja e tij është treguar në Kur'an si dhe në Ungjijtë:

si ngjarje e mrekullueshme. Libri i bën nderime të jashtëzakonshme Maries (Merjemes): po surja numër 19 a nuk mban emrin e saj?

Duhet të konstatojmë se këto të dhënat e fundit që i përkasin Islamit përgjithësisht nuk janë të njohura në vendet tona Perëndimore. Por a duhet të çuditemi me këtë, kur e dimë se si janë edukuar brezat lidhur me problemet e fesë së njerëzimit dhe në ç'terr janë mbajtur në krahasim me tërë atë që ka të bëjë me Islamin. Po përdorimi i emërimit "besimi Muhamedan" dhe "Muhamedanët" a nuk është përkrahur deri sot, në mënyrë që në shpirtat e tyre të ruhet bindja e shtrembër se fjala është për besimet e përhapura nëpërmjet veprës së një njeriu e në të cilat, Zoti, (ashtu siç e kuptojnë të krishterët) nuk mund të ketë kurrëfarë pjesëmarrje. Shumë nga bashkohësit tanë të ngritur janë të interesuar për aspektet filozofike, sociale dhe politike të Islamit, por kurrë nuk kanë pyetur - siç do të duhej pyetur - lidhur me Shpalljen Islame në kuptimin e vërtetë të fjalës. Merret si parim se Muhammedi a.s. është bazuar në atë që i ka paraprirë, në mënyrë që kështu pikë së pari, të eliminohet vetë problemi i Shpalljes.

Në fund të fundit, çfarë urrejtje shprehin ndaj muslimanëve disa mese të krishtera! Kam pasur rastin ta përjetoj vetë këtë kur kam bërë përpjekje ta filloj dialogun mbi studimin krahasues të tregimeve biblike dhe kur'anore, që bëjnë fjalë për të njëjtën temë, dhe të vërtetojë mospranimin sistematik thjesht vetëm për arsye se për këtë qëllim është marrë parasysh ajo që përmban Kur'anin lidhur me temën e shqyrtuar. Kjo i ngjan asaj që kur e citojmë Kur'anin sikur i drejtohem drejt!

Por, duket se më në fund, në kohën tonë po ndodhin ndryshime në nivelin më të lartë të botës së krishterë. Një dokument i Sekretariatit të Vatikanit për jokrishterët, i botuar pas mbledhjes të Këshillit të Dytë të Vatikanit, "Orientimet për dialog ndërmjet të krishterëve dhe muslimanëve", botimi i tretë i të cilit është bërë në vitin 1970, dëshmon për thellësinë e ndryshimeve të qëndrimeve zyrtare. Pasi bënë thirrje për eliminimin e "pasqyrës së vjetëruar të trashëguar nga e kaluara ose të shtrembëruar nga paragjykitime dhe sharje", që të krishterët e kanë krijuar për Islamin, dokumenti i Vatikanit merr përsipër detyrimin të "pranojë padrejtësitë e së kaluarës, për të cilat Perëndimi i edukimit të krishterë është fajtor ndaj muslimanëve". Ai kritikon përfytyrimet e gabuara që kanë të krishterët për fatalizmin musliman, për të drejtën Islame, për fanatizmin e tij etj. Shpreh njësinë e besimit në Zot dhe rikujton deri në ç'masë Kardinal Koenigu i befasojë dëgjuesit e vet në Xhaminë e Madhe duke shpallur gjatë një konference zyrtare në Universitetin "Al Azhar", në muajin Mars të vitit 1969. Ai gjithashtu sjell ndërmend atë se Sekretariati i Vatikanit, në vitin 1967, u bënë thirrje të krishterëve që t'ju shprehin dëshirat e tyre të mira muslimanëve në rastin e agjërimit të Ramazanit, kësaj "vlere fetare origjinale".

Këtë nismë që zuri të bëjë afrimin e Kurisë së Romës dhe Islamit e konkretizuan manifestime dhe takime të ndryshme që pasuan. Por, për këto ngjarje shumë të rëndësishme që u zhvilluan në botën Perëndimore u njoftua vetëm një numër i vogël i njerëzve, edhe pse nuk munguan mjetet e informacionit : shtypi, radio dhe televizioni.

Gazetat i bënë vetëm pak vend vizitës zyrtare të kardinal Pignedolit, krytar i Sekretariatit të Vatikanit për jokrishterët që ja bëri mbretit të Arabisë Saudite, Fejsalit, më 24 prill 1974. Revista "Le Monde", e datës 25 prill 1974, solli vetëm

një raport me disa rreshta. Por, përsëri, ky është lajm i rëndësishëm kur lexohet se kardinali ia transmetoi sovranit porosinë e Papës Palit VI, në të cilën ky i fundit shpreh "konsideratën e Shenjtërisë së Tij për Shkëlqesisë e Tij, Fejsalin, në cilësinë e autoritetit suprem të botës Islame, i nxitur nga besimi i thellë në bashkimin e botës Islame dhe të krishtere që e adhurojnë një Zot".

Gjashtë muaj më vonë, në muajin tetor 1974, Papa, priti zyrtarisht në Vatikan dijetarët nga Arabia Saudite. Ishte ky një rast për një seminar ndërmjet të krishterëve dhe muslimanëve lidhur me "të drejtat kulturore të njeriut në Islam". Gazeta e Vatikanit, "L'osservatore Romano", të 26 tetorit 1974, solli raportin lidhur me këtë ngjarje në faqen e parë duke i dhënë vend më shumë se raportit mbi ditën e mbylljes së Sinodit Ipushkvor në Romë.

Dijetarët e mëdhenj nga Arabia i priti edhe Këshilli Ekumenik i Kishave në Gjenovë dhe monsinjor Elchinger, Ipushkvi i Strasburgut. Ipushkvi i thirri dijetarët ta falin namazin e drekës para tij, në katedralen e tij. Kjo u bë më tepër për anën e vet spektakolare, se sa për rëndësinë fetare që ka pasur. Ndër ata që i kam pyetur, shumë pak prej tyre kanë thënë se i dinë këto ngjarje.

Frymëzimi i Papës Palit VI për hapje ndaj Islamit, i cili për vete ka thënë se është "i nxitur nga besimi i thellë në bashkimin e botës Islamike dhe të krishterë, që adhurojnë një Zot", në të vërtetë do të shënoj datën e marrëdhënies mes dy besimeve. Kjo thirrje e kryetarit të Kishës katolike për ndjesi ndaj muslimanëve më është dukur e domosdoshme, sepse ka aq shumë të krishterë të edukuar në frymë të theksuar armiqësie - siç u ankua dokumenti i Vatikanit, i përmendur më sipër - të cilët parimisht kanë disponim armiqësor ndaj çdo mendimi për Islamin: mbi këtë bazë, ata e injorojnë gjendjen e vërtetë të çështjes, kurse për Shpalljen kur'anore kanë pikëpamje plotësisht të gabuara.

Sido që të jetë, kur studiohet ndonjë aspekt i një besimi monoteist, është krejt e arsyeshme që këtë ta bëjnë me ndihmën e krahasimit ta asaj që dy besimet e tjera ofrojnë nga po ajo pikëpamje. Studimi i plotë i një problemi është me interes më të madh se studimi i pjesshëm. Konfrontimi i disa temave me të arriturat e shkencës së shekullit XX, që janë trajtuar në shkrime, i intereson të tri besimeve pa përjashtim. Pastaj, a thua ato nuk e përbëjnë, apo nuk do të duhej ta përbënin një bllok më kompakt duke u afruar mes veti, kur të gjithëve, në kohën tonë, na kërcënohet vërshimi i materializmit.

Edhe në vendet nën ndikimin judeo-krishterë, sikurse edhe në vendet Islamike, mbështetet ideja - veçanërisht në rrethet shkencore - se besimi dhe shkenca janë të papajtueshme. Për ta shqyrtuar këtë çështje në tërësinë e saj do të na duhet të bëjmë shpjegime të gjera. Unë këtu do të shqyrtoj vetëm një aspekt të kësaj teme: mbi shqyrtimin e vet Shkrimeve në dritën e njohurive shkencore bashkëkohore.

Ky qëllim të detyron që më parë të shtrohet një pyetje themelore: çfarë është origjinaliteti i teksteve që kemi sot? Kjo pyetje implikon studimin e rrethanave që kanë shtyrë të bëhet redaktimi i teksteve dhe transmetimi i tyre deri sot.

Studimi i shkrimeve në formë të kritikës së teksteve në vendet tona kanë filluar vonë. Përsa i përket Biblës, Besëlidhjes së Vjetër dhe Besëlidhjes së Re, kanë kaluar shumë shekuj gjatë të cilëve njerëzit janë kënaqur me atë që t'i pranojnë ashtu siç janë. Leximi i tyre ka qenë një rast vetëm për shqyrtime apologjetike. Do të konsiderohej mëkat sikur të thuhej edhe më i vogli mendim kritik lidhur me to.



Meshtarët kanë qenë të privilegjuar sepse kanë mundur të njohin lehtë në tërësi. Shumica e laikëve kanë marrë vetëm pjesë të zgjedhura në ceremonitë liturgjike ose gjatë predikimit.

E organizuar si profesion, kritika e teksteve ka meritë që ka zbuluar dhe ka publikuar shpesh probleme shumë të mprehta që dalin. Por, sa zhgënjuese është literatura e atë veprave që shpallen si kritike, por, - para vështirësive shumë reale të interpretimit - ato ofrojnë vetëm fjalime apologjetike, qëllimi i të cilave është të mbulojnë hutinë e autorit. Nën këto kushte, për atë që e ruan të paprekshme aftësinë e vet të menduarit dhe dëshirën e vet për objektivitet, mungesa e vërtetësisë dhe kundërthëniet për këtë arsye nuk janë më pak të qëndrueshme dhe vetëm mund të ankohehi kundër qëndrimit qëllimi i të cilit, kundër çdo llogjike, arsyeton ruajtjen në Bibël të disa fragmenteve përplot me gabime. Ai mund të jetë skajshmërisht i dëmshëm për besimin në Zot të disa shpirtra të ngritur. Përsëri, përvoja vërteton se nëqoftë se disa janë të aftë të zbulojnë mangësitë e këtij lloji, shumica dërrmuese e të krishterëve kurrë nuk e ka kuptuar se ato ekzistojnë, dhe me njohuri profane, të cilat, me të vërtetë janë shpesh krejt elementare ka vazhduar të jetojë duke mos ditur se ekzistojnë këto kundërthënie.

Islami në hadithe ka barazvlerësimin e vet në Ungjijtë. Hadithet janë përmbledhje në të cilat janë shënuar veprat e Muhammedit a.s. Ungjijtë nuk janë asgjë tjetër për Jezusin (Isain a.s.). Përmbledhjet e para të haditheve janë shkruar me dhjetra vjet pas vdekjes së Muhammedi a.s., ashtu siç janë shkruar edhe Ungjijtë dhjetra vjet pas Jezusit (Isait a.s.). Në të dy rastet, këto janë dëshmi të njerëzve mbi ngjarjet e së kaluarës. Përkundër asaj çfarë mendon shumica, më vonë do të shohim se autorët e katër Ungjijve kanonikë nuk janë dëshmitarë të ngjarjeve për të cilat tregojnë. Po kjo vlen edhe për përmbledhjet më serioze të haditheve.

Krahasimi patjetër duhet të ndalet këtu, sepse, nëse është diskutuar dhe akoma vazhdon të diskutohen mbi origjinalitetin e këtij apo atij hadithi, me këtë përfundimisht largohemi nga shekujt e parë të kishës, e cila ndër shumë Ungjij vetëm katër prej tyre i pranoi si zyrtarë ose kanonikë<sup>4</sup>, përkundër mospajtimeve të shumta ndërmjet vetes për shumë çështje, dhe dha urdhër që të gjithë të tjerët të fshihen, prej nga rrjedh edhe emri i tyre: apokrifë.

Ndryshim tjetër themelor ndërmjet krishtëritit dhe Islamit, në pikëpamje të Shkrimeve, është: te i pari mungesa e një teksti të shpallur dhe njëherazi të ndryshueshëm, kurse tek tjetri ka Kur'anin, që i përgjigjet këtij përkufizimi.

Kur'ani është shprehje e Shpalljes të cilën Kryeëngjëlli, Xhibrili, ja transmetoi dhe besimtarët menjëherë e përshkruan, e mësuan përmendësh dhe e kënduan në kohën e faljeve, e sidomos gjatë muajit ramazan. Atë vet Muhammedi a.s. e ka ndarë në sure e këto janë përmbledhur menjëherë mbas vdekjes së të dërguarit, në mënyrë që në kohën e Khalifit Osman (12 - 24 vjet më pas) e formuan tekstin që e kemi dhe sot. Përkundër asaj që është bërë në Islam, Shpallja e krishterë është bazuar në dëshmi të shumta dhe indirekte të njerëzve, meqë nuk e kemi asnjë dëshmi që do të vinte nga dëshmitari i vërtetë i jetës së Jezusit (Isait a.s.), përkundër asaj çfarë e merr me mend shumica e të krishterëve. Kështu është shtruar gjysma e dytë e vitit të krishterë kalendarik 1975 i përgjigjet vitit 5736 të krijimit të Botës. Njeriu, krijimi i të cilit ka pasur disa ditë vonesë, domethënë ka moshë të njëjtë të shprehur me numrat e viteve sipas kalendarit hebraik.

Në të vërtetë, është mirë të bëhet korrigjimi për shkak të logaritjes së kohës që fillimisht është shprehur me vitet hënore, kurse kalendari perendimor e ka llogaritur duke u mbështetur në kalendarin diellor. Por, korrigjimi prej 3%, që do të duhej bërë po të dëshironim të jemi absolutisht të saktë, është pak i rëndësishëm. Që të mos i komplikojmë llogaritë, është mirë mos ta bëjmë këtë. Këtu qenësore është lloji i madhësisë dhe është pak e rëndësishme nëse numri i viteve të një mileniumi është llogaritur me mundësi për të gabuar deri tridhjetë vjet. Për të qenë më afër së vërtetës, do të themi se sipas këtij vlersimi hebraik, krijimi i Botës vendoset tridhjetë e shtatë shekuj para erës sonë.

Çfarë na mëson shkenca bashkëkohore? Do të ishte vështirë të përgjigjemi në këtë pyetje kur bëhet fjalë për krijimin e Gjithësisë. Krejt ajo që do të mund të shprehej me numra është epoka e formimit të sistemit diellor që do të mund të vendosej me vërtetësi të kënaqshme. Koha që na ndan nga ajo, vlerësohet në katër miliard e gjysëm vjet. Domethënë, mund të vlersohet skaji që sot ndan realitetin e përcaktuar mirë (mbi të cilin do të flitet në pjesë e tretë të këtij libri) nga të dhënat e nxjerra nga Besëlidhja e Vjetër. Ato dalin nga shqyrtimi tepër i hollësishëm i tekstit biblik. Zanafilla jep indikacione shumë të sakta me kohën që ka kaluar prej Adamit deri tek Abrahami. Të dhënat e nxjerra për periudhën prej Abrahamit deri tek era e krishterë nuk janë të mjaftueshme. Duhet të kompletohen me të dhëna të tjera.

## 2.1 PREJ ADAMIT DERI TEK ABRAHAMIT

Libri i Zanafillës jep të dhëna tepër të sakta mbi të gjithë paraardhësit e Abrahamit në një linjë të drejtpërdrejtë prej Adamit. Në gjenealogjitë e veta nga kreu 4,5,11,21 dhe 25, duke dhënë kohëzgjatjen e jetës së secilit, moshën e babës në kohën e lindjes së djalit, ajo e bën të mundur që në këtë mënyrë të përcaktohet lehtë datat e lindjes dhe të vdekjes të çdo paraardhësi në krahasim me krijimin e Adamit, siç është shënuar në tabelën vijuese:

### GJENEALOGJIA E ABRAHAMIT

Paraardhësit e Abrahamit	Data e lindjes pas krijimit të Adamit	Jetëgjatësia	Data e vdekjes pas krijimit të Adamit
1. Adami	-	930	930
2. Sheti	130	912	1024
3. Enohi	235	905	1140
4. Kenani	325	910	1235
5. Mahalaleli	395	895	1290
6. Jeredi	460	962	1422
7. Henoku	622	365	987
8. Metuhalahu	687	969	1656
9. Lemeku	874	777	1651
10. Noa	1056	950	2006
11. Shemi	1556	600	2156

12. Arpakshadi	<b>1658</b>	<b>438</b>	<b>2096</b>
13. Shelahu	<b>1693</b>	<b>433</b>	<b>2122</b>
14. Eberi	<b>1723</b>	<b>464</b>	<b>2187</b>
10. Pelegu	<b>1756</b>	<b>239</b>	<b>1996</b>
16. Reu	<b>1787</b>	<b>239</b>	<b>2026</b>
17. Serugu	<b>1819</b>	<b>230</b>	<b>2049</b>
18. Nahori	<b>1849</b>	<b>148</b>	<b>1997</b>
19. Terahu	<b>1878</b>	<b>205</b>	<b>2083</b>
20. Abrahami	<b>1948</b>	<b>175</b>	<b>2123</b>

Kjo tabelë është përcaktuar në bazë të shënimeve të cilat burojnë nga teksti priftërorë i Zanafillës; ky është i vetmi tekst biblik i cili jep saktësi të këtij lloji. Prej kësaj del si përfundim se Abrahami sipas Biblës është lindur 1948 vjet pas Adamit.

## 2.2. PREJ ABRAHAMIT DERI TEK ERA E KRISHTERË

Për këtë periudhë Bibla nuk jep asnjë të dhënë në shifra që do të mund të na jepte vlerësime aq të sakta siç janë ato të Zanafillës për paraardhësit e Abrahamit. Për ta vlerësuar kohën që ndan Abrahamin prej Jezusit, duhet t'u referohemi burimeve të tjera. Epoka e Abrahamit sot vendoset rreth 18 shekuj para erës sonë, me mundësi të vogla për të gabuar. Kjo e dhënë, e kombinuar me treguesit e Zanafillës në intervalin që ndan Abrahamin prej Adamit, do të na sillte deri aty që ta vendosnim Adamin rreth 38 shekuj para erës sonë. Ky vlerësim është i gabuar në mënyrë të padiskutueshme: pasaktësia e tij është pasojë e gabimit që e përmban Bibla lidhur me kohëzgjatjen e periudhës Adam - Abraham, në të cilën tradita ebraike mbështetet akoma dhe sot e kësaj dite për ta përpiluar kalendarin e vet. Në kohën tonë mbrojtësive të së vërtetës biblike mund t'u kundërvemë mospërputhjen e këtyre vlerësimeve imagjinare të priftërinjve hebrej të shekullit VI para erës sonë me të dhënat bashkëkohore. Për shumë shekuj këto vlerësime kanë shërbyer si bazë për datimin e ngjarjeve të kohës së vjetër në raport me Jezusin.

Biblat që janë botuar para epokës bashkëkohore zakonisht u janë paraqitur lexuesve me kronologjinë e ngjarjeve, që janë zhvilluar që nga krijimi i botës deri në epokën në të cilën janë shpallur këto libra, dhe kjo është bërë me një parathënie eksplikative; shifrat kanë ndryshuar pak në varësi nga epokat. Për shembull, "Vulgata" e Klementit (1621) ka dhënë tregues të tillë gjë që e ka vendosur Abrahamin pak më herët dhe krijimin rreth 40 shekuj (XL) para erës sonë... Bibla shumëgjuhëshe (poliglote) "Valton", e botuar në shekullin XVII, përveç teksteve biblike në shumë gjuhë, i ka ofruar lexuesit tabela analoge me tabelën që e dhamë më sipër për paraardhësit e Abrahamit. Përafërsisht të gjitha vlerësimet janë përputhur me shifrat që janë dhënë këtu. Kur erdhi koha bashkëkohore, botusi nuk kishte më mundësi që të botojë përsëri kornologji të tilla fantazioze e të mos jetë në kundërshtim me zbulimet shkencore, të cilat krijimin e vunë në një epokë më

të largët. U kënaqën me aq sa mos të japin tabela dhe parathënie të tilla, por, kishin kujdes shumë të madh që lexuesi mos të informohej mbi vjetërsimin e teksteve biblike në të cilat janë mbështetur dikur për të bërë redigjimin e kronologjisë së tillë, që më nuk mund të konsiderohej si shprehje e së vërtetës. Më shumë ju përgjigjej që të hidhnin mbi to velin e turpshëm dhe të gjenin formula të dialektikës erudite në mënyrë që teksti të pranohej ashtu siç ka qenë dikur, pa asnjë shqetësim. Për këtë arsye kronologjitë nga teksti priftëror edhe më tej janë të vlefshme, edhe pse, logjikisht, në shekullin XX më nuk mund të llogaritet koha duke u bazuar në një fikSION të tillë.

Për sa i përket datës së paraqitjes së njeriut në Tokë, të dhënat shkencore bashkëkohore lejojnë që ajo të përcaktohet vetëm deri në një kufi të caktuar. Mund të jemi të bindur se njeriu është i aftë të mendojë dhe të punojë, gjë që e dallon nga qëniet e tjera të gjalla, që duken anatomikisht të afërta me të, ka ekzistuar në Tokë pas një date të përcaktueshme, por askush nuk do të mund ta caktojë saktësisht datën e paraqitjes së tij. Sot, përsëri, mund të pohohet se janë gjetur mbetje të një farë njerëzimi meditativ dhe veprues, vjetërsia e të cilit matet me njësitë e masës prej dhjetra mijëra vjetësh.

Ky datim i përafërt ka të bëjë me tipin parahistorik të njeriut që është zbuluar si më i riu, të llojit të neoantropus (njeriu nga Cro-Magnoni). Vërtet, zbulime të tjera të mbetejeve njerëzore, që kanë të bëjnë me tipa më pak të zhvilluar (paleoantropus), janë bërë në shumë pjesë të Tokës; njësia e vjetërsisë së tyre mund të jetë me qindra mijëra vjet. Por, a thua ata janë njerëz të vërtetë?

Si do që të jetë, të dhënat e gjetura, që kanë të bëjnë me neo-antropoidët janë mjaft të sakta sa t'i vendosim larg përtej epokës në të cilën Zanafilla, i vendos njerëzit e parë. Domethënë, ekziston mospërputhje e qartë ndërmjet asaj që mund të nxirret nga të dhënat numerike të Zanafillës që kanë të bëjnë me paraqitjen e njeriut në Tokë, dhe njohurive me mbështetje më të fortë shkencore të kohës sonë.

### 2.3. PËRMBYTJA

Kapitujt 6, 7 dhe 8 të Librit të Zanafillës i janë kushtuar tregimit mbi Përmbytjen. Më saktësisht, ekzistojnë dy tregime që nuk janë vendosur njëri pranë tjetrit, por, të ndarë në fragmente, të gërshtuar ndërmjet tyre me një farë koherence në renditjen e disa episodeve. Në të vërtetë, në këta tre kapituj ekzistojnë kundërthënie flagrante; edhe këtu ato shjehohen me ekzistimin e dy burimeve të ndryshme: Jehovaistike dhe priftërore.

Më sipër pamë se ata formojnë përzjerje jo të barabarta; secili teks origjinal është ndarë në fragmente ose fjali, kurse elementet e një burimi ndërrohen me elementet e burimit tjetër, kështu që në tërë tregimin kalohet nga njëri burim në tjetrin 17 herë në 100 rreshta të tekstit në frengjisht.

Tregimi i plotë është si më poshtë:

Meqë zvetëni i njerëzve është i përgjithshëm, Zoti vendosi t'i zhdukë të gjithë me të gjitha krijesat e gjalla. Ai e paralajmëroi Noan dhe i dha urdhër të ndërtojë një Anije në të cilën të vendosë bashkëshorten e vet, tre djemte e vet me bashkëshortet e tyre, si dhe qenie të tjera të gjalla. Përsa i përket këtyre të fundit, dy burimet ndryshojnë: një fragment i tregimit (priftëror) thotë se Noa do të marrë nga një çift të secilit lloj, pastaj, në fragmentin e ardhshëm (burimi jehovaistik),

saktësohet se Zoti dha urdhër që të merret nga kafshët e quajtura të pastra - nga shtatë çifte të secilit lloj: mashkull dhe femër, kurse prej kafshëve të quajtura të papastëra - vetëm nga një çift. Por më poshtë është saktësuar se Noa do të hyjë në Anije me nga një çift të çdo kafshe. Specialistët, si R.P.de Vaux, pohojnë se këtu kemi të bëjmë me një fragment të përpunuar të tregimit jehovaistik.

Në një fragment (i burimit jehovaistik) shënohet se shkaku i Përmbytjes është uji i shiut, por në një fragment tjetër (të burimit priftëror) shkaku i Përmbytjes është paraqitur i dyfishtë: uji i shiut dhe burimet tokësore.

E tërë Toka ka qenë e përmbytur deri mbi majat e bjeshkëve. E gjithë jeta në të ishte shkatërruar. Pas një viti, Noa del nga anija që kishte arritur në kodrën Ararat pas rënies së nivelit të ujit.

Të shtojmë edhe këtë se Përmbytja, sipas burimeve, ka pasur kohëzgjatje të ndryshme: 40 ditë të rrijtes së nivelit të ujit, sipas tregimit jehovaistik, kurse 150, sipas atij priftëror.

Tregimi jehovaistik nuk e saktëson se në cilën moshë të jetës së Noas ka ndodhur Përmbytja, por tregimi priftëror e vendos në kohën kur Noa ishte 600 vjeç. Po ky tregim jep të dhëna, me anë të gjenealogjive të veta, për lokalizimin e tij në krahasim me Adamin dhe me Abrahamin. Pasi Noa, sipas përlllogaritjes së paraqitur mbi bazë të treguesve të Zanafillës, është lindur 1056 vjet pas Adamit (shihni tabelën e paraardhësve të Abrahamit), Përmbytja ka ndodhur 1656 vjet pas krijimit të Adamit. Në krahasim me Abrahamin Zanafilla e vendos Përmbytjen 292 vjet para lindjes së këtij patriarku.

Por, sipas Zanafillës, Përmbytja i ka interesuar tërë njerëzimit, dhe të gjitha qëniet e gjalla të krijuara nga Zoti kanë qenë shkatërruar në Tokë; njerëzimi është ngritur përsëri nga tre djemtë e Noas dhe bashkëshorteve të tyre, kështu që rreth tre shekuj më vonë kur u lind Abrahami, ai e gjeti e njerëzimin të formuar në shoqëri. Si u bë që brenda një kohe kaq të shkurtër u bë përtëritja? Ky konstantim i thjeshtë ja mohon tërë vërtetësinë tregimit.

Për më tepër të dhënat historike tregojnë mospërputhjen e tij me njohuri bashkëkohore. Me të vërtetë, konsiderohet se Abrahami është lindur ndërmjet viteve 1800 dhe 1850 para erës sonë. Nëse përmbytja ka ndodhur, si sugjeron Zanafilla në gjenealogjitë e veta, rreth tre shekuj para Abrahamit, atëherë atë do të duhej ta vendosnin rreth shekullit XXI dhe XXII para erës sonë. Kjo është epoka në të cilën njohuritë bashkëkohore e lejojnë një pohim të tillë - në shumë vise të Tokës që më parë kishin lulëzuar civilizimet, mbetjet e të cilave janë ruajtur për pasardhësit.

Kjo është, për shembull, në Egjipt, periudhë e cila i paraprin Mbretërisë së mesme (viti 2100 para erës sonë), që është datë e përafërt me mesperiudhën para dinastisë XI. Në Babiloni kemi dinastinë e tretë nga Uri. Në mënyrë të përkryer dihet nuk ka pasur ndërprerje në këto civilizime, për këtë arsye nuk ka pasur as shkatërrime që do të kishin të bënin me tërë njerëzimin, siç do ta dëshironte Bibla. Prandaj, nuk mund të konsiderohet se tri tregimet biblike i sjellin njerëzimit raportin e fakteve të përputhshme me të vërtetën. Nëse jemi objektiv, jemi të detyruar të pranojmë se tekstet për të cilët është fjala, dhe që kanë depërtuar deri te ne, nuk e paraqesin realitetin. Po a thua Zoti do të mund të zbulojë diçka tjetër përveç së vërtetës? Me të vërtetë nuk mund të merret me mend përfytyrimi i Zotit

që i mëson njerëzit me ndihmën e trillimeve dhe, aq më tepër, me trillime kundërshtuese. Atëherë shumë natyrshëm arrijmë te supozimi për ndryshimet që i kanë bërë njerëzit ose në trashëgimninë gojore, që është transmetuar nga një gjeneratë në tjetrën, ose në tekstet pas fiksimit të këtyre trashëgimive. Kur dihet se një vepër, siç është Zanafilla, është përpunuar së paku dy herë brenda tre shekujve atëherë si të çuditemi kur në të gjejmë gjëra të pabesueshme ose tregime të kundërta me realitetin e gjërave, që kur progresi i njohurive njerëzore e bëri të mundur, nëse jo të dihet çdo gjë që së paku për disa ngjarje të merret një njohuri e mjaftueshme sa të mund të gjykohet mbi shkallën e lidhjes së saj me tregimet e lashta që kanë të bëjnë me to. A ka gjë më të logjikshme se sa t'i përmbahemi këtij interpretimi të gabimeve në tekstet biblike që i përzbejnë në kontest vetëm njerëzit? Është për të ardhur keq që nuk e mbështesin shumica e komentuesve, as të krishterë as hebrenj. Por, përsëri, argumentat që ata i thërrasin në ndihmë meritojnë vëmendje.

#### **IV**

### **QËNDRIMI AUTORËVE TË KRISHTERË NDAJ MASHTRIMEVE SHKENCORE TË TEKSTEVE BIBLIK - SHQYRTIM KRITIK I TYRE**

Jemi të habitur shumëllojshmëria e reaksioneve të autorëve të krishterë lidhur me ekzistimin e këtij grumbulli të trillimeve, të gjërave të pabesueshme dhe të kundërshtimeve. Disa prej tyre e pranojnë ndonjëherë nga këto dhe nuk hezitojnë që në veprat e veta të ballafaqohen me probleme të vështira. Të tjerët hareshëm kalojnë nëpër pohimet e papranueshme, duke i kushtuar kujdes mbrojtjes së teksteve fjalë për fjalë dhe duke u përpjekur të na bindin me anë të deklaratave apologetike dhe me mbështetje të madhe të argumentave shpesh të papritura, me shpresë se në këtë mënyrë do të harrojnë atë që logjika e hedh poshtë.

R.P.de Vaux, në Hyrjen e tij të përkthimit të Zanafillës, lë mundësinë e ekzistimit të këtyre kritikave dhe për më tepër flet mbi bazueshmërinë e tyre, por, sipas tij, rindërtimi objektiv i ngjarjeve nga e kaluara është i padobishëm. Ai në shënimet e veta shkruan: *"Ajo që Bibla e ka huazuar rikujtimin e një apo më shumë vështrimeve katastrofike në ultësirën e Tigrit dhe të Euftratit, që tradita i ka zmadhuar deri në parmasat e kataklizmës universale"* ka rëndësi fare të vogël; është e rëndësishme se *"vetëm autori i shenjtë i ka dhënë këtij kujtimi këshillë universale mbi drejtësinë dhe mëshirën e Zotit, mbi ligësinë njerëzore dhe shpëtimin që jepet të drejtit"*.

Kështu është arsyetuar transformimi i një legjende të popullarizuar në ngjarje me përmasa hyjnore - e cila, si e tillë, i ofrohet njerëzve për ta besuar - duke filluar nga çasti kur një autor e ka shfrytëzuar si një ilustrim të një këshille fetare. Një qëndrim i këtyre apologetik i arsyeton të gjitha keqpërdorimet e njerëzve në krijimin e shkrimeve për të cilat thuhet se janë të shenjta dhe se përmbajnë Fjalën e Zotit. Të lejosh përzjerje të tilla njerëzore me Hyjnoren, do të thotë të mbrosh të gjitha shpërdorimet e njerëzve me tekste biblike. Nëse ekziston qëllimi teologjik,

të gjitha shpërdorimet bëhen të ligjëruara dhe kështu mbrohen dhe ato të autorëve të shekullit VI, me preokupimet legaliste që kanë çuar deri te tregimet e njohura fantazioze.

Një numër i konsiderueshëm i komentuesve të krishterë e konsideruan si mendjempërtësi që këto trillime, gjëra të pabesueshme dhe kundërthënie të tregimeve biblike, t'i shpjegojnë duke nënvizuar këtë arsyetim: autorët biblikë janë shprehur varësisht nga faktorët shoqërorë me kulturë dhe mentalitet të shumëllojshëm, që gjë ka çuar deri te përkufizimi si "*vepra letrare*" të veçanta. Futja në këtë mënyrë e kësaj shprehjeje në dialektikën subtile të komentuesve i fsheh të gjitha vështirësitë. Çdo kundërthënie mes dy teksteve ka si shpjegim ndryshimin në mënyrën e të shprehurit të secilit autor, "*gjininë letrare*" të veçantë të tij. Me të vërtetë këtë argument nuk e pranuan të gjithë, sepse megjithëmend nuk është serioz. Por, ai, përsëri, nuk u hodh poshtë krejtësisht në ditët tonë dhe në rastin e Besëlidhjes së Re do të shihet se në ç'mënyrë jo korrekte bëhen përpjekje që të shpjegohen kundërthëniet aq të hapta të Ungjijve.

Një mënyrë tjetër që të pranohet ajo që, logjika në tekstin kontestues, po të zbatohet do ta hidhte poshtë, është që teksti përkatës të mbulohet me shqyrtime apologetike. Vëmendja e lexuesit është zhvendosur nga problemi thelbësor i vërtetësisë së tregimit, për t'u përqëndruar në probleme të tjera.

Pasqyrimet e kardinal Danielit mbi Përmbytjen, që u paraqitën në revistën "Dieu vivant" (Zoti jeton), me titull "*Përmbytja, Kryqëzimi, Gjyqi*", zbulojnë një mënyrë të këtillë të të shprehurit. Ai shkruan: "*Tradita më e lashtë e Kishës në teologjinë e Përmbytjes ka parë simbolin e Krishtit dhe të Kishës*". Ky është "*episodi me rëndësi të veçantë...*" "*gjyqi që godet tërë racën njerëzore*". Pasi e citon Origenin, i cili në veprën e vet "*Predikimet mbi Ezekielin*" flet mbi "*Përmbytjen e tërë Gjithësisë të shpëtuar në Anije*", kardinali evokon vlerën e numrit tetë "*i cili shpreh numrin e vetave të shpëtuar në Anije (Noa dhe bashkëshortja e tij, tre djemtë me tre bashkëshortet e tyre)*". Ai e huazon për vete atë që e ka shkruar Justini në veprën e vet "*Dialogu*". "*Ata kanë dhënë simbolikën e ditës së tetë në të cilën Krishti ynë u ringjall nga të vdekurit*" dhe shkruan: "*Noa, i parëlinduri në krijimin e ri, simboli i Krishtit, i cili ka realizuar atë që ka simbolizuar Noa*". Ai vazhdon krahasimin ndërmjet Noas i cili shpëtoi me ndihmën e drurit të Anijes në të cilin ky noton në një anë, dhe të ujit të pagëzimit ("uji të Përmbytjes nga i cili lind njerëzimi i ri") dhe drurëve të kryqit në anën tjetër. Ai ngul këmbë në vlerën e këtij simbolizimi dhe përfundon duke vënë theksin në "*pasurinë shpirtërore dhe doktrinare të sakramentit të Përmbytjes*".

Do të mund të flitej shumë për këto krahasime apologetike. Ato komentojnë - të rikujtojmë - një ngjarje vërtetësia e së cilës nuk mund të mbrohet në peshoren universale dhe në epokën në të cilën vendoset Bibla. Para komentimit, siç është ky i kardinal Danielit, na bie ndër mend epoka e mesjetës kur është dashur që teksti të pranohet ashtu siç ka qenë dhe kur nuk ka qenë e mundur të bëhet asnjë diskutim, përveç atij konformist.

Por të jep kurajo konstantimi se para kësaj epoke të errësirës së imponuar mund të zbulohen qëndrime shumë logjike, siç është ai i Shën Agustinit, i cili del nga mendimi që i paraprin kohës së vet. Në epokën e Eërve të Shenjtë problemet e

kritikës së teksteve kanë qenë dashur të imponohen. Këtë Shën Agustini e evokon në një letër të vetën, Nr. 82, nga e cila po citojmë një fragment më karakteristik:

*"Vetëm këtyre librave të shkrimit (të Shenjtë), që quhen kanonikë, ka mësuar t'u kushtoj një vëmendje dhe një respekt të atillë, sa që besoj fort se asnjë autor i tyre nuk ka mundur të mashtrrojë duke i shkruar. Kur në këta libra hasi në pohimin që duket se e kundërshton të vërtetën, atëherë nuk dyshoj se teksti i (kopjes sime) është i gabuar ose përkthyesi nuk ka dhënë në mënyrë besnike tekstin origjinal ose ndoshta intelektin im nuk është i mjaftueshëm".*

Për Agustinin e shenjtë ka qenë e paimagjinueshme që një tekst i shenjtë mund të përmbajë trillime. Shën Agustini e ka përkufizuar shumë qartë dogmën e pagabueshmërisë. Para një fragmenti që duket se i kundërvihet së vërtetës, ai u mendua për kërkimin e shkakut dhe nuk e ka përjashtuar supozimin mbi prejardhjen njerëzore. Një qëndrim i tillë është qëndrim i besimtarit që ka pikëpamje kritike. Në epokën e Shën Agustinit nuk ka ekzistuar mundësia e konfrontimit të tekstit biblik me shkencën. Gjerësia e pikëpamjes së njëjtë me të tijën do të kishte bërë të mundur që në kohën tonë të kapërcehen shumë vështirësi që paraqiten kur i krahasojmë disa tekste biblike me njohuritë shkencore.

Specialistët e kohës sonë përpiqen, përkundrazi, ta mbrojnë tekstin biblik nga çdo sulm për shkak të gabimit. R.P.de Vaux në Hyrjen e tij në Përmbajtje na jep shkaqet që e shtojnë në këtë mbrotje të tekstit me çdo kusht edhe atëherë kur ajo është e prapranueshme në pikëpamje historike ose shkencore. Ai nga ne kërkon që historinë biblike mos ta shikojmë "*sipas rregullave të atij lloji të historisë me të cilën merren bashkëkohësit*", sikur mund të ekzistojnë shumë mënyra të të shruarit të historisë. E shpjeguar në mënyrë jo të saktë, historia bëhet - të gjithë e pranojnë këtë - roman historik. Por, këtu, ajo i eviton normat që dalin nga konceptonet tona. Komentuesi biblik refuzon çdo kontrollim të tregimeve biblike me anë të gjeologjisë, paleontologjisë dhe me anë të dhënave parahistorike. "*Bibla nuk varet, shkruan ai, nga asnjëra prej këtyre disiplinave, dhe po të donim ta konfrontonim me të dhënat e këtyre shkencave do të mund të arrihej vetëm deri te kundërthëniet joreale ose te përputhjet artificiale*". Duhet të vërejmë se këto refleksione janë bërë lidhur me atë që në Zanafillë nuk është aspak në përputhje me të dhënat e shkencës bashkëkohore, sidomos kapitujt prej 1 deri 11. Por, nëse disa tregime janë të verifikuara plotësisht në kohën tonë, siç janë disa episode nga koha e patriarkut, autori nuk e lëshon rastin të mbështetet në njohuritë bashkëkohore për konfirmimin e vërtetësisë biblike. Ai shkruan: "*Dyshimet që kanë dominuar lidhur me këto tregime duhet të lëshojnë pe para vërtetimit të mjaftueshëm që iu bën historia orientale dhe arkeologjia*". Me fjalë të tjera, nëse shkenca është e dobishme për ta vërtetuar tregimin biblik, ajo mbështetet në të, e nëse e konteston, është e palejueshme t'i referohet atij.

Që të pajtohet e papajtueshmja, d.m.th. teoria e së vërtetës së Biblës me karakterin jo të saktë të disa fakteve të paraqitura në tregimet e Besëlidhjes së Vjetër, teologët modernë kanë filluar të bëjnë revidimin e koncepteve klasike të vërtetësisë. Po të donim shprehim hollësisht shqyrtimet subtile të cilat zhvillohen gjerësisht në veprat me temën vërtetësisë së Biblës, siç është ajo e O. Lorencit (1972), do të dilnim nga suazat e këtij libri. Çfarë është vërtetësia e Biblës? Të përmendim vetëm një gjykim që i përket shkencës:



Autori shkruan se Koncili i Dytë i Vatikanit *"është kujdesur mirë që të mos përcaktojë rregulla për dallimin e së vërtetës nga trillimi në Bibël. Shqyrtime themelore tregojnë se kjo është e pamundur meqë Kisha nuk mund të vendosë mbi vërtetësinë apo pavërtetësinë e metodave shkencore në atë mënyrë që do të zgjidhte parimisht dhe në mënyrë të përgjithshme çështjen e vërtetësisë së Shkrimit (të Shenjtë)".*

Është e qartë se Kisha nuk do të mund të deklarohej mbi vlerën e një "metode", si mjet për t'iu afruar diturisë. Këtu është fjala për diçka krejt tjetër. Nuk është fjala për diskutimin mbi teorinë, po për faktet e vërtetuara mirë. A thua në epokën tonë është e nevojshme të jesh shkencëtar i mirë për të ditur se bota nuk është krijuar dhe se njeriu nuk është paraqitur në Tokë para tridhjet e shtatë apo tridhjet e tetë shekujve, dhe se ky vlerësim, i nxjerr nga gjenealogjia biblike mund të shpallet i gabueshëm pa rrezik mashtrimi? Autori, të cilin e cituam këtu do të duhej ta dinte këtë. Pohimet e tij mbi shkencën kanë për qëllim vetëm ta kthejnë problemin vetëm në anën tjetër, në mënyrë që të mos të mund të trajtohet si duhet.

Rikujtimi i të gjitha këtyre qëndrimeve të autorëve të krishterë ndaj gabimeve shkencore të teksteve biblike e ilustron mirë shqetësimin që e shkaktojnë ato dhe pamundësinë që të përcaktohet një qëndrim tjetër logjik, përveç atij që e pranon prejardhjen e tyre njerëzore dhe pamundësinë për t'i pranuar si pjesë të një shpalljeje.

Shqetësimi i cili i mundon rrethet e krishtera, kur është fjala për Shpalljen, është shprehur gjatë Koncilit të dytë të Vatikanit (1962 - 1965) kur qenë të nevojshme të bëhen jo më pak se pesë redaktime për tu arritur pajtimi lidhur me tekstin përfundimtar dhe për tu ndërprerë (kjo gjendje e dhembshme që kërcënonte ta mbyste Koncilin) sipas shprehjes së imzot Veberit, në hyrje që e kishte shkruar në dokumentin e Koncilit Nr. 4 mbi Shpalljen<sup>15</sup>.

Dy fjali nga ky tekst, që kanë të bëjnë me Besëlidhjen e Vjetër (kreu IV, fq. 53), zhvillojnë gjëra me të meta dhe vjetërsim të atillë të disa teksteve që nuk lejojnë kurrëfarë kontekstimi:

*"Duke mbajtur parasysh pozitën e njeriut para shpëtimit të cilin e ka sjellë Krishti, librat e Besëlidhjes së Vjetër ja bëjnë të mundur secilit të njohë cili është Zoti e cili është njeriu, si dhe mënyrën se si Zoti, me drejtësinë dhe mirësinë e tij, vepron me njerëzit. Këto libra, edhe për kundër asaj se përmbajnë gjëra të papërsosura dhe gjëra të vjetërsuara, përsëri janë dëshmitarë të pedagogjisë së vërtetë Hyjnore".*

Me anë të cilësorit *"i papërsosur"* dhe *"i vjetërsuar"*, që janë përdorur në disa tekste, nuk mund të thuhet se këta i nënshtrohen kritikës dhe se mund të heqin dorë prej tyre; parimi është lejuar në një mënyrë mjaft të qartë.

Ky tekst është pjesë e deklaratës së përbashkët, e cila, edhe pse definitivisht është botuar me 2344 vota ndaj 6 votave nuk ka qenë dashur të jetë kaq gati njëzërëshe. Dhe me të vërtetë, në komentimet e dokumentit zyrtar nga imzot Veberi është nënshkruar një fjali e cila në mënyrë të qartë e korrigjon pohimin mbi vjetërsinë e disa teksteve që i përmban deklaratatë solemne e Koncilit: *"Pa dyshim, disa libra të Biblës izraelite kanë kufirin kohor dhe në vete përmbajnë diçka të papërsosur"*.

Shprehja *"vjetërsuar"* nga deklaratatë zyrtare pa dyshim nuk është sinonim i *"kufirit kohor"*, si shprehje e komentuesve, kurse për sa i përket epitetit *"izraelite"*, të cilin

ky i fundit e ka shtuar në mënyrë të çuditshme, ai sikur sugjeron se teksti i Koncilit e ka kritikuar vetëm versionin hebraik, kurse, në të vërtetë, kjo nuk është ashtu aspak pasi që Besëlidhja e Vjetër, gjatë Koncilit, thjesht ishte objekt gjykimi që kishte të bënte me papërsosurinë dhe vjetërsinë e disa pjesëve të saj<sup>16</sup>.

## V PËRFUNDIMET

Nuk duhen shikuar Shkrimet biblike duke i zbuluar artificialisht me cilësi që do të dëshironim t'i kishin, por, duhen studiuar objektivisht për atë që janë ato. Kjo nënkupton jo vetëm njohjen e teksteve, por edhe njohjen e historisë së tyre. Kjo e fundit me të vërtetë e bën të mundur krijimin e përfytyrimit lidhur me rrethanat që kanë çuar deri në përpunimin e teksteve gjatë shekujve, deri në formimin e ngadalshëm të përmbledhjes të tillë që kemi sot, me heqje dhe shtim pjesësh të shumta.

Pikëpamjet e tilla e bëjnë krejtësisht të pranueshme atë se në Besëlidhjen e Vjetër mund të gjejmë versione të ndryshme të të njëjtit tregim, kundërthënie, gabime historike, gjëra të pabesueshme dhe mospërputhje me njohuritë shkencore të vërtetuara mirë. Ato janë krejtësisht të natyrshme në të gjitha veprat njerëzore të lashtësisë. Atëherë, si të mos i gjejmë në librat e shkruar në kushte të tilla që është elaboruar teksti biblik?

Edhe para se të mund të shtrohen problemet shkencore, në një epokë në të cilën ka mundur të gjykohej vetëm mbi gjërat e pamundshme dhe kundërthëniet, një njeri me mendje të shëndoshë, siç ka qenë Agustini i shenjtë, duke thënë se Zoti nuk ka mundur t'i mësojë njerëzit për atë që nuk i përgjigjet realitetit, e ka vendosur parimin e pamundësisë së prejardhjes hyjnore të ndonjë pohimi të kundërt me të vërtetën. Ai ka qenë i gatshëm që prej çdo teksti të shenjtë atë që i është dukur se për këtë arsye duhet hequr.

Më vonë, në një epokë kur u kuptua mospërputhja e disa fragmenteve të Biblës me njohuritë bashkëkohore, u ndërpre mbajtja e këtij qëndrimi. Atëherë kemi qenë prezent kur lindi një literaturë, e cila kishte për qëllim që në Bibël, përkundër të gjithave, ta arsyetojë mbajtjen e teksteve që më nuk kanë vend në të. Koncili i dytë i Vatikanit (1962 - 1965) e ka zbutur shumë këtë papajtueshmëri duke shprehur rezervën për "*librat Besëlidhjes së Vjetër*" të cilët "*përmbajnë papërsosuri dhe vjetërsi*". A thua ajo do të jetë edhe më tej besëlidhje hyjnore apo do të ndyshojë qëndrimin ndaj asaj që më nuk është e pranueshme në shekullin XX, në librat, qëllimi i të cilëve ka qenë të jenë jashtë çdo shpërdorimi njerëzor, vetëm "*dëshmitarë të një pedagogjie të vërtetë hyjnore*"?

## UNGJIJTË

### I. HYRJJE

Shumë lexues të Ungjijve janë të habitur edhe të turbulluar kur mendojnë për domethënien e disa tregimeve ose kur bëjnë krahasime ndërmjet versioneve të

ndryshme të të njëjtës ngjarje që është treguar në disa Ungjij. Këtë e konstanton R.P. Roge në librin e vet "*Hyrje në Ungjijtë*"<sup>17</sup>. Me një përvojë të madhe që e kishte arritur gjatë shumë viteve, kur e kishte për detyrë që në një revistë katolike t'u përgjigjej lexuesve të hutuar nga tekstet e Ungjijve. R.P.Roge ka mundur ta vlerësojë rëndësinë e pertubacionit që ka shkaktuar tek ata literatura e tyre. Ai shënon se bashkëbiseduesit e tij, të cilat i takonin mjediseve shumë të ndryshme shoqërore dhe kulturore, kërkonin shpjegime lidhur me tekstet "*e paqartë të pakuptueshme, edhe kundërthënës, absurd ose skandaloz*". Nuk ka dyshim se leximi i plotë i Ungjijve është në gjendje t'i shqetësojë shumë të krishterët.

Një observim i këtillë është bërë së voni libri i R.P.Roge-së është botuar më 1973. Në kohën e cila nuk është aq e largët shumica e të krishterëve nga Ungjijtë dinin vetëm fragmente të zgjedhura, që janë lexuar gjatë shërbimit ose që janë komentuar nga altari. Nëse lihen anash protestantët, nuk ka qenë e zakonshme që Ungjijtë të lexohen në tërësi jashtë këtyre rasteve. Ndër doracakët të edukimit fetar janë përfshirë vetëm botimet e tyre të shkurtra: teksti in extenco (tërësisht) nuk ka qenë fare në lexim. Gjatë kohës së studimeve të mija në një ent katolik, më kanë rënë në dorë vepra të Virgjilit dhe të Platonit, por jo edhe Besëlidhja e Re. Por, përsëri, teksti grek i këtij do të ishte shumë instruktiv: shumë më vonë e kam kuptuar pse nuk na i jepnin për ti përkthyer librat e shenjtë të krishterë. Ato do të mund të na shtynin t'u bënim pyetje mësuesve tanë të cilat do ti tronditnin.

Nëse njeriu ka shpirt kritik, duke i lexuar Ungjijtë in extenco do të vijë patjetër deri tek këto zbulime të cilat edhe e kanë shtyrë Kishën të ndërhyjë dhe t'u ndihmojë lexuesve në mënyrë që ta kalojnë tronditjen e tyre. "*Shumë të krishterë kanë nevojë të mësojnë t'i lexojnë Ungjijtë*", konstanton R.P.Roge. pa marrë parasysh se a pajtohemi me shpjegimet e bëra autori ka meritë të madhe që është ballafaquar me këto probleme delikate. Kjo, për fat, akoma nuk po ndodh me shumë dokumente mbi Shpalljen e krishterë.

Në botimet e Biblës të dedikuara për publikun e gjerë, shënimet hyrëse shprehin më së shpeshti një grumbull pikëpamjesh që do të dëshironin të bindnin lexuesin se Ungjijtë përgjithësisht nuk shtrojnë probleme të personalitetit të autorit të librave të ndryshëm, rreth origjinalitetit të teksteve dhe rreth karakterit të vërtetë të tregimeve. Edhe pse ekzistojnë aq shumë gjëra të panjohura për autorët, në origjinalitetin e të cilëve nuk jemi të sigurtë aspak, sa janë të sakta këto lloje të shënimeve, që shpesh e paraqesin si të sigurtë atë që është vetëm hipotezë, duke pohuar se filan ungjilltar i ka parë ngjarjet, kurse veprat e specializuara e pohojnë të kundërtën<sup>18</sup>.

Teprohet shumë me shkurtimin e kohës ndërmjet fundit të profecisë së Jezusit dhe paraqitjes së teksteve. Do të dëshironim të na bindnin vetëm për një redaktim që është bazuar në gojëdhënat popullore, edhe pse specialistët e kanë dëshmuar redaktimin e teksteve. Aty-këtu flitet për disa vështirësi të interpretimit, por kalohet rrëshqitazi pranë kundërthëniesve të qarta që ja vrasin syrin atij që mendon. Konstatohet shpesh se në fjali të shkurtra eksplikative, të futura në shtojcë, si shtesë e hyrjeve qetësuese, kundërthëniet e gabimet e hapta janë fshehur ose janë mbytur me argumentime të shkathta apologjetike. Kjo gjendje që zbulon karakterin dinak të këtyre komenteve është shastIsës a.s.e.

Shqyrtimet që po i bëjmë këtu do t'i habisin, pa dyshim, ata lexues të mi të cilët ende nuk kanë njohuri për këto probleme. Përveç kësaj, para se të hyjnë në thelbin e çështjes, që tani dëshiroj t'i ilustroj fjalët e mija me një shëmbull që më duket se është krejt demonstrativ.

As Mateu, as Gjoni nuk flasin për shëlbimin e Jezusit. Luka në Ungjillin e vet e vendos në ditën e ringjalljes dhe dyzet ditë më vonë në Veprat e Apostujve, autor i të cilës do të duhej të ishte. Sa i përket Markut, ai përmend (duke mos e saktësuar datën) në një finale, e cila sot konsiderohet jo autentike. Shëlbimi domethënë, nuk ka kurrëfarë baze solide biblike. Por, përsëri, komentuesit i afrohen kësaj çështje të rëndësishme me një indiferencë të pabesueshme.

A. Trikoti, në librin e tij *Petit Dictionnaire du Nouveau Testament* (Fjalori i vogël i Besëlidhjes së re), nga *Bibla Crampon*, vepër shumë e përhapur (botuar më 1960)<sup>19</sup>, nuk i kushton asnjë artikull shëlbimit. *Synopse des 4 Evangiles* (Krahasimi i katër Ungjijve) P.R. Benoitit dhe P.P. Boismardit, profesor në Shkollën Biblike të Jeruzalemit (botuar më 1972)<sup>20</sup>, në vëllimin II, fq.451 dhe 452, na mëson se te Luka shpjegohet me "*mjeshtri letrare*". Le të kuptojë kush të mundet!

Me siguri shumë të madhe R.P. Roge, në veprën e vet *Initiato a l'Evangile* (Hyrje në Ungjijtë), në vitin 1973, nuk është mashtruar me një argument të tillë, por shpjegimi që na ofron ai është i pazakontë:

*"Këtu, si dhe në shumë raste të ngjashme, problemi duket se është i pazgjithshëm vetëm nëse pohimet e Shkrimit (të Shenjtë) merret si shprehimisht materiale, duke harruar domethënien e tyre fetare. Nuk është fjala për atë që realiteti i fakteve të kthehet në një simbolizëm të flashkët, por të kërkohet qëllimi teologjik i atyre që na zbulojnë fshehtësitë, duke na dhënë fakte të kapshme, të përshtatshme për ndjesinë e selitur të shpirtit tonë".*

Si të kënaqemi me një shpjegim të tillë? Formulatat apologetike të këtij lloji mund t'ju shërbejnë vetëm dogmatikëve.

Citati i R.P.Roges është njësoj interesant për pranimin e tij se në Ungjijtë ka "*shumë raste të ngjashme*" me atë të shërbimit. Domethënë, është e nevojshme t'i futemi problemit plotësisht, nga brenda, me objektivitet të plotë. Duket se është mençuri të kërkohet shpjegim për studimin e kushteve në të cilat janë shkruar Ungjijtë dhe për klimën fetare të asaj kohe. Nxjerrja në dritë e korrigjimeve të redaktimeve fillestare, që janë bërë mbi bazë të gojëdhënave popullore, dhe ndryshimi i teksteve gjatë transmetimit deri te ne, e bëjnë shumë më pak të pazakonshëm ekzistimin e fragmenteve të paqarta, të pakuptueshme, kundërthënëse dhe të pabesueshme, që ndonjëherë shkojnë deri në absurd ose të fragmenteve të papërputhshme me faktet që i ka vërtetuar përparimi shkencor në kohën tonë.

Është fakt se para disa dhjetëvjeçarësh është paraqitur interesi për studimin e Shkrimeve (të Shenjta) në frymën e studimit objektiv. Në një libër të kohës më të re "*Foi en la Resurrection, Resurrection de la foi*" (Besimi në Ringjallje, Ringjallje e Besimit)<sup>21</sup>, R.P. Kannengiesser, profesor në Institutin Katolik të Parisit, jep një pasqyrë të shkurtër të këtij ndryshimi të thellë me këto fjalë: "*Besimtarët e vërtetë as që e dinë se është bërë revolucion me metodat e shpjegimit të Biblës që nga epoka e Piut XII*". "*Revolucioni*" për të cilin flet autori

është i datës më të re. Ai fillon të vazhdojë në këshillimin e besimtarëve, së paku nga disa specialistë, të cilët i vë në lëvizje kjo frymë e re. *"Qarkullimi i prespektivave më të besueshme të traditës baritore, shkruan autori, nuk është filluar aspak me këtë revolucion të metodave të shpjegimit"*.

R.P. Kannengiesser tërheq vërejtjen se *"Nuk duhet kuptuar shprehimisht"* faktet që i sjellin Ungjijtë për Jezusin, *"të shkruash siaps rasteve"* ose *"luftarake"*, autorët e të cilëve *"i ushqejnë me shkrim gojëdhënat e bashkësive të veta mbi Jezusin"*<sup>22</sup>. Lidhur me ringjalljen e Jezusit, që është temë e librit të tij, ai nënvizon se asnjë autor i Ungjijve nuk mund t'i përshkruajë vetes cilësinë e personit që e ka parë ngjarjen, duke bërë me dije se duhet të jetë ashtu edhe me një pjesë të jetës së Jezusit, pasi, sipas Ungjijve, asnjë apostull - përveç Judës - nuk u nda nga Mësuesi që nga momenti kur i shkuan pas e deri në manifestimet e fundit në këtë vend.

Ja, pra, sa jemi larg pikpamjeve tradicionale, të cilat në mënyrë edhe më solemne i ka vërtetuar Koncili i Dytë i Vatikanit, para më pak se dhjetë vjetësh, e të cilat akoma huazojnë vepra bashkëkohore të vulgarizimit që u janë kushtuar besimtarëve. Por, pak nga pak, e vërteta po del në dritë.

Nuk është e lehtë të vihet deri tek e vërteta, sepse aq e rëndë është barra e traditës që është mbrojtur me aq ashpërsi. Nëse duam të lirohemi nga ajo, duhet t'i afrohemi problemit në thelbin e tij, domethënë më parë të studiohen kushtet që kanë bërë që të lind krishtërimi.

## **II**

### **RIKUJTIMI I HISTORISË**

### **HEBREO - KRISHTERIMI**

### **DHE SHËN PALI**

Shumica e të krishterëve beson se Ungjijtë janë shkruar nga dëshmitarë të drejtpërdrejt të jetës së Jezusit dhe, për këtë arsye, ata paraqesin dëshmi të padyshimta mbi ngjarjet që e kanë stolitur dhe predikimet e tij. Si do të mund të dikutohej mbi këshillat që dalin nga ata, kur janë dhënë garanci të tilla lidhur me origjinalitetin, si do të mund të dyshohej në vlerën e institucionit të Kishës duke zbatuar direktivate përgjithshme që i ka dhënë vetë Jezusi? Botimet e tashme të Ungjijve, që i janë dedikuar popullarizimit, përmbajnë komentime qëllimi i të cilave është që të përhapin pikpamje të tilla në publik.

Cilësia e dëshmitarëve të redaktimit të Ungjijve iu paraqitet si aksiomë besimtarëve. Po a thua shën Justini, nga mesi i shekullit II, nuk i quajti Ungjijtë Memoare të Apostujve. Pastaj, flitet me aq saktësi për autorët, saqë pyesim se si do të mund të dyshohej në saktësinë e tyre; Mateu ishte person shumë i njohur, *"nënpunës dogane në Kafarnaum"*, dihet se e ka njohur gjuhën aramenishte dhe greke. Marku, gjithashtu, është indentifikuar në mënyrë të përsosur si bashkëpunëtor i Pjetrit; nuk ka asnjë dyshim se ka qenë edhe dëshmitar i

ngjarjeve. Luka është "mjeku i dashur" për të cilin flet Pali: njoftimet për të janë mjaft të sakta. Gjoni është apostull gjithnjë i afërt me Jezusin, djalë i Zebedit, peshkatar në liqenin e Genezaretit.

Studimet bashkëkohore mbi fillimet e krishterimit tregojnë se kjo mënyrë e paraqitjes së gjërave nuk i përgjigjet aspak realitetit. Do të shohim se ç' ndodh me autorët e Ungjijve. E sa i përket dhjetëvjeçarëve pas misionit të Jezusit, duhet të dimë se ngjarjet aspak nuk janë zhvilluar ashtu siç është thënë dhe se me shkuarjen e Pjetrit në Romë nuk u vunë themelet e Kishës. Por, përkundrazi, që nga ai çast Jezusi e lëshoi këtë tokë, nga gjysma e dytë e shekullit II ose gjatë më shumë se një shekulli, është zhvilluar luftë e ashpër ndërmjet dy tendencave: ndërmjet asaj që mund të quhet krishtërim palian dhe hebreo-krishterimit: i pari e ka mundur gradualisht të dytin dhe krishterimi palian ngadhnjeu mbi atë hebreo-krishterim 11:26 PM 11:26 PM.

Një numër shumë i madh punimesh të botuara në dhjetëvjetëshat e fundit, të bazuar në zbulimet e kohës sonë, bënë të mundur që të arrijmë deri te botëkuptimet bashkëkohore me të cilat lidhet emri i kardinal Danielit. Artikulli që e ka botuar në dhjetor të vitit 1967, në revistën "Etudes": "Pikëpamje e re për periudhën e krishterimit dhe të hebreo-krishterimit", duke huazuar punimet e mëhershme, ai trazon historinë dhe na mundëson ta vendosim paraqitjen e Ungjijve në një kontest shumë më të ndryshëm nga ai që e theksojnë raportet, që janë destinuar për masa e gjera. Këtu më poshtë do të japim një përmbledhje të pikave thelbësore të artikullit të tij, me citate të shumta:

Pas Jezusit, "një grup i vogël apostujsh" e formojnë një "sekt Hebre besnik ndaj rregullave dhe kultit të tempullit". Përsëri, kur kësaj i shtohen edhe konvertitët e ardhur nga paganizmi, atyre u propozohet, nëse mund të thuhet, një regjim i posaçëm: Koncili i Jeruzalemit, viti 49, i liron nga synetlia (rrethprerja)<sup>23</sup> dhe nga rregullat Hebre: "shumë hebreo-krishter e refuzojnë këtë koncesion". Ky grup është krejtësisht i ndarë nga Pali. Aq, më tepër lidhur me paganët që iu bashkuan krishterimit, Pali dhe hebreo-krishterët kacafyten (incidenti vitit 49 në Antioki). "Për Palin, po edhe për hebrejtë syneti, sabati dhe kulti i tempullit që nga kjo kohë u bënë të parëndësishëm. Krishtërimin iu desh të lirohej nga përkatësia politiko-fetare hebraike në mënyrë që të hapej ndaj paganëve".

Për hebreo-krishterët që mbetën "izraelit besnikë", Pali ishte tradhëtar; dokumentet hebreo-krishtere konsiderojnë si "armik", duke e paditur për shkak "të dyftysisë taktike", por "hebreo-krishterizmi deri në vitin 70 paraqet shumicën e Kishës", kurse "Pali mbeti i izoluar". Shef i bashkësisë atëherë ishte Jakovi, kushëri i Jezusit. Me të (në fillim) është Pjetri dhe Gjoni. "Jakovin mund ta konsiderojmë shtyllë të hebreo-krishterimit që qëndroi vendosmërisht i angazhuar në hebraizëm përkundër krishtërimin palian". Familja e Jezusit zë vend të madh në këtë kishë hebreo-krishtere të Jeruzalemit. "Trashigimtari i Jakobit do të jetë Simoni, djali i Kleopasit, kushëri i Zotërisë".

Kardinal Danieli këtu citon shkrimet judeo-krishtere që shprehin pikëpamjen për Jezusin e kësaj bashkësie, fillimisht të formuar prej apostujve: Ungjijtë e hebrejve (sipas një bashkësie judeo-krishtere në Egjipt), Hipotipozat e Klementit, Apokalipsi i Dytë i Jakovit, Ungjilli i Tomës<sup>24</sup>. "Pa dyshim, me hebreo-

*krishterimin duhen lidhur përmendoret më të lashta të literaturës së krishterë", të cilën kardinal Danieli e përmend hollësisht.*

*"Gjatë shekullit të parë të kishës, hebreo-krishterimi nuk është dominues vetëm në Jeruzalem dhe në Palestinë. Duket se misioni judeo-krishterë është zhvilluar gjithkund para misionit të Palit. Mu kjo shpjegon se si letrat e Palit vazhdimisht aludojnë në përleshje". Gjithandej do të hasen të njëjtët armiq, në Galile, në Korint, në Kolosos, në Romë, në Antioki.*

Bregdeti siriano-palestinez, prej Gazës deri në Antioki, ishte judeo-krishter, "si e dëshmojnë Veprat e Apostujve dhe shkrimet e Klementit". Lidhur me ekzistimin e judeo-krishterëve në Azinë e Vogël dëshmojnë letrat e Palit drejtuar Galatasve dhe Kolosianëve. Shkrimet e Papisë njoftojnë mbi hebreo-krishterimin në Frigji. Në Greqi, letra e parë e Palit drejtuar Korintasve mendon në judeo-krishterët, posaçërisht në Apollosin. Roma është një "qëndër e rëndësishme", sipas letrës së Klementit dhe Bariun e Hermasit. Për Svetonin dhe Tacitin, të krishterët janë një sekt Hebre. Kardinal Danieli mendon se ungjëllizimi i parë i Afrikës ka qenë hebreo-krishterimi. Me të lidhen Ungjijtë e hebrejve dhe shkrimet e Klementit të Aleksandrisë.

Është me rëndësi tepër të madhe të dihen këto fakte në mënyrë që të kuptohet në ç'atmosferë lufte ndërmjet bashkësive janë shkruar Ungjijtë. Rregullimi i teksteve që i kemi sot, pas gjithë atyre përpunimeve, ka filluar të bëhet rreth vitit 70, në epokën kur dy bashkësitë rivale janë në luftë e sipër, kurse hebreo-krishterimi dominonte akoma. Por, me luftën hebreite të vitit 70 dhe rënien e Jeruzalemit, gjendja do të rrokulliset. Ja si e shpjegon kardinal Danieli fundin:

*"Pasi hebrejtë u diskretituan në Mbretëri, të krishterët përpigën që të shkëputen nga ata. Të krishterët helenistë do të marrin iniciativën: Pali do të korrë fitore postmorte; krishterimi sociologjikisht dhe politikisht do të ndahet nga judaizmi; ai do të bëhet populli i tretë. Por, deri në kohën e revoltës së fundit hebreite, në vitin 140, hebreo-krishterimi do të ketë dominim kulturor".*

Prej vitit 70, në periudhën që datohet para vitit 110, do të krijohen Ungjijtë: i Markut, i Mateut, i Lukës dhe i Gjonit<sup>25</sup>. Ata nuk janë dokumentet e parakrishtere të shkruara: letrat e Palit janë shumë më të vjetra se ata. Sipas O. Culmanit, Pali në vitin 50 e ka rediguar letrën e vet drejtuar Selanikasve. Por ajo, pa dyshim, ka humbur disa vjet para se të përfundohej Ungjilli i Markut.

Figura më e diskutueshme e krishterimit, të cilën familja e Jezusit dhe apostujt që qëndruan në Jeruzalem bashkë me Jakobin e konsideronin tradhëtar të mendimeve të Jezusit- Pali, e ndërtoi krishterimin në dëm të atyre që Jezusi i mblodhi rreth vetes për ta përhapur mësimin e tij. Pasi nuk e kishte njohur Jezusin e gjallë, ai arsyetoi legjitimitetin e mendimit të tij, duke pohuar se Jezusi i është paraqitur në rrugë për në Damask. Është e lejueshme të bëhet pyetja çfarë do të ishte krishterimi pa Palin dhe mbi këtë temë do të mund të ndërtoheshin shumë hipoteza. Por, sa i përket Ungjijve, sikur mos të egzistonte lufta ndërmjet bashkësive që u bë me përçarjen e Palit, do të mund të vinim bast se sot nuk do t'i kishim shkrimet që i kemi. Duke u paraqitur në periudhën e luftës intensive ndërmjet dy bashkësive, këto "shkrime luftarake", siç i cilëson R.P. Kannengiesser, dolën nga shumësia e shkrimeve të publikuara mbi Jezusin, kur krishterimi i stilit palian ngadhënjeu përfundimisht dhe e përpiloi përmbledhjen e

vet të teksteve zyrtare, "*Kanonin*", i cili i përjashtoi dhe i gjykoi si të kundërta me besimin e vërtetë të gjitha dokumentat e tjera që nuk ishin në përputhje me linjën që e kishte zgjedhur Kisha.

Edhe pse judeo-krishterët nuk ishin bashkësi me ndikim, për ta dëgjohet akoma dhe flitet nën shprehjen e përgjithshme "*të hebraizmit*". Kardinal Danieli kështu e evokon fundin e tyre:

*"Të ndarë nga Kisha e Madhe, e cila gradualisht lirohet prej prangave hebraike, ata shpejt do të shkatërrohen në Perëndim, por gjurmët e tyre do të mund të ndiqen prej shekullit III deri në shekullin IV në Lindje, sidomos në Palestinë, Arabi, Transjordan, Siri, Mesopotami. Disa do t'i absorbojë Islami, që pjesërisht është trashigimtarë; disa do të lidhen me ortodoksët, duke e ruajtur përsëri bazën e kulturë semite, dhe diçka nga ata vazhdon të jetojë në Kishat e Etiopisë dhe të Kaldejes".*

### III

## KATËR UNGJIJTË BURIMET E TYRE HISTORIA E TYRE

Në shkrimet e kohës së fillimit të krishtërimit Ungjijtë përmenden shumë më vonë se veprat e Palit. Vetëm në gjysmën e shekullit II, më saktë pas 140 vjetësh, paraqiten dëshmi lidhur me përmbledhjen e shkrimeve të ungjilltarëve, kurse "*nga fillimi i shekullit të dytë shumë autorë të krishterë na tregojnë se e njohin numrin më të madh të letrave të Palit*". Këto konstatime, të paraqitura në Hyrjen në përkthimin ekumenik të Biblës, Besëlidhja e Re (l'Introduction a la Traduction oecumenique de la Bible, Nouveau Testament), botuar më 1972, meritojnë të përmenden menjëherë, siç është e dobishme të nënvizohet se vepra në të cilën bazohemi është rezultat i punës kolektive, që ka mbledhur më shumë se njëqind specialist katolikë dhe protestantë.

Ungjijtë, të cilët më vonë do të bëhen zyrtarë, d.m.th.kanonikë, u bënë të njohur shumë vonë, edhe pse redaktimi i tyre ka qenë bërë që në fillim të shekullit II. Sipas përkthimit ekumenik, nga mesi i shekullit II fillojnë të citohen përmbajtjet që u takojnë, por "*gati gjithnjë është vështirë të konkludohet nëse citatet janë marrë nga tekstet e shkruara, që autorët i kanë pasur pranë vetes, apo janë kënaqur që me të kujtuar të evokojnë*



*fragmente nga tradita popullore".*

*"Para 140 vjetësh, lexojmë në komentimet e këtij përkthimi të Biblës, gjithsesi nuk ka egzistuar asnjë dëshmi sipas të cilës do të ishte njohur përmbledhja e shkrimeve të ungjilltarëve". Ky pohim është krejtësisht i kundërt me atë që shkruan A. Tricoti (1960) në komentimet e përkthimit të tij të Besëlidhjes së Re: "Shumë herët, në fillim të shekullit II, shkruan ai, iu bë e zakonshme që të thuhet Ungjijtë në mënyrë që të tregohen librat të cilët, rreth vitit 150, edhe shën Justini i quajti "Memoaret e apostujve". Për fat të keq konstatime të këtilla janë mjaft të shpeshta saqë publiku i gjerë të krijojë një pikpamje të shtrembër lidhur me datën e përmbledhjes së Ungjijve.*

Ungjijtë e përbëjnë një tërësi më shumë se një shekull pas misionit të Jezusit, por jo më herët. Përkthimi ekumenik i Biblës vlerëson se të katër Ungjijtë e kanë fituar statutin e literaturës kanonike rreth vitit 170.

Siç do të shihet, pohimi i Justin, me të cilin autorët e tyre kalifikohen si apostuj, gjithashtu nuk është më i lejueshëm në kohën tonë.

Sa i përket datës së redaktimit të Ungjijve, A. Tricoti deklaron se Ungjilli i Mateut, i Markut dhe i Lukës kanë qenë të redigjuar para vitit 70: kjo nuk mund të pranohet, përveç, ndoshta, për Ungjillin e Markut. Pas atyre vitesh ky komentues përpiqet t'i paraqesë autorët e Ungjijve si apostuj ose shoqërues të Jezusit dhe për këtë arsye i lëviz datat e redaktimit, duke i vënë shumë afër epokës në të cilën ka jetuar Jezusi. Sa i përket Gjonit, të cilin A. Tricoti e bën të jetojë edhe 100 vjet, të krishterët gjithnjë kanë qenë të mësuar që ta shohin se si në rastet festive është paraqitur shumë afër Jezusit, por është vështirë të thuhet se ai është autor i Ungjillit që mban emrin e tij. Apostulli Gjon (si edhe Mateu), për A. Tricotin dhe komentuesit e tjerë është dëshmitari i autorizuar dhe i kualifikuar i ngjarjeve për të cilat predikon, edhe pse shumica e kritikëve nuk e mbështesin hipotezën sipas të cilës ai do të bënte redigjimin e Ungjillit të katërt.

Por nëse katër Ungjijtë për të cilët është fjala nuk mund të konsiderohen "memoare" të apostujve ose të shoqëruesve të Jezusit, atëherë, cila është prejardhja e tyre?

O. Culman, në librin e tij *"Le Nouveau Testament" (Besëlidhja e Re)*<sup>27</sup>, për këtë temë shkruan se ungjilltarët kanë qenë vetëm "zëdhënës të bashkësisë primitive të krishterë, e cila i ka shkruar gojëdhënat popullore. Gjatë tridhjet apo dyzet vjetësh, Ungjijtë ekzistonin vetëm në formën gojore; tradita popullore përçonte sidomos fjalë dhe tradita të shkëputura. Ungjilltarët, secili në mënyrën e vet, secili sipas personalitetit të vet dhe preokupimeve të veta të veçanta teologjike, theksuan lidhjet ndërmjet

*tregimeve dhe fjalëve që i morën nga gojëdhënat përreth. Grupimi i fjalëve të Jezusit, si dhe lidhja e tregimeve me formula lidhëse mjaft të papërcakturara, siç janë "pas saj", "menjëherë" etj., shkurt "suaza" e Ungjijve sinoptikë është lloji i pastër letrar dhe nuk ka themel historik"<sup>28</sup>.*

Po ky autor vijon: *"Duhet të mbahet mend se nevojat e predikimit, të stërvitjes dhe të kultit, më shumë se interesi biografik, e çuan bashkësinë primitive në shënimin e kësaj gojëdhëne mbi jetën e Jezusit. Apostujt i ilustruan të vërtetat e fesë që predikonin duke i shjeguuar ngjarjet nga jeta e Jezusit dhe mu këto predikime të tyre u bënë shkas për shënimin e tregimeve. Vetë fjalët e Jezusit janë transmetuar sidomos në mësimin katekizmit<sup>29</sup> të Kishës primitive".*

Komentuesit e përkthimit ekumenik të Biblës nuk e evokojnë ndryshe kompozimin e Ungjijve: formimi i një tradite gojore nën ndikimin e predikimit të nxënësve të Jezusit dhe të predikuesve të tjerë, ruajtja e materialit, i cili, përfundimisht, do të gjendet në Ungjijtë përmes predikimit, liturgjisë, stërvitjes së besimtarëve, mundësisë për materializmin e hershëm në formë të shkruar të disa predikimeve fetare, të disa fjalëve të Jezusit, për shembull, tregimi mbi mundimin, dhënia e ungjilltarëve pas këtyre formave të ndryshme të shkrimeve aq sa edhe pas të dhënave të traditës gojore, për të krijuar tekste *"të përshtatshëm për mjedise të ndryshme, në përputhje me nevojat e Kishave, që shprehin mendime mbi Shkrimin (e Shenjtë), i përmirësojnë gabimet dhe japin përgjigjet e rastiit në argumentet e kundërshtarit. Kështu ungjilltarët mblodhën dhe shkruan, sipas prespektivës personle, atë që u ishte dhënë në traditën gojore".*

Një pikëpamje e tillë kolektive, që rrjedh nga mbi njëqind shpjegues të Besëlidhjes së Re, katolikë dhe protestantë, dallohet shumë nga linja që e ka përcaktuar Konkili i Dytë i Vatikanit në konstituimin e tij dogmatik mbi Shpalljen, i cili është elaboruar ndërmjet viteve 1962 dhe 1965. Më sipër kemi hasur në këtë dokument koncilor që ka të bëjë me Besëlidhjen e Vjetër. Konkili për të ka mundur të deklarojë që librat të cilat e përbëjnë *"përmbajnë mospërsosje dhe vjetërsim"*, por ai nuk ka shprehur dyshime të tilla kur është fjala për Ungjijtë. Por, përkundrazi, mund të lexohet kjo që vijon:

*"Askujt nuk i ka shpëtuar pa e vërejtur se ndër të gjitha Shkrimet (e Shenjta), edhe ato të Besëlidhjes së Re, Ungjijtë kanë superioritet të merituar, sepse paraqesin dëshminë par excellence mbi jetesën dhe mësimet e personifikimit të Fjalës së Shpëtimtarit tonë. Kisha e ka mbështetur dhe e mbështet gjithmonë dhe gjithkund prejardhjen apostolike të katër Ungjijve. Atë që apostujt vërtet e predikuan sipas urdhrat të Krishtit, më vonë ata dhe njerëz të tjerë nga mesi i tyre, nën frymëzimin*

*hyjnor të Shpirtit, e shndëruan në tregime që janë baza e fesë, dmth Ungjijtë katërformësh, sipas Mateut, Markut, Lukës dhe Gjonit".*

*"Nëna jonë e Shenjtë Kisha ka mbështetur fort dhe mbështet akoma me këmbëngulje më të madhe se këta katër Ungjij, historinë e të cilëve e vërteton pa mëdyshje, e transmetojnë besnikërisht atë që Jezusi, biri i Zotit, në gjallje të tij ka bërë vërtet mes njerëzve dhe ka mësuar për shpëtimin e tyre të amshueshëm, deri në ditën kur është ngritur në qiell... Domethënë, autorët e shenjtë i komponojnë katër Ungjijtë ashtu që për Jezusin gjithmonë na japin gjëra të vërteta dhe të sigjerta".*

Ky është pahim pa kurrëfarë dykuptimësie se Ungjijtë i transmetojnë besnikërisht veprat dhe fjalët e Jezusit.

Nuk shohim kurrëfarë pajtimi ndërmjet këtij pohimi të Koncilit dhe të atyre autorëve të cituar më sipër, sidomos:

*"nuk duhet më të kuptohen shprehimisht" Ungjijtë, "që janë ruajtur me shkrim traditat e bashkësive të veta mbi Jezusin". (R.P. Kannengiesser).*

Ungjijtë janë tekste "që u janë përshtatur mjedisve të ndryshme, në përputhje me nevojat e Kishës, të cilët shprehin meditimin mbi Shkrimin (e Shenjtë), i përmirësojnë gabimet, si dhe gabimet e rastësishme, përgjigjen në argumente të kundërshtarëve". Kështu ungjillatërt i mblodhën dhe i shkruan sipas prespektivës personale, atë që u dhënë me traditat gojore. (Përkthimi ekumenik i Biblës).

Është e qartë se me këtë deklaratë të Koncilit dhe me pikëpamjet e reja ndodhemi në mesin e dy pohimeve që kundërshtojnë njëra-tjetrën. Nuk është e mundur të pajtohet deklarata e Koncilit të Dytë të Vatikanit, sipas së cilës në Ungjijtë do të gjendej transmissioi besnik i veprave dhe fjalëve të Jezusit me ekzistimin e kundërtënieve, të gjërave të pabesueshme, të pamundësive materiale dhe të pohimeve të kundërta në këto tekste me realitetin të përcaktuara drejt.

Përkundrazi, nëse Ungjijtë shikohen si shprehje të prespektivave karakteristike për mbledhësit e traditave gojore, që u kanë takuar bashkësive të ndryshme, si të shkruar sipas rasteve ose luftarakisht, atëherë nuk mund të na habit fakti që në Ungjijtë i gjejmë tërë këto mangësi që janë shenjë se i kanë bërë njerëzit në kushte të atilla. Këta mund të jenë krejtësisht të sigjertë edhe pse transmetojnë ngjarje, pasaktësinë e të cilave as nuk e parashikojnë, duke na dhënë tregime mospajtuse me ato të autorëve të tjerë ose, për shkaqe të rivalitetit fetar ndërmjet bashkësive, paraqesin tregime nga jeta e Jezusit në një optikë krejtësisht të ndryshme

nga ajo e kundërshtarit.

Që më parë kemi vëretjur se konteksti historik është në përputhje me mënyrën e fundit të të kuptuarit të Ungjijve. Të dhënat me të cilat disponojmë lidhur me tekstet e vërtetojnë krejtësisht.

## UNGJILLI SIPAS MATEUT

Nga të katër Ungjijtë, i Mateut zë vendin e parë në rendin e prezantimit të librit të Besëlidhjes së Re. Kjo është plotësisht e arsyeshme, sepse ky Ungjill, në një farë mënyre, është vetëm vazhdim i Besëlidhjes së Vjetër: është shkruar që të tregohet se *"Jezusi e realizon historinë e Izraelit"*, siç shkruajnë komentuesit e Përkthimit ekumenik të Biblës, përkthim nga i cili do të huazojmë shumë. Për këtë Mateu merr shpesh citate nga Besëlidhja e Vjetër, duke treguar se Jezusi sillet si Mesia, të cilin e kanë pritur hebrenjtë.

Ky Ungjill fillon me gjenealogjinë e Jezusit. Mateu e shpie deri tek Abrahami, ndërmjet Davidit. Më vonë do të shohim gabimin në tekst, gabim për të cilin komentuesit heshtin. Sido që të jetë, shihet qartë qëllimi i Mateut që nëpërmjet kësaj lidhjeje menjëherë t'ia caktojë orientimin librit të vet. Autori e vazhdon po atë ide duke theksuar vazhdimisht qëndrimin e Jezusit ndaj ligjit hebraik, parimet e mëdha të të cilit, siç janë: lutja, agjërimi dhe mëshira, janë marrë nga ky ligj.

Jezusi dëshiron t'ia japë mësimin e vet popullit të vet dhe këtë e ka si detyrë të parë. Ai kështu iu thotë të dymbëdhjetë apostujve: **"Mos shkoni ndër paganë, as mos hyni në ndonjë qytet të samaritanëve<sup>30</sup>! Por shkoni më mirë te delet e humbura të shtëpisë së Izraelit"** (Mateu 10, 5-6). **"Unë jam i dërguar vetëm te delet e humbura të shtëpisë së Izraelit"** (Mateu 15, 24). Në fund të Ungjillit të vet, Mateu më vonë e zgjeron në të gjithë popujt apostolatin e nxënësve të parë të Jezusit dhe ia përshkruan këtë urdhër : **"Prandaj, shkoni t'i bëni nxënësit e mij të gjithë popujt"** (Mateu 28, 19), por shkuarja, para së gjithash, duhet të bëhet nga *"shtëpia e Izraelit"*. A. Tricoti për këtë Ungjill thotë: *"Nën petkun grek, libri me kokë e me shpirt është hebraik; ai ka atë shije dhe mbart ato shenja të qarta"*.

Ky shqyrtim, vetvetiu e vendos prejardhjen e Ungjillit sipas Mateut në traditën judeo-krishtere, e cila, siç shkruan O. Culmann, *"përpiqet t'i ndërpresë lidhjet që e lidhin me për judaizmin, duke e ruajtur sadopak vazhdimësinë me Besëlidhjen e Vjetër. Qendra e interesimit dhe zëri i përgjithshëm i këtij Ungjilli sugjerojnë ekzistimin e një situate të nderë"*.

Faktorët e llojit politik ndoshta nuk janë të huaj për tekstin. Pushtimi romak i Palestinës e bën jetësisht të natyrshme dëshirën e vendit të robëruar për ta parë ardhjen e lirisë dhe lut Zotin që të ndërmjetësojë në dobi të popullit, të cilin e ka zgjedhur midis popujve të tjerë, dhe që është Zoti i gjithfuqishëm i tyre, i cili mund të japë ndihmën e tij të drejtpërdrejtë në punën e njerëzve, siç ka bërë shumë herë deri më tani gjatë historisë.

Çfarë është personaliteti i Mateut? Ta themi menjëherë se sot nuk pranohet se është fjala për shoqëruesin e Jezusit. A. Tricoti e paraqet si të tillë në komentimin e vet të përkthimit të Besëlidhjes së Re të vitit 1960: *"Mateu , ose Levi, me profesion tagrambledhës ose financier, ka qenë nëpunës në doganën e Kafarnaumit kur Jezusi e thirri për ta bërë nxënës të vet"*. Kjo është ashtu siç kanë menduar etërit kishtarë, si Origeni, Jeronimi, Epifani. Në këtë nuk besohet më. E vetmja pikë e pakontestueshme është se autori është hebre: fjalori është palestinez, redaktimi është grek. Autori iu drejtohet, shkruan O. Culmann, *"njerëzve të cilët edhe pse flasin greqisht, i njohin zakonet hebraike dhe gjuhën arameje"*.

Për komentuesit e Përkthimit ekumenik, prejardhja e këtij Ungjilli duket si më poshtë:

*"zakonisht merret se është shkruar në Siri, ndoshta në Antioki (...) ose në Fenici, sepse në këto ka jetuar një numër i madh çifutësh (...). mund të hetohet polemika kundër judaizmit ortodoks sinagoianë në Jaminë, rreth vitit 80. Në këto kushte, janë të shumtë autorët që e datojnë Ungjillin e parë në vitet 80-90, ndoshta pak më përpara; nuk mund të arrihet deri te një siguri e plotë në këtë lëndë... në mungesë të njohjes së saktë të emrit të autorit, është e udhës të kënaqemi me disa elemente të nënvizuara në vetë Ungjillin: autori njihet sipas profesionit të tij. I udhëzuar në Shkrimet (e Shenjta) dhe në traditat hebraike, duke i njohur, duke i respektuar, por duke i qortuar ashpër udhëheqësit fetarë të popullit të vet, mjeshtër i shkathët në mësimin mbi Jezusin, për ta më të kuptueshëm për dëgjuesit e vet, atij t'i shkante mirë përshkrimi i një letrari hebraik, i cili është bërë i krishterë, zot shtëpie "që nxjerr nga visari i vet gjëra të reja dhe të vjetra", siç e evokon Mateu në 13, 52. Jemi shumë larg nga nënpunësi i doganës në Kafarnaum , të quajtur Levi, sipas Markut dhe Lukës, i cili është bërë njëri nga të dymbëdhjetë apostujt"*.

Të gjithë pajtohen me mendimin se Mateu e ka shkruar Ungjillin e vet mbi bazë të burimeve të përbashkëta me Markun dhe Lukën. Por tregimi i tyre do të ndryshojë, dhe ky ndryshim konsiston në pika qenësore, siç do ta shohim më poshtë. Por, përsëri, Mateu e ka shfrytëzuar shumë Ungjillin sipas Markut, i cili nuk ka qenë nxënës i Jezusit (O. Culmann).

Marku i lejon vetes liri serioze me tekstet. Do ta vërtetojmë këtë lidhur me

Besëlidhjen e Vjetër, lidhur me gjenealogjinë e Jezusit, që është vendosur në fillim të Ungjillit. Ai në librin e tij rendit tregime të pabesueshme. Ky është cilësori të cilin e përdor në veprën e cituar më sipër të R.P. Kannengiesser lidhur me një episod mbi ringjalljen e Krishtit; episodi i rojes. Ai zbulon se ky tregim është i pabesueshëm kur është fjala për rojën ushtarake afër varrit, *"të këtyre ushtarëve paganë"*, të cilët *"u raportojnë meshtarëve të mëdhenj që i paguajnë për të gënjyer, e jo eprorëve të tyre"*. Ai prap shton: *"Dhe duhet të ruhem nga tallja, sepse qëllimi i Mateut është jashtëzakonisht i pastër, meqë ai, sipas mënyrës së vet, e integron një të dhënë të vjetër nga tradita gojore në veprën e tij të shkruar. Po rinskenimi i tij është i denjë për Jezu Krishtin Superstar<sup>31</sup>".*

Ta rikujtojmë se ky gjykim mbi Mateun rrjedh nga një teolog eminent, profesor në Institutin Katolik të Parisit.

Në predikimet e tij mbi ngjarjet që e kanë ndjekur vdekjen e Jezusit, Mateu, jep një shembull tjetër të fantazisë së vet.

**"Ja! Perdja e tempullit shqyhet më dysh, nga maja gjer në fund; toka dridhet, shpellat shkatërrohen, kurse varret hapen, dhe kështu u ringjallën shumë trupa të të drejtëve që kishin pasë vdekur. Dolën nga varri pas ringjalljes së Jezusit, erdhën në Qytetin e Shenjtë dhe iu dëftuan shumë njerëzve".**

Ky fragment nga Mateu ( 27, 51-53) nuk ka paralele në Ungjijtë e tjerë. Është pak e kuptueshme se si kanë mundur trupat e të shenjtëve, për të cilët është fjala, të ringjallen gjatë kohës së vdekjes së Jezusit (në prag të sabati, thonë Ungjijtë) dhe të dalin nga varret e veta pas ringjalljes së tij ( një ditë pas sabatit, sipas po atyre burimeve).

Mund të bëhet që mu te Mateu ndeshet gjëja e pabesueshme më karakteristike dhe më pak kontestuese se në tërë Ungjijtë; atë njëri prej autorëve ja ka vënë në gojë vetë Jezusit. Ai, në episodin mbi shenjën e Jonës, 12, 38-40, flet kështu;

Jezusi ndodhet në mesin e letrarëve dhe të farisejve, të cilët i drejtohen me këto fjalë: **"Mësues, do të dëshironim prej teje të shohim shenjën!"** Jezusi përgjigjet: **"Shenjën kërkon breznia e prapët dhe lavire, por nuk do t'i jepet shenjë tjetër përveç shenjës së Jonës profet. Pasi Jona ka qenë në barkun e përbindëshit të detit tri ditë dhe tri netë, ashtu edhe Biri i Njeriut do të jetë në zemën e tokës tri ditë e tri netë"** (teksti i Përkthimit ekumenik).

Jezusi, domethënë, paralajmëron se do të qëndrojë në tokë tri ditë dhe tri net. Por, Mateu, e bashkë me të edhe Luka dhe Marku, e vendosin vdekjen

dhe varrosjen e Jezusit në prag të sabbatit, gjë që vërtet bën që qëndrimi në tokë të zgjatë tri ditë ( teis emersas, në tekstin grek). Por kjo shkëputje në kohë mund të zgjasë vetëm dy e jo tri net ( treis nuktas, në tekstin grek).

Komentuesit e Ungjillit e heshtin shpesh këtë episod. Por, R.P. Roge zbulon të pabesueshmen, sepse heton se Jezusi *"ka qenë në varr"* vetëm tri ditë ( prej të cilave vetëm njëra është e plotë ) dhe dy net. Por, shton ai, *"shprehja është e ngurtë dhe nuk do të thotë asgjë tjetër përveç tri ditë"*. Është e habitshme të vërtetohet se komentimet kanë bërë që të përdoren argumente të tilla që nuk flasin asgjë pozitive, sikur shpirti të kënaqej me sugjestionin se një budallallëk i tillë ka mundur të rrjedhë nga trillimi i një letrari!

Përveç këtyre gjërave të pabesueshme, Ungjillin sipas Mateut pikë së pari e karakterizon ajo se ky Ungjill i bashkësisë judeo-krishtere, e cila e shkëput lidhjen me judaizmin duke qëndruar megjithatë në linjën e Besëlidhjes së Vjetër. Nga pikëpamja e historisë judeo-kridhtere ajo ka rëndësi të madhe.

## UNGJILLI SIPAS MARKUT

Ky Ungjill është më i shkurtër se tre të tjerët. Njëkohësisht është më i vjetri, por nuk është për këtë arsye libër i një apostulli: ky është më së paku një libër i reduktuar nga nxënësi i një apostulli.

O. Culmann ka shkruar se Markun nuk e konsideron nxënës të Jezusit. Por, kujt i duket i dyshimtë autorësia e këtij Ungjilli, e një apostulli, Markut, ai tërheq vërejtjen; "Mateu dhe Luka nuk do ta shfrytëzonin këtë Ungjill, si kanë vepruar, sikur ai mos të ishte mbështetur vërtet në mësimet e një apostulli".

Por, ky nuk është argument vendimtarë. O. Culmann, si vërtetim të dyshimtë të tij, njësoj thotë se në Besëlidhjen e Re shpesh përmendet njëfarë *"Gjoni, i quajtur Mark"*, por këta shembuj nuk përmbajnë kujtime për autorin e Ungjillit, kurse vetë teksti i Markut nuk e përmend autorin.

Njohuritë e pakta të informacioneve lidhur me këtë çështje i ka detyruar komentuesit që si element me rëndësi të marrin hollësitat të cilat duken të

pabesueshme, si është kjo: nën preteksin se Marku është i vetmi ungjilltar i cili në tregimin e vet mbi Mundimin e tregon episodin për një djalosh, që për rrobë ka pasur vetëm çarçaf dhe i cili, kur provuan ta kapnin, e lë çarçfin dhe ikën (Marku 14, 51-52), disa kanë nxjerrë përfundime se ky djalosh ka mundur të jetë Marku, "*nxënësi besnik që përpiqej t'i shkonte pas mësuesit*" (Përkthimi ekumenik); sipas të tjerëve, "*në këtë kujtim personal mund të shihen shenja të origjinalitetit, një nënshkrim anonim*", "*i cili vërteton se ai ka qenë dëshmitarë*" (O. Culmann).

Sipas këtij autori, "*ndryshimet e shumta të fjalive e vërtetojnë hipotezën sipas së cilës autori do të ishte me preardhje hebraike*", po prania e latinizmave mund të sugjerojë se ai e ka shkruar Ungjillin e vet në Romë. "*ai, në fund të fundit, ju drejtohet të krishterëve që nuk jetojnë në Palestinë dhe kujdeset që t'ju shpjegojë shprehjet arameike që i përdor*".

Me të vërtetë, tradita dëshironte ta nxirrte Markun si shoqërues të Pjetrit në Romë, duke e mbështetur këtë në letrën e parë të Pjetrit (nëse ai është vërtetë autori i saj). Pjetri u ka shkruar atyre që u dedikohet letra: "*Bashkësia e të zgjedhurve në Babiloni ju përshëndet si dhe djali im, Marku*". Përkthimit ekumenik, prej nga konsiderohet se lejohet të nxirret përfundimi se Marku, i cili ka qenë me Pjetrin në Romë, është ungjilltarë... a thua një rezonim i këtyre e ka shtyrë Papinë, ipeshkvin e Hieropolisit, që rreth vitit 150 t'ia përshkruajë ungjillit, për të cilin është fjala, një Marku për të cilin thonë se ka qenë jo vetëm "*përkthyes i Pjetrit*", por edhe bashkëpunëtor i Palit?

Nga kjo perspektiv, ungjilli sipas Markut datohet pas vdekjes së Pjetrit, domethënë ndërmjet viteve 65 dhe 70, sipas Përkthimit ekumenik, kurse rreth vitit 70, sipas O. Culmannit.

Vetë teksti shpreh mangësinë e parë të madhe: ai është redaktuar pa kurrfarë kujdesi për kronologjinë. Kështu Marku në fillim të tregimit të vet (1, 16-20) vendos episodin mbi katër peshkatarët, të cilët Jezusi i bën pasues duke thënë thjesht: "*Do t'ju bëj peshkatarë njerëzish*", edhe pse nuk i ka njohur fare. Ungjilltari, përveç kësaj, tregon se i mungon tërësisht fuqia bindëse.

Siç e ka thënë R.P. Roge Marku është "*shkrimtar i ngathët*", "*ungjillari më i mjerë*", ai nuk di fare ta komponojë rrëfimin; kometuesi e ilustron vërejtjen e tij duke e cituar një fragment që shpjegon për institucionin e dymbëdhjetë apostujve, përkthimi i të cilit shprehimisht është si më poshtë: "**Pastaj u ngjit në një mal dhe thirri ata që deshi vetë. Ata shkuan tek ai. Dhe i emëroi të dymbëdhjetë që ta shoqërojnë, që t'i dërgoi të predikojnë dhe të kenë pushtet t'i dëbojnë djajtë. I emëroi këta të**



**Dymbëdhjetët: Simonin, të cilit ia dha emrin Pjetër" ( Marku 3, 13-16).**

Në disa episode ai është në kundërshtim me Mateun dhe Lukën, siç e kemi thënë më sipër me rastin e shenjës së profetit Jon. Aq më tepër, lidhur me shenjat që Jezusi ju jep njerëzve gjatë misionit të tij, Marku predikon (8, 11-12) një episod të cilit nuk mund t'i besohet :

**"Atëherë erdhën farisenjtë dhe filluan të diskutojnë me të, duke kërkuar nga ai ndonjë shenjë prej qellit, me qëllim që ta sprovonjë<sup>32</sup>. Ai duke fsharë prej fundit të shpirtit, tha: "përse ky brez kërkon shenjë? Me të vërtetë, po ju them, këtij brezi asesi nuk do t'i jepet shenjë". Atëherë i la, përsëri hyri në Anije dhe kaloi në bregun tjetër".**

Ky është pa dyshim pohimi që vjen nga Jezusi lidhur me qëllimin e tij që të mos bëjë kurrëfarë vepre e cila do të mund të dukej e mbinatyshme. Kështu komentuesit e Përkthimit Ekumenik të Biblës, duke u çuditur që Luka deklaroi se do të japë vetëm një shenjë - të Jonës profet (shih Ungjillin sipas Mateut), konsiderojnë se është "*paradoksale*" ajo që Marku u thotë : "*asesi nuk do t'i jepet shenjë këtij brezi*", pas "*çudirave që i paraqitet si shenjë vetë Jezusi*", vërejnë ata. (Luka, 7, 22 dhe 11, 20).

I tërë Ungjilli sipas Markut është pranuar zyrtarisht si kanonik, por autorët modernë thonë se fundi i Ungjillit të tij (16, 9-20) është shtuar më vonë. Përkthimi Ekumenik e sinjalizon këtë në mënyrën mjaft eksplicite.

Ky fund nuk është përfshirë në dy dorëshkrimet komplete më të vjetra të Ungjijve, Codexu Vaticanus dhe Codexu Sinaiticus, që datojnë nga shekulli IV. O. Culmann me këtë rast shkruan:

*"Dorëshkrimet e reja greke dhe disa versione e kanë shtuar në këtë vend një përfundim mbi tregimet që nuk janë të Markut, por që janë nxjerrë nga Ungjijtë e tjerë". Me të vërtetë, versionet e këtij të fundit të shtuar janë të shumta. Në tekste ekziston herë një version i gjatë, herë një i shkurtër (që të dy versionet janë të reproduktuar në Përkthimin Ekumenik), herë versioni i gjatë me një shtesë, herë të dy versionet.*

R.P. Kannengiesser e komenton kështu këtë të fundit: "*Duhet patjetër që të jenë nxjerrë jashtë vargjet e fundit gjatë kohës së pritjes zyrtare (ose botimet e dedikuara për publikun e gjerë) të veprës së tij në bashkësinë që ka garantuar për të. As Mateu, as Luka, as a fortiori Gjoni nuk e kanë njohur pjesën që ka munguar. Por, përsëri, zbrazëtia ka qenë e palejueshme. Shumë më vonë, kur shkrimet e ngjashme sipas Mateut, Lukës dhe Gjoni u bënë të mundshme të lexohen nga të gjithë, është hartuar një përfundim i denjë i Ungjillit të Markut, duke marrë elemente majtas e*

*djathtas prej ungjilltarëve të tjerë. Do të mund t'i gjenim lehtë pjesët e kësaj përmbledhjeje duke e ndarë pjesë pjesë Ungjillin e Markut (16, 9-20). Do të kishim një pasqyrë me konkrete të lirisë me të cilën është trajtuar lloji letrar i të rëfyerit ungjilltar deri në prag të shekullit II".*

Çfarë pranimi të hapët të ekzistimit të shpërdorimeve të njeriut në tekstet e Shkrimeve (të Shenjta) na ofrojnë këto pasqyrime të një teologu të madh!

## UNGJILLI SIPAS LUKËS

*"Kronisti", sipas O. Culmann, "romancieri i vërtetë", sipas R.P. Kannengiesseri, Luka në prologun e tij drejtuar Theofilin na njofton se ai pas shumë të tjerëve që kanë hartuar tregime mbi Jezusin, do të shkruajë një tregim mbi të njëjtat ngjarje duke i shfrytëzuar tregimet dhe informacionet e dëshmitarëve të ngjarjes - gjë që tregon se ai nuk është njëri ndër ta - si dhe ato që rrjedhin nga predikimet e apostujve. Kjo, domethënë, është punë metodike e tij që e tregon me këto shprehje:*

*"Meqë shumë janë përpjekur t'i sistemojnë rrëfimet mbi ngjarjet që kanë ndodhur ndër ne, ashtu siç na kanë treguar ata që ishin dëshmitarë të ngjarjeve që nga fillimi dhe shërbëtorë të Fjalës, edhe mua më bëri mirë, dhe, pasi i shqyrtova më vëmendje që nga fillimi, t'i shkrova ty me rradhë, shkëlqesi Theofil, që të bindesh plotësisht mbi sigurinë e mësimit që e ke marrë".*

Që nga rreshtat e parë kuptohet e tërë ajo që e ndan Lukën nga *"shkrimtari shumë i vogël"*, siç është Marku, veprën e të cilit sapo e përmendëm. Ungjilli i tij është vepër letrare e pakontestueshme, e shkuar me një greqishte klasike pa barbarizma.

Luka është shkrimtari pagan i kthyer në krishtërim. Qëndrimi i tij ndaj hebregjeve bie në sy menjëherë. Siç e thekson këtë O. Culmanni, Luka nuk i merr nga Marku vargjet në të cilat ka më shumë judaizëm dhe thekson fjalët e Jezusit kundër mosbesimit të hebregjeve dhe marrëdhëniet e tij të mira me samaritanët, që janë urrejtur nga hebregjtë, kurse sipas Mateut, e pamë më sipër, Jezusi ka kërkuar nga apostujt që të ikin prej tyre. Një shembull tronditës, ndër shumë shembuj të tjerë, për faktin se ungjilltarët duke vënë në gojën e Jezusit atë që u është përgjigjur prespektivave të tyre, me bindje thellësisht të padyshimita, japin versionin e fjalëve të Jezusit në përshtatje me pikëpamjet e bashkësive të cilave u kanë takuar. Si të mohohet që Ungjijtë janë *"shkruar luftarakisht"* ose *"sipas rasteve"* të përmendura më

sipër, kur ekzistojnë kaq shumë fakte të qarta? Krahasimi ndërmjet mënyrës së përgjithshme të shprehjes së Ungjijve sipas Lukës dhe të atij sipas Markut është një dëshmi për këtë.

Kush është Luka? Kanë dashur ta identifikojnë më mjekun që mban këtë emër, të cilin e citon Pali në disa letra të veta. Përkthimi Ekumenik thekson *"shumë veta nga përshkrimi i saktë i të sëmurit vërtetuan se autori i Ungjillit është me profesion mjek"*. Ky mendim është krejtësisht i tepruar. Luka nuk bën *"përshkrime"* të këtij lloji në kuptimin e mirëfilltë të fjalës; *"fjalori që e përdor ai është i një njeriu të ngritur të kohës së tij"*. Një farë Luka ka qenë udhëtar shoqëruar i Palit. A thua mos është ky po ai person? O. Culmanni mendon se po.

Data e Ungjillit sipas Lukës mund të vlerësohet sipas faktorëve të ndryshëm: Luka është shërbyer me Ungjillin sipas Markut dhe me atë sipas Mateut. Duket, lexojmë në Përkthimin Ekumenik, se ka përjetuar rrethimin dhe shkatërrimin e Jeruzalemit nga armata e Titusit, në vitin 70. Domethënë, Ungjilli është më i vonshëm se kjo datë. Kritikat e sotme e vendosin redaktimin e tij në vitet 80-90, por shumë të tjerë përmendin dhe data më të hershme.

Mënyrat e ndryshme të të rrëfyerit të Lukës tregojnë dallime të theksuara në krahasim me ato të paraardhësve të tij. Më sipër e kemi dhënë pasqyrën e tyre të shkurtër. Përkthimi Ekumenik në faqen 181 e në faqen pasuese i sinjalizon këto. O. Culmanni në faqen 18 të librit të tij *"Nouveau Testament"* (Besëlidhja e Re) citon tregimin nga Ungjilli sipas Lukës, që nuk janë gjetur tek të tjerët. Këtu nuk është fjala aspak për çështje të dorës së dytë.

Tregimet mbi fëmijërinë e Jezusit nga Ungjilli sipas Lukës janë të tija. Mateu e predikon ndryshe nga Luka fëmijërinë e Jezusit. Marku për këtë nuk thotë asnjë fjalë.

Mateu dhe Luka japin gjenealogji të ndryshme të Jezusit: kundërthënia është aq shumë me rëndësi, gjëra të pabesueshme aq të mëdha nga pikëpamja shkencore, saqë, në këtë libër, kësaj do t'i kushtohet një kapitull të veçantë. Është e kuptueshme që Mateu, duke ju drejtuar hebregjeve, e fillon gjenealogjinë prej Abrahamit dhe e vazhdon ndërmjet Davidit, kurse Luka, pagan i konvertuar, kujdeset që ta çojë edhe më lart. Por, do të shihet se duke filluar nga Davidi, dy gjenealogjitë e kundërshtojnë njëra-tjetrën.

Në shumë çështje, Luka, Mateu dhe Marku e tregojnë ndryshe profetësinë e Jezusit.

Një ngjarje me rëndësi kapitale për të krishterët, siç është themelimi i

Eukaristisë, është temë me variantet e Lukës dhe të dy ungjilltarëve të tjerë. R.P.Roge në librin e tij *"Initiation a l'Evanglie"* (Hyrje në Ungjijtë fq. 75) vëren se fjalët me të cilën është themeluar Eukaristia Luka (22, 19-24) i ka transmetuar krejtësisht ndryshe nga fjalët që i gjejmë tek Mateu (26, 26-29) dhe te Marku (14, 22-24), te të cilët janë gati të njëjta. *"Përkundrazi, formula të cilën e transmeton Luka është shumë e afërt me atë që e përmend shën Pali"* (letra e parë Koritianëve, 11, 23-25).

Siç e pamë, Luka i vë në qarkullim fjalët mbi shëlbimin e Jezusit, që janë në kundërshtim me atë që është thënë në Veprat e Apostujve, autori i të cilave është pranuar, dhe që janë pjesë përbërëse të Besëlidhjes së Re. Në Ungjillin e vet, ai e vendos shëlbimin në Ditën e Ringjalljes, kurse në Veprat, dyzet ditë më vonë. E dimë se çfarë komentime të çuditshme kanë bërë ekzegetët e krishterë lidhur me kundërthëniet.

Por komentuesit që kujdesen të jenë objektivë janë të detyruar të pranojnë, ashtu siç e bëjnë ata të Përkthimit Ekumenik se në planin e përgjithshëm për Lukën *"nuk është brenga e parë përshkrimi i ngjarjeve në vërtetësinë e tyre materiale..."*.

Duke i krahasuar tregimet mbi Jezusin e ringjallur nga Veprat e Apostujve, nga po ky Lukë, me tregimet analoge të ngjarjeve sipas Palit, R.P. Kannengiesseri jep për Lukën jK}ë mendim; *"Nga të katër ungjilltarët Luka është më i ndjeshmi dhe më letrari, ai i ka të gjitha cilësitë e një romancierit të vërtetë"*.

## UNGJILLI SIPAS GJONIT

Ungjilli sipas Gjonit ndryshon në mënyrë radikale nga tre të tjerët aq sa R.P. Roge, në librin e tij *"Initiation a L'Evangile"*, pas komentimit të tre të tjerëve, jep menjëherë një figurë ekspresive të Ungjillit të katërt: *"një botë tjetër"*. Ky është me të vërtetë një libër i veçantë: është i ndryshëm në renditjen dhe zgjedhjen e temave, të tregimeve, në stil, në të dhënat gjeografike dhe kronologjike, por edhe në prespektivat teologjike (O.Culmann). Gjoni dhe ungjilltarët e tjerë i transmetojnë fjalët e Jezusit në mënyrë shumë të ndryshme; R.P.Roge lidhur me këtë tërheq vërejtjen se derisa ungjijtë sinoptikë i transmetojnë fjalët e Jezusit në stil *"goditës, shumë më të afërt me stilin gojor"*, te Gjoni stili është meditues deri në atë masë sa që *"ndonjëherë mund të pyesim a thua akoma po flet Jezusi apo fjalët e tij pahetueshëm janë zgjatur nga meditimet e ungjilltarit"*.

Kush është autori? Çështja është diskutuar shumë dhe lidhur me këtë janë vënë në qarkullim mendime nga më të ndryshmet.

A.Tricoli dhe R.P.Roge janë ndër ata që nuk i prek as dyshimi më i vogël: Ungjilli sipas Gjonit është vepër e dëshmitarit të ngjarjes; autori është Goni, biri i Zebetit dhe vëlla i Jakovit, apostull, për të cilin dimë hollësisht që janë dhënë në doracakët, të cilët i janë kushtuar publikut të gjerë. Ikonografia popullore e vendos afër Jezusit, si në kohën e darkës së fundit, që i ka paraprirë Mundimit. Kush do të mund të mendonte se Ungjilli sipas Gjonit nuk është vepër e këtij Gjoni, apostull, figura e të cilit është aq shumë e përhapur?

Redaktimi shumë i vonshëm i këtij Ungjilli të katërt nuk është argument formal kundër një pikëpamje të tillë. Versioni definitiv duhet të jetë i redaktuar patjetër nga fundi i shekullit I. Vendosja e redaktimit gjashtëdhjet vjet pas Jezusit do të ishte në përputhje me ekzistimin e një apostulli shumë të ri në kohën e Jezusit, i cili do të jetonte afër një shekull. Në studimin e vet mbi Ringjalljen, R.P. Kannengiesseri arrin në përfundimin se asnjë autor i Besëlidhjes së Re, përveç Palit, nuk mund të thotë për vete se është dëshmitar i ringjalljes së Jezusit. Por, përsëri, Gjoni e përshkruan dëftimin e Jezusit para apostujve, ndër të cilët do të ketë qenë edhe ai, kur ishin të gjithë së bashku, përveç Tomës (20, 19-24), pastaj tetë ditë më vonë të gjithëve së bashku (20, 25-29).

O.Culmann në librin e tij "*Le Nouveau Testament*" nuk përcaktohet.

Përkthimi Ekumenik i Biblës i saktëson se pjesë më e madhe e kritikëve nuk e mbështet hipotezën mbi redaktimin e apostullit Gjon, edhe pse kjo mundësi, përkundër të gjithave, nuk mund të jetë krejt e përjashtuar. Por çdo gjë tregon se ka pasur ndërhyrje, sepse teksti që sot është në lexim ka shumë autorë: "*Mund të bëhet që Ungjijtë, këta që i kemi tani, i kanë botuar nxënësit e autorëve që ja kanë shtuar kapitullin 21, dhe, pa dyshim, disa shënime (Kështu 4, 2 dhe ndoshta 4, 1; 4, 44; 7, 375; 11, 2; 19, 35). Përsa i përket tregimit mbi gruan që shkel kurorën (7, 53-8), të gjithë pajtohen me atë se është fjala për pjesën me prejardhje të panjohur që është futur më vonë (por që i takon Shkrimin kanonik). Paragrafi 19, 35 paraqitet si "nënshkrim i dëshmitarit të ngjarjes" (O. Culmann) dhe është i vetmi që është i qartë në tërë Ungjillin sipas Gjonit; por komentuesit mendojnë se ai me siguri është shtuar më vonë.*

O. Culmanni mendon se shtesat e mëvonshme janë të qarta në këtë Ungjill; i tillë është kapitulli 21, që ka qenë vepër e një "nxënësi", i cili, gjithashtu, "*e ka retushuar pjesën kryesore të Ungjillit*".

Pa i përmendur të gjitha hipotezat e tjera të ekzegetëve, vetëm vërejtjet e

autorëve të krishterë më të njohur që i kemi përmendur këtu lidhur me çështjen e autorit të Ungjillit të katërt, tregojnë se në pikëpamje të kumbarisë kemi një konfuzion të plotë.

Vlera historike e tregimeve të Gjoni është kontestuar mjaft. Mospërputhjet me tre Ungjijtë e tjerë janë të hapta. O.Culmanni jep shpjegime për to. Ai pranon se Gjoni ka prespektiva të ndryshme teologjike nga ungjilltarët e tjerë. Ky qëndrim *"drejtohet nga zgjedhja e tregimeve të paraqitura të mësimit, si dhe nga mënyra me të cilin janë reproduktuar... Kështu autori shpesh vazhdon renditjen dhe vë në gojën e Jezusit historik atë që Shpirti i Shenjtë ja ka zbuluar vetë atij"*. Për këtë ekzeget shkaku i mospërputhjes është i tillë.

Me të vërtetë është e mundur të merret me mend se Gjoni duke shkruar pas ungjilltarëve të tjerë, i ka zgjedhur disa tregime të vetat që t'i ilustrojë më mirë tezat e veta dhe nuk do të duhet të çuditemi që te Gjoni nuk e gjejmë tërë atë që e përmbajnë treëgimet e tjera. Përkthimi Ekumenik zbulon një numër të konsiderueshëm të rasteve të këtij lloji (fq. 282). Por edhe më shumë të habitin disa zbraçeti. Disa duken fare pak të mundshme, siç është ajo nga tregimi i themelimit të Eukaristisë. Siç mund të merret me mend që një episod aq i rëndësishëm për krishtërimin, i cili do të bëhet shtyllë e liturgjisë së tij: meshën, nuk e ka përmendur Gjoni, ungjilltari meditativ par excellence? Por, ai kënaqet me atë që në predikimin e asaj darke që i ka paraprirë Mundimit të përshkruajë vetëm larjen e këmbëve të nxënësve, paralajmërimin e tradhëtisë së Judës dhe mohimin e Pjetrit.

Përkundrazi, ka tregime që janë karakteristike për këtë, kurse mungojnë tek të tre ungjilltarët e tjerë. Përkthimi Ekumenik i përmend (fq. 283). Edhe këtu mund të përfundojmë se të tre autorët mund të mos e kuptojnë rëndësinë që e ka zbuluar Gjoni në këto episode. Por, si të mos habitemi që tek Gjoni gjejmë tregime mbi Jezusin e ringjallur në bregun e liqenit të Tiberiadit (Gjoni, 21, 1-14), që është vetëm reproduktim, me shumë hollësira të shtuara më vonë, të gjuetisë së çuditshme që e ka treguar Luka (5, 11), një episod që ka ngjarë në ringjallje të Jezusit. Në këtë tregim Luka aludon në praninë e apostullit Gjon, i cili, sipas traditës, ka qenë ungjilltar. Pasi ky tregim nga Ungjilli sipas Gjoni përbën një pjesë të kreut 21, për të cilin pajtohen se është shtesë e mëvonshme mund të marrim me mend lehtë se përmendja e emrit të Gjoni në tregimin e Lukës mund të mendohet se ndërthuret artificialisht në Ungjillin e katërt: nevoja që për këtë tregim mbi ngjarjen në ringjallje të Jezusit të ndërrohet në tregim të mbasvdekjes nuk e ka ndaluar shpërdoruesin e teksit të Ungjillit.

Një mospërputhje tjetër e rëndësishme ndërmjet Ungjillit sipas Gjoni dhe tre të tjerëve është kohëzgjatja e misionit të Jezusit. Marku, Mateu dhe Luka e vendosin në një vit kurse Gjoni e zgjatë mbi dy vjet. O.Culmanni e

vëren këtë fakt. Për këtë çështje ja si shprehet Përkthimi Ekumenik:

Derisa Ungjijtë sinoptikë zhvillojnë periudhë të gjatë galilease, pas së cilës vjen një ecje pak a shumë e gjatë në drejtim të Judesë, dhe më në fund një qëndrim i shkurtër në Jeruzalem. Gjoni, përkundrazi, flet për transferime të shpeshta nga një krahinë në tjetrën dhe vëren praninë e përzgatur në Jude e sidomos në Jeruzalem (1, 19-51; 2, 13-3, 36; 5, 1-47; 14, 20-31). Ai përmend shumë kremtime të Pashkëve (2, 13; 5, 1; 6, 4; 11, 55) dhe kështu sugjeron profeci më të gjatë se dy vjet.

Pra, kujt duhet t'i besojmë: Markut, Mateut, Lukës apo Gjoni?

## BURIMET E UNGJIJVE

Kjo pasqyrë e përgjithshme e shkurtër që del nga shqyrtimi kritik i teksteve të Ungjijve na shpie drejt konceptimit të një literature "*të palidhshme*", "*plani i të cilës nuk ka vazhdimësi*" dhe "*kundërthëniet e të cilave duken të pakalueshme*", t'i huazojmë shprehjet nga gjykimi i komentuesit të Përkthimit Ekumenik të Biblës, në autoritetin e të cilit mund të mbështetemi, sepse mendimet për këtë lëndë janë shumë të rënduara nga pasojat. E pamë se njohja e historisë së fesë nga koha e lindjes së Ungjijve mund të na shpjegojë disa karakteristika të kësaj literature, e cila i habit lexuesit që janë të prirur të mendojnë. Por, vlen të shkojmë më tej dhe të kërkojmë atë që mund të mësojmë nga punimet e publikuara në kohën bashkëkohore lidhur me punimet nga të cilët ungjilltarët kanë marrë lëndën për t'i redaktuar tekstet e veta: njësoj është interesant të shihet nëse historia e teksteve pas zyrtarizimit të tyre mund të shpjegojë disa aspekte që i ofrojnë sot.

Në kohën e Etërve Kishtarë çështjes së burimit i është afruar në mënyrë shumë të thjeshtë. Në shekujt e parë të erës së krishterë burim ka mundur të jetë vetëm Ungjilli, i cili në dorëshkrimet komplete ka qenë vendosur në vendin e parë, dmth Ungjilli sipas Markut. Çështja e burimit është shtruar vetëm për Markun dhe Lukën, pasi Gjoni ka qenë problem i veçantë. Shën Agustini ka konsideruar se Marku, i dyti sipas rendit tradicional të paraqitjes, është frymëzuar nga Mateu, të cilin e ka remizuar, kurse Luka, i cili në dorëshkrimet (manuskripte) është në vendin e tretë, është shërbyer me të dhëna të njërit dhe të tjetrit: këtë e sugjeron prologu i tij, për të cilin kemi folur më sipër.

Ekzegetët e kësaj kohe kanë mundur njësoj si edhe ne sot të vlerësojnë

shkallën e përputhshmërisë së teksteve dhe të gjejnë një numër të madh vargjeve që janë të përbashkëta në dy ose tre Ungjij sinoptikë. Komenutesit e Përkthimit Ekumenik të Biblës për afërsisht kështu i vlerësojnë me numra:

- 330 vargje të përbashkëta në të tre Ungjijtë sinoptikë.

- 178 vargje të përbashkëta të Markut dhe Mateut;

- 100 vargje të përbashkëta të Markut dhe Lukës;

- 230 vargje të përbashkëta të Mateut dhe Lukës;

kurse prej të gjitha vargjeve të tre ungjilltarëve të parë 330 vargje i takojnë Mateut, 53 Markut dhe 50 Lukës.

Nga Etërit Kishtarë e deri në fund të shekullit XVIII ka kaluar një mijëvjeçar e gjysëm dhe nuk ka lindur ndonjë problem i ri lidhur me burimet e ungjilltarëve; është pranuar tradita. Por, në kohën bashkëkohore, duke i ditur këto të dhëna, u kuptua se secili ungjilltar, duke marrë informacionet që i gjente tek të tjerët, në të vërtetë e ndërtoi tregimin në mënyrën e vet, sipas pikëpamjeve të veta. Atëherë i është kushtuar një kujdes i rëndësishëm grumbullimit të materialeve të tregimit në traditën gojore të bashkësisë primitive, nga një anë dhe në një burim të shkruar të përbashkët arameik, i cili nuk është gjetur, në anën tjetër. Ky burim i shkruar ka mundur të përbëjë një bllok kompakt ose të jetë i përbërë nga fragmente të komplikuar të tregimeve të ndryshme që kanë mundur t'i shërbejnë secilit ungjilltar për ta ndërtuar veprën e vet origjinale.

Kërkimet më të thelluara që kanë filluar afërsisht para një shekulli sollën teori më të sakta, të cilat do të komplikohen me kalimin e kohës. Teoria e parë bashkëkohore është teoria e quajtur "*dy burimet e Holtzmanit*" (1863). Sipas saj, siç e saktësojnë O.Culmanni dhe Përkthimi Ekumenik, Mateu dhe Luka janë frymëzuar prej Markut, në një anë, dhe prej një dokumenti të përbashkët që sot ka humbur, në anën tjetër. Për më tepër, dy ungjilltarët e parë do të kishin në dispozicion nga një burim personalisht të vetin. Kështu vijnë deri te skema e mëposhtme.

### **Skema**

Culmanni e kritikon skemën në këto pika:

1. Vepra e Markut, të cilën e kanë përdorur Luka dhe Mateu, nuk do të ishte Ungjilli i këtij autori, por ndonjë redaktim më i hershëm;
2. Kjo skemë nuk i kushton kujdes të duhur traditës gojore, e cila paraqitet



si kryesore, pasi vetë, me kalimin e kohës prej tridhjetë apo dyzet vjetësh, i ka ruajtur fjalët e Jezusit dhe tregimet mbi misionin e tij, kurse ungjilltarët kanë qenë vetëm raportues të bashkësisë së krishterë, e cila e ka fiksuar traditën gojore.

Kështu arrijmë të kuptojmë se Ungjijtë që i kemi sot kanë sjellë pasqyrën e asaj që bashkësitë e krishtera primitive kanë ditur për profertësinë e Jezusit, si dhe besimin dhe konceptonet e tyre teologjike, raportues të të cilave kanë qenë ungjilltarët.

Kërkimet më bashkëkohore të kritikës lidhur me burimet e Ungjijve kanë zbuluar një proces akoma më kompleks të formimit të teksteve. "*Krahasimi i katër Ungjijve*", vepër e R.P. Benoitit dhe R.P. Boismardit, profesorë së Shkollës Biblike të Jeruzalemit (1972 deri 1973), e vë theksin në zhvillimin e teksteve nëpër shumë etapa, paralelisht me zhvillimin e traditës, gjë që ka sjellë deri në pasojat që R.P. Benoitit, duke paraqitur një pjesë të librit që është vepër e R.P. Boismardit, e shpreh me këto fjalë: "*(...) format e fjalëve ose të tregimeve që rrejdhin nga evolimi i gjatë i traditës nuk e kanë origjinalitetin e njëjtë si ato që kanë qenë në fillim disa lexues të kësaj veprë ndoshta do të befasohen ose do të habiten kur të kuptojnë se kjo ose ajo fjalë e Jezusit, kjo ose ajo parabolë, ky ose ai paralajmërim i fatit të tij, nuk janë thënë ashtu siç i lexojmë ne, por ato janë përmirësuar dhe përshtatur nga ata që na i kanë transmetuar. Për ata që nuk janë të mësuar me këtë lloj të kërkimit historik ka një burim të mundshëm për tu çuditur, ndoshta edhe skandal*".

Këto përmirësime të teksteve dhe përshtatja e tyre që është bërë nga ata që na i kanë transmetuar, janë bërë në mënyrë tepër komplekse dhe këtë e tregon skema të cilën në e jep R.P. Boismardi. Ajo është zhvillim i teorisë së të ashtuquajturës të dy burimeve. Skema është ndërtuar pas punës në hulumtimin dhe komparacionin e teksteve, të cilën këtu do të ishte e pamundur ta rezimojmë. Lexusi i interesuar do të duhej që për më shumë hollësira t'i referohej veprës origjinale që është botuar në Paris, në botimin Cerf.

Katër dokumentet bazë të quajtura A, B, C, dhe Q, paraqesin burimet origjinale të Ungjijve (shih skemën e përgjithshme).

Dokumenti A është dokument i cili rrjedh nga mjedisi judeo-krishterë dhe e ka frymëzuar Mateun dhe Markun.

Dokumenti B është riinterpretim të dokumentit A për nevojat të kishave pagane-krishtere: ai ka frymëzuar të gjithë ungjilltarët, përveç Mateut.

Dokumenti C e ka frymëzuar Markun, Lukën dhe Gjonin.

Dokumenti Q përmban shumicën e burimeve të përbashkëta për Mateun dhe Lukën; ky është "*dokument i përbashkët*" nga teoria e sipërpërmendur e dy burimeve.

Asnjëri nga këto dokumente bazë nuk qe shkaktar për redaktimin e teksteve përfundimtare që i kemi sot. Ndërmjet tyre dhe versionit përfundimtar vendosen redaktimet e ndërmjetme që autori i quan: Mateu intermedist, Marku intermedist, Luka i hershëm dhe Gjoni. Këto katër dokumente ndërmjetse do të sjellin gjer te redaktimet e fundit të katër Ungjijve, duke i inspiruar si redaksi përkatëse të fundit, ashtu dhe ato të Ungjijve të tjerë. Duhet parë skema kryesore në mënyrë që të kuptohen të gjitha veprimet komplekse të cilat autori i nxjerr në dritë.

Rezultatet e këtyre hulumtimeve biblike janë me rëndësi të madhe. Ato tregojnë se tekstet e Ungjijve jo vetëm që kanë "*historinë*" e tyre (për këtë do të flasim më poshtë), por edhe "*parahistorinë*" e tyre, sipas shprehjes së R.P.Boismardit, kjo do të thotë se para redaktimeve të fundit ata kanë pësuar ndryshime gjatë etapës së dokumenteve ndërmjetëse (intermediste). Kështu, për shembull, shpjegohet se si është e mundur që një tregim i njohur mirë nga jeta e Jezusit, siç është peshkimi i çuditshëm, të paraqitet nga Luka si ngjarje që ka ndodhur në gjallje të tij, kurse sipas Gjonit, si një episod i dëftimit të tij pas ringjalljes.

## **M.E. BOISMARD**

### **KRAHASIMI I KATËR UNGJIJVE**

#### **SKEMA E PËRGJITHSHME**

Dokumenti A,B,C,Q = dok.bazë që i kanë shërbyer redaktimit

Mt.interm. = Redaktimi i ndërmjetëm i Mateut

Mk.interm. = Redaktimi i ndërmjetëm i Markut

Proto-Lk = Redaktimi i ndërmjetëm i Lukës

In = Redaktimi i ndërmjetëm i Gjonit

Red.fund.Mt = Redaktimi i fundit i Mateut

Red.fund.Mk = Redaktimi i fundit i Markut

Red.fund.Lk = Redaktimi i fundit i Lukës

Red.fund.Gjn = Redaktimi i fundit i Gjonit

Si përfundim i tërë kësaj del se duke lexuar Ungjijtë nuk jemi më të sigurt se dëgjojmë fjalën

e Jezusit. R.P. Benoit, duke iu drejtuar lexuesit të Ungjijve, ia tërheq vërejtjen në këtë, por i ofron një kompensim:

*"Nëse në shumë raste duhet të heqë dorë nga ajo që të dëgjojë zërin e Jezusit, ai dëgjon zërin e Kishës dhe shpreson në të si në shpjguesin, të cilin hynisht e ka autorizuar Zotriu i cili, pasi dikur fliste në vendin tonë, tani flet për lavdinë e vet".*

Si të lidhet ky konstatim formal mbi mungesën e origjinalitetit të disa teksteve me fazën e konstatimit dogmatik mbi Shpalljen Hyjnore të Koncilit të Dytë të Vatikanit, i cili, përkundrazi, na bind për transmetimin e fjalëve të Jezusit: *"Këta katër Ungjij, historikun e të cilëve ajo (Kisha) e vërteton pa mëdyshje, e trasmetojnë besnikërisht atë që Jezusi, Bir i Zotit, në gjallje të tij, duke qenë mes njerëzve, vërtet ka bërë dhe i ka mësuar për shpëtimin e tyre të amshueshëm, deri në ditën kur u ngrit në qiell".*

Shihet krejt qartë se puna e Shkollës Biblike të Jeruzalemit i ka bërë një demant të rreptë deklaratës së Koncilit<sup>33</sup>.

## **HISTORIA E TEKSTEVE**

-

Do të ishte gabim të besohet se menjëherë pas redaktimit Ungjijtë kanë

krijuar Shkrimin e (Shenjtë) themelorë të krishterimit që po vinte, dhe se në ta janë mbështetur si në Besëlidhjen e Vjetër. Autoriteti kryesor atëherë ka qenë tradita gojore e cila transmetonte fjalën e Jezusit dhe mësimet e apostujve. Shkrimet e para që lexoheshin dhe që fituan shumë më përpara Ungjijve kanë qenë letrat e Palit: a nuk ishin redaktuar ato shumë dhjetëvjeçarë më parë?

Pamë se para vitit 140 nuk ekzistonte asnjë dëshmi e cila do të vërtetonte se ka qenë i njohur një përmbledhje i shkrimeve ungjillore, përkundër asaj çfarë shkruajnë akoma në kohën tonë disa komentues. Duhet pritur përafërsisht vitin 170, që të katër Ungjijtë të fitojnë statutin e literaturës kanonike.

Në këtë kohë fillestare të krishterimit kanë qarkulluar, gjithashtu, shkrime të shumta mbi Jezusin, të cilat më vonë nuk janë konsideruar si të denja për origjinalitetin dhe për të cilat Kisha ka dhënë urdhër që të fshihen, prej nga edhe janë quajtur apokrifë. Prej këtyre teksteve ka vepra që janë ruajtur mirë, meqë kanë "*gëzuar përkrahje e plotë*", na thotë Përkthimi Ekumenik ; si didake (mësimi i të dymbëdhjetë apostujve) ose letra e Barnabës, por të tjerat, për fat të keq, "*janë hequr në mënyrë brutale*" dhe prej tyre kanë ngelur vetëm fragmente. Duke u konsideruar si transmetuese të trillimeve, ato u hoqën para syve të besimtarëve. Por, përsëri, veprat siç janë Ungjilli i Nazaretasve, Ungjilli i Hebrejve, Ungjilli i Egjiptjanëve, të njohur për lidhjet me Etërit Kishtar, u lidhën njaft ngushtë me Ungjijtë me Ungjijtë kanonikë. Po kjo vlen edhe për Ungjillin e Tomës dhe Ungjillin e Barnabës.

Disa nga këto shkrime apokrifë përmbajnë pjesë fantazmogorike, të cilat janë produkt i imagjinatës popullore. Autorët e veprave mbi Apokrifët, me një kënaqësi të qartë, i citojnë fragmentet të cilat, thënë shkurt, janë qesharake. Por, fragmente të tilla mund të hasen në të gjitha Ungjijtë. Të përkujtojmë vetëm përshkrimin fantastik të ngjarjeve të cilat, sipas Mateut, kanë ndodhur në kohën e vdekjes së Jezusit. Në të gjitha shkrimet e kohës së fillimit të krishterimit mund të hasen fragmente të cilave ju mungon serioziteti: duhet të jesh i ndershëm për ta pranuar këtë.

Shumësia e literaturës mbi Jezusin e ka shtyrë Kishën që t'i eliminojë që në fazën e organizimit. A mos janë fshehur ndoshta me qindra ungjij? Vetëm katër janë ruajtur për të hyrë në listën zyrtare të shkrimeve të Besëlidhjes së Re, që përbëjnë atë që quhet "*Kanon*".

Nga mesi i shekullit II, Markioni i detyroi fuqimisht autoritetet kishtarë që të mbajnë qëndrim. Ky ishte armiku i egër i hebrenjve, i cili atëhere kishte hedhur poshtë tërë Besëlidhjen e Vjetër dhe atë që i dukej e tepërt në shkrimet pas Jezusit, lidhur me të ose që rridhnin nga tradita judeo-krishtere. Markioni e pranonte vetëm vlerën e shkrimeve të Palit dhe të

Ungjillit sipas Lukës, pasi mendonte se ky flet në emër të Palit.

Kisha e shpalli Markionin heretik, kurse në kanonin e saj futi të gjitha letrat e Palit, por krahas katër Ungjijve, sipas Mateut, Markut, Lukës dhe Gjonit, dhe gjithashtu i shtoi disa vepra, siç janë Veprat e Apostujve. Por, në këta shekuj të parë të erës së krishterë lista zyrtare ndryshon. Veprat që më vonë do të konsiderohen të pavlera (apokrifë) momentalisht qëndrojnë në listë, kurse vepra të tjera, të cilat i përmban ligji i tanishëm i Besëlidhjes së Re, kanë qenë fshirë në atë epokë. Lëkundjet kanë zgjatur deri në Koncilin e Hiponit, në vitin 393, dhe në Kartagenë, në vitin 397. Por të katër Ungjijtë janë vazhdimisht të pranishëm.

Bashkë me R.P.Boismardin duhet të na vijë keq për zhdukjen e një sasive të literaturës së çuditshme që Kisha e shpalli apokrifë, sepse ka qenë me interes historik. Në të vërtetë ky autor i bën vend kësaj literature në krahasimin e vet të katër Ungjijve, përveç Ungjijve zyrtarë. Ai vëren se këta libra kanë qenë nëpër biblioteka deri në fundin e shekullit IV.

Ky shekull është epokë e vendosjes së një rendi serioz. Të kësaj kohë janë dorëshkrimet komplete të Ungjijve më të vjetër. Dokumentet më të reja, papirusët e shekullit III dhe një që mund të datohet si i shekullit II, na transmetojnë vetëm fragmente. Dy dorëshkrimet më të vjetra në pergament janë dorëshkrimet greke të shekullit IV. Këto janë "Codex Vaticanus", vend zbulimi i të cilit nuk dihet, dhe "Codex Sinaiticus", i zbuluar në kodrën e Sinait. I pari ruhet në Bibliotekën e Vatikanit, kurse i dyti në Muzeumin Britanik të Londrës dhe përmban dy vepra apokrifë.

Sipas Përktimit Ekumenik në botë ekzistojnë 150 pergamena të njohura; të fundit janë të shekullit IX. Por *"të gjitha kopjet e Besëlidhjes së Re që kanë arritur te ne nuk janë identike. Por, përkundrazi ndër to mund të hetohen dallime me rëndësi variable, numri i të cilave është tepër i madh. Disa nga këto dallime janë me karakter gramatikor, leksikor ose në renditjen e fjalëve, por ndonjëherë ndërmjet dorëshkrimve mund të hetohen mospajtimit të cilat prekin kuptimin e fragmenteve të tëra"*. Nëse duam t'i kujtojmë mospajtimet e tekstit, mjafton të shëtisim nëpër *"Novum Testamentum graece"*.

Kjo vepër përmban një tekst grek të quajtur *"mesatar"*, i cili është sintetik, me shënimin e të gjitha varianteve që hasen në versione të ndryshme.

Autenticiteti i një teksti, edhe i atij nga dorëshkrimet më të vlefshme, është gjithnjë i diskutueshëm. *"Codex Vaticanus"* na jep një shembull për këtë. Reprodiktimi i tij në faksimil, botim i Vatikanit i vitit 1965, është shoqëruar nga një shënim i të njëjtës prejardhje, nga i cili kuptojmë se *"shumë shekuj pas kopjimit (besohet rreth shekullit X ose XI) një shkruer i*

ka rishkruar me bojë shkrimi të gjitha fjalët përveç atyre që i ka konsideruar të gabuara". Ka fragmente të tëra të tekstit, në të cilën shumë qartë duken shkronjat e dikurshme ngjyrë gështenjë që janë në kontrast me tekstin tjetër, ngjyra e të cilit është gështenjë e errët. Asgjë nuk na lejon të pohojmë se ka qenë restaurim besnik. Tek e fundit, shënimi e saktësom këtë gjë: *"Ende nuk kemi patur sukses që përfundimisht të dallojmë duart e ndryshme që kanë korrigjuardhe shpjeguar dorëshkrimet gjatë shekujve; një numër i dukshëm korrigjurash është bërë tërësisht në momentin e përmirësimit të tekstit"*. Por në të gjithë doracakët dorëshkrimi është paraqitur si kopje nga shekulli IV. Duhet t'u drejtohem burimeve të Vatikanit për të parë se, shekuj më vonë, duart kanë mundur ta ndryshojnë tekstin.

Do të marrim përgjigje se tekstet e tjera mund të shërbejnë për krahasime, por si të zgjedhim variantet të cilat e ndryshojnë kuptimin? Dihet mirë se korrektura shumë e lashtë e ndonjë shkruesi mund të bënte që të vulosej versioni definitiv i një teksti të korrigjuar. Pak më poshtë do të shohim se si një fjalë e vetme nga teksti sipas Gjonit e cila ka të bëjë me Parakletin, e ndryshon rrënjësisht kuptimin e fragmentit dhe e modifikon tërësisht kuptimin e tij nga pikpamja teologjike.

Ja se çfarë shkruan O. Culmanni lidhur me variantet në librin e tij *"Besëlidhja e Re"*:

*"Ato ndonjëherë janë rezultat i gabimeve pa dashje; kopjuesi e ka harruar një fjalë, ose, për shembull, e ka shkruar dy herë radhazi, ose nga pakujdesia e ka harruar një pjesë të fjalisë, sepse ky në dorëshkrimin që është përshkruar ka qenë i vendosur ndërmjet dy fjalëve të njëjta. Ndonjëherë kemi të bëjmë me korrigjime të qëllimshme: ose përshkruesi i ka lejuar vetes të bëjë korrigjime të tekstit sipas ideve personale ose është përpjekur ta harmonizojë tekstin me ndonjë tekst tjetër paralel në mënyrë që pak a shumë t'i reduktojë mospajtimet. Pasi shkrimet e Besëlidhjes së Re u ndan nga literatura e krishterë fillestare dhe u konsideruan Shkrime të Shenjta, përshkruesit kanë hezituuar më shumë që t'i lejojnë vetes korrigjime të tilla të paraardhësve të vet: ata besojnë se përsëri e kopjojnë tekstin autentik dhe kështu i fiksojnë variantet. Më në fund, ndonjëherë përshkruesi e ka shpjeguar tekstin në margjinë (fusnotë) për ta shpjeguar vendin jo të qartë. Përshkruesi i ardhshëm, duke menduar se fjalinë e ka shkruar në margjinë paraardhësi ka harruar ta fusë në tekst, ka besuar se është e nevojshme të futet në tekst ai shpjegim marginal. Kështu teksti i ri ndonjëherë bëhet edhe më i pakuptueshëm"*.

Shkruesit e disa dorëshkrimeve ndonjëherë i japin liri të tepruar vetes në punën me tekst. I tillë është rasti me përshkruesin e njërit nga dorëshkrimet më të vlefshme *"Codexom Bezae Contabrigiensis"* nga shekulli VI, pas

atyre të dyve që i cituam më sipër. Duke parë pa dyshim ndryshimin në gjenealogjitë e Jezusit sipas Lukës dhe Mateut, shkruesi, në kopjen e tij të Ungjillit sipas Lukës, fut gjenealogjinë sipas Mateut, por pasi ky përmban më pak emra se i Lukës, ai e plotëson me emra të tjerë (edhe pse nuk e vendos barazpeshën).

A thua përkthimet latinisht, siç është *Vulgata* e shën Jeronimit ( shekulli IV) ose përkthimi edhe më i vjetër (vetus itala), përkthimet e sirianishtes së vjetër dhe të koptishtes, janë më të besueshme se dorëshkrimet bazë të greqishtes? Ato kanë mundur të bëhen edhe sipas dorëshkrimeve edhe më të vjetra, prej atyre që i kemi cekur më sipër dhe të cilat do të ishin të humbura në kohën tonë. Për këtë nuk dimë asgjë.

Ka pasur sukses që të gjitha këto versione të futen në familje të cilat në vete bashkojnë një numër të konsiderueshëm të karakteristikave të përbashkëta. Kështu, sipas O. Culmannit, mund të caktohen:

- një tekst i quajtur lashtosirian, formimin e të cilit kanë mundur ta bëjnë dorëshkrimet më të vjetra greke, në pjesën më të madhe; në sajë të shtypshkronjës ky tekst është shumë i përhapur në Europë që nga shekulli XVI; ai është njëri ndër më të dobëtit thonë specialistët.

- një tekst i quajtur Perëndimor me versionet e tij të vjetra latine dhe "*Codex Bezae Cantabrigiensis*", njëkohësisht në greqisht dhe latinisht (sipas Përkthimit Ekumenik, njëra nga karakteristikat e tij është tendenca shumë e shprehur ndaj shpjegimeve, pasaktësive, parafrazave, harmonizimeve).

- teksti i quajtur neutral, të cilit i takon *Codex Vaticanus* dhe *Codex Sinaiticus*, do të kishte një pastërti mjaft të madhe; botimet bashkëkohore të Besëlidhjes së Re e ndjekin pas me dëshirë, edhe pse edhe ky ka të meta (Përkthimi Ekumenik).

Krejt ajo që kritika bashkëkohore e teksteve mund të na japë nga ky pikëvështrim është të provojë të bëjë rindërtimin e "*një teksti i cili do të kishte shanse më të mëdha që t'i afrohet origjinalit. Shpresat se në çfarë mënyre do të gjejmë vetë tekstin origjinal nuk mund të realizohet*". (Përkthimi Ekumenik).

## UNGJIJTË DHE SHKENCA BASHKËKOHORE

## - GJENEALOGJITË E JEZUSIT

Ungjijtë përmbajnë shumë pak vende që do të mund t'i krahasonim me të dhënat shkencore bashkëkohore.

Para së gjithash, shumë tregime nga Ungjijtë që kanë të bëjnë me çuditë nuk janë aspak të përshtatshëm për komentim shkencor. Këto çudi lidhen si me persona: shërimi i të sëmurëve (të tërbuarit, të verbuarit, të paralizuarit, të gërbulluarit, ringjallja e Lazrit), ashtu edhe me fenomene thjesht materiale jashtë ligjeve të natyrës (ecja e Jezusit nëpër ujra që e mbajnë, kthimi i ujit në verë). Ndonjëherë ky mund të jetë fenomen natyror në formë të pazakonshme për shkak të realizimit të tij brenda një kohe tepër të shkurtër siç është fashitja e menjëhershme e stuhisë, tharja e menjëhershme e fiqve ose dhe peshkimi i çuditshëm, sikur të jenë grumbulluar gjithë peshqit e liqenit mu në vendin ku janë hedhur rrjetat e peshkimit.

Në të gjitha këto ngjarje, Zoti ndërhyr me anë të gjithëfuqisë së Tij, prandaj nuk do të duhej habitur që Ai është në gjëndje të bëjë atë që njerëzve u duket si habi, por, për Të nuk është e tillë. Këto shqyrtime nuk, do të thotë aspak se besimtari nuk duhet të përzihet në shkencë. Të besosh në çudira hyjnore dhe në shkencë është një lidhje harmonike: njëra është në mundësinë e Zotit, kurse tjetra në mundësinë e njeriut.

Unë personalisht besoj me kënaqësi se Jezusi ka mundur të shërojë të gërbullurin por, nuk mund të pajtohem të shpallet origjinal dhe i frymëzuar nga Zoti një tekst në të cilin lexoj se ndërmjet njeriut të parë dhe Abrahamit kanë ekzistuar dymbëdhjet brezni, siç na thotë Luka në Ungjillin e tij (3, 23-28). Pak më poshtë do t'i shohim shkaqet që tregojnë se teksti i Lukës, si dhe ai i Besëlidhjes së Vjetër, krejtësisht janë produkt i imagjinatës njerëzore. Ungjijtë (si edhe Kur'ani) na japin një tregim të njëjtë mbi prejardhjen biologjike të Jezusit (Isai a.s.t). Rritja e Jezusit (Isai a.s.t) në barkun e nënës ka ndodhur jashtë ligjeve të natyrës, që vlejnë për tërë qëniet njerëzore. Veza prej vezores së nënës së vet nuk ka pasur nevojë të takohet me spermatozoidin, që do të duhej të rridhte nga babai i tij, për t'u formuar embrioni, e pastaj fëmija i aftë për të jetuar. Fenomeni i cili shkakton lindjen e individit normal pa ndërmjetësimin e elementit frytnues mashkullor quhet partenogjeneza. Në botën shtazore partenogjenza mund të shikohet në disa kushte. I tillë është rasti tek insekte të ndryshëm, te disa jokurrizorë dhe shumë rrallë te një lloj i zogjve. Te disa sisorë, te lepujt për shembull, ka mundur në mënyrë eksperimentale të fitohet fillimi jetës së vezës pa ndërmjetësimin e spermatozoidit në embrion, në një stad shumë rudimentar, por, nuk ka qenë e mundur të shkohet më tej se ata nuk dihet për asnjë rast të partenogenezës së përfunduar eksperimentale ose natyrore.



Jezusi (Isai a.s.) është një rast i tillë. Maria (Merjemja) ka qenë nënë virgjëreshë. Ajo ka ruajtur virgjërinë e vet dhe nuk ka pasur fëmijë tjetër përveç Jezusit (Isai a.s.t). Jezusi (Isai a.s.) është një unikat biologjik.

## GJENEALOGJITË E JEZUSIT

Dy gjenealogjitë që i përmbajnë Ungjilli sipas Mateut dhe sipas Lukës shtrojnë çështje e vërtetësisë dhe të përputhshmërisë me të dhënat shkencore dhe rrjedhimisht edhe të origjinalitetit. Këto çështje janë tepër habitëse për komentuesit e krishterë, sepse ata nuk pranojnë që në të, të shohin atë që është tepër e qartë se bëhet fjalë për një sajim të imagjinatës njerëzore: ajo që më parë i ka frymëzuar autorët priftërorë të Zanafillës, në shekullin VI para erës sonë, për gjenealogjitë e tyre lidhur me njerëzit e parë. Ajo e kë frymëzuar edhe Mateun dhe Lukën për atë që këta dy autorë nuk kanë huazuar nga Besëlidhja e Vjetër.

Duhet menjëherë të vërejmë që këto gjenealogji mashkullore nuk kanë kurrëfarë rëndësie për Jezusin. Nëse Jezusit, birit të vetëm të Marisë, pa baba biologjik, ka qenë dashur t'i caktohet gjenealogjia, atëherë ajo do të duhej të ishte gjenealogjia e Marisë, nënës së tij.

Ja tekstet sipas Përkthimit Ekumenik të Biblës, Besëlidhja e Re:

Gjenealogjia sipas Mateut në fillim të Ungjillit të tij:

GJENEALOGJIA E JEZU KRISHTIT,

DJALIT TË DAVIDIT,

DJALIT TË ABRAHAMIT

Abrahamit i lindi Izaku.

Izakut i lindi Jakobi.

Jakovit i lindi Juda dhe vëllezërit e tij.

Judës i lindi prej Tamarës Faresi dhe Zara.

Faresit i lindi Esromi.

Esromit i lindi Arami.

Aramit i lindi Aminadabi.

Aminadabit i lindi Naasoni.

Naasonit i lindi Salmoni.

Salmonit i lindi prej Rabës Boozi.

Boozit i lindi Prej Rutës Jobedi.

Jobedit i lindi Jeseu.

Jeseut i lindi Davidi mbret.

Davidid prej ish gruas Urisë, Solomoni.

Solomonit i lindi Roboami.

Roboamit i lindi Abiai.

Abiait i lindi Asi.

Asit i lindi Jozafati.

Jozafatit i lindi Jorami.

Joramit i lindi Ozia.

Ozisë i lindi Joatami.

Joatamit i lindi Akazi.

Akazit i lindi Ezekia.

Ezekisë i lindi Manaseu.

Manaseut i lindi Amoni.

Amonit i lindi Jozia.

Jozisë i lindi Jehonia dhe vëllezrit e tij në kohën e shpërnguljes në Babiloni.

Pas shpërnguljes në Babiloni:

Jenonisë i lindi Salatieli.

Salatielit i lindi Zorobabeli.

Zorobabelit i lindi Abiudi.

Abiudid i lindi Eliakimi.

Elikimit i lindi Azori.

Azorit i lindi Sadoku.

Sadokut i lindi Akimi.

Akimit i lindi Eliudi.

Eliudid i lindi Eliazari.

Eliazarit i lindi Matani.

Matanit i lindi Jakobi.

Jakobit i lindi Jozefi, Fati i Marisë, prej së cilës lindi Jezusi që quhet Krisht.

Pra, gjithsej: katërbëdhjetë brezni prej Abrahamit deri te Davidi, katërbëdhjetë prej Davidit deri në internimin në Babiloni, katërbëdhjetë prej internimit në Babiloni deri te Krishti.

Luka (3, 23-38) jep një gjenealogji tjetër nga ajo sipas Mateut. Këtu po e riprodhojmë sipas të njëjtit përkthim:

"Jezusi kur ishte rreth tridhjetë vjeç. Ishte - si mendonin njerëzit - i biri i Jozefit, i Helit, i Matatit, i Levit, i Melkit, i Janait, i Jozefit, i Matatisë, i Amonit, i Naumit, i Heselit, i Nagait, i Mahatit, i Matatisë, i Semeit, i Josehit, i Judës, i Joananit, i Resait, i Zorobabelit, i Salatielit, i Nierit, i

Melkit, i Adit, i Kozamit, i Elmandamit, i Herit, i Jezusit, i Eliezerit, i Jorimit, i Matatit, i Levit, i Simonit, i Judës, i Jozefit, i Jonamit, i Eliakimit, i Meleait, i Menait, i Matatait, i Natanit, i Davidit, i Jeseut, i Obedit, i Boozit, i Salait, i Naasonit, i Aminadabit, i Adminit, i Arnit, i Esromit, i Faresit, i Judës, i Jakobit, i Izakut, i Abrahamit, i Tares, i Nahorit, i Seruhut, i Ragahut, i Falekut, i Heberit, i Salait, i Kainait, i Arfaksadit, i Semit, i Nojës, i Lamehit, i Matuzalës, i Enokut, i Jaredit, i Maleleelit, i Kainanit, i Enosit, i Setit, i Adamit, i Zotit.

Këto dy gjenealogji shihen më qartë në dy tabela prej të cilave njëra tregon gjenealogjinë para Davidit, kurse tjetra gjenealogjinë pas Davidit:

### **GJENEALOGJIA E JEZUSIT PARA DAVIDIT**

SIPAS MATEUT

SIPAS LUKËS

	1. Adami
	2. Seti
	3. Enosi
. Mateu nuk e përmend Kainani	4.
asnjë emër para Abrahamit. Maleleeli	5.
6. Jaredi	
7. Enoku	
8. Matuzala	
Lumehi	9.
	10. Noa
Semi	11.
	12.

Arfaksadi	
Kainani	13.
Salai	14.
Haberi	15.
Faleku	16.
Ragau	17.
18.Seruku	
Nahori	19.
Tares	20.
1. Abrahami Abrahami	21.
2. Izaku Izaku	22.
3. Jakobi	23. Jakobi
4. Juda	24. Juda
5. Faresi Faresi	25.
6. Esromi Esromi	26.
7. Arami	27. Arni

	28. Admini
8. Aminadabi Aminadabi	29.
9. Naasoni Naasoni	30.
10. Samoni Salai	31.
11. Boozi	32. Boosi
12. Jobedi Obedi	33.
13. Jeseu	34. Jeseu
14. Davidi Davidi	35.

#### GJENEALOGJIA E JEZUSIT PAS DAVIDIT

##### SIPAS MATEUT

14. Davidi      35. Davidi

15. Solomoni  
Natani

16. Roboaimi

17. Abiai. 38. Menai

18. Asafi

39. Meleai

##### SIPAS LUKËS

36.

37. Matatai

19. Jozafati	40. Eliakimi	
20. Jorami	Jonami	41.
21. Ozia	Jozefi	42.
22. Joatami		43. Juda
23. Akazi	Simoni	44.
24. Ezekia		45. Levi
25. Manaseu	Matati	46.
26. Amonia	Jorimi	47.
27. Joazia	Eliezeri	48.
28. Jehonia	Jezusi	49.
		50. Hari
Internimi në Babiloni	Elmadami	51.
52. Kozami		53. Adi
29. Salatieli	Melki	54.
30. Zorobabeli		55. Neri
31. Abiudi	Salatieli	56.
32. Eliakimi	Zorobabeli	57.

33. Azori Reasi	58.
34. Sadoku Joanani	59.
35. Akimi	60Juda
36. Eliudi Josehi	61.
37. Eleazari Semei	62.
38. Matani Matati	63.
39. Jakobi Mahati	64.
40. Jozefi Nagai	65.
41. Jezusi Hesli	66.
Naumi	67.
Amoni	68.
69. Matati	
Jozefi	70.
Janai	71.
Melki	72.
Levi	73.



Matati	74.
Heli	75.
Jozefi	76.
Jezusi	77.

#### NDRYSHIMET NGA DORËSHKRIMET

#### DHE NË KRAHASIM

#### ME BESËLIDHJEN E VJETËR

Nëse lihen anash ndryshimet ortografike, duhet të citojmë:

#### a) UNGJILLI SIPAS MATEUT

Nga "*Codex Bezae Cantabrigiensis*", një dorëshkrim dygjuhësh greqisht-latinisht shumë i rëndësishëm i shekullit VI, gjenealogjia është zhdukur krejtësisht nga teksti grek dhe një pjesë shumë e madhe nga teksti në latinisht, por këtu mund të bëhet fjalë për një humbje të zakonshme të fletëve të para.

Duhet të theksojmë lirinë e madhe të Mateut në lidhje me Besëlidhjen e Vjetër, gjenealogjitë e të cilës ia amputon për nevoja të një demonstrimi të veçantë numerik ( të cilin, më në fund, as nuk e jep, si do të shihet më poshtë).

#### B) UNGJILLI SIPAS LUKËS

1. Luka i përmend njëzet emra para Abrahamit; Besëlidhja e Vjetër i përmend vetëm nëntëmbëdhjetë (shih tabelën e pasardhësve të Adamit në veprën kushtuar Besëlidhjes së Vjetër). Luka e ka shtuar pas Arfaksadit (n. 12) njëfarë Kainanin ( n. 13), gjurma e të cilit, si bir i Arfaksadit, nuk është

në Zanafilla.

2. Prej Abrahamit deri te Davidi: kemi 14 deri 16 emra sipas dorëshkrimeve.

3. Prej Davidit deri tek Jezusi.

Në "*Codex Bezae Cantabrigiensis*" është një variant shumë i rëndësishëm që ia përshkruan Lukës një gjenealogji fantazioze të përpiluar sipas Mateut, të cilit shkruesi ia ka shtuar pesë emra. Për fat të keq, gjenealogjia nga Ungjilli sipas Mateut është zhdukur nga ky dorëshkrim, kështu që më nuk mund të bëhet krahasimi.

## HULUMTIMI KRITIK I TEKSTEVE

Këtu kemi dy gjenealogji të ndryshme për të cilat është më thelbësore karakteristika e përbashkët: ajo që zhvillohen ndërmjet Abrahamit dhe Davidit. Për të lehtësuar këtë hulumtim, do ta shqyrtojmë kritikën duke e ndarë në tri pjesë:

- prej Adamit deri te Abrahami,

- prej Abrahamit deri te Davidi,

-prej Davidit deri te Jezusi.

### 1. PERIUDHA PREJ ADAMIT DERI TEK ABRAHAMI

Pasi Mateu e fillon gjenealogjinë e tij prej Abrahamit, atij nuk i përket kjo. Vetëm Luka jep informacione për të parët, prej Abrahamit deri te Davidi: 20 emra prej të cilëve siç thamë 19 janë tek Zanafilla ( kreu 4,5 dhe 11).

A mund të merret me mend se para Abrahamit ka pasur vetëm 19 se 20

gjenerata të qenieve njerzore? Problemin e kemi hulumtuar lidhur me Besëlidhjen e Vjetër. Nëse kthehemi në tabelën e pasardhësve të Abrahamit, të përcaktuar sipas Zanafillës, e cila përmban tregues mbi kohën që shprehet në numra që rrjedhin nga teksti biblik, do të duhej të kishin kaluar përafërsisht nëntëmbëdhjetë shekuj që nga paraqitja e njeriut në Tokë deri në lindjen e Abrahamit. Por, meqë tani konsiderohet se Abrahami ka jetuar rreth vitit 1850 para erës sonë, atëherë, sipas treguesve nga Besëlidhja e Vjetër, rrjedh se njeriu është paraqitur në Tokë përafërsisht tridhjetë e tetë shekuj para erës sonë. Luka në Ungjillin e tij me siguri është frymëzuar nga këto të dhëna. Duke i kopjuar këto, ai shpreh një të pavërtetë të hapët. Pamë më sipër se çfarë argumente historike të pakundërshtueshme sjellin deri në këtë konstatim.

Deri këtu mund të kuptohet problemi që të dhënat nga Besëlidhja e Vjetër nuk mund të pranohen në kohën tonë: ato hyjnë në fushën e "*vjetërsimit*", që e ka përmendur edhe Koncili i Dytë i Vatikanit. Por ajo që ungjilltarët i kanë huazuar po këto të dhëna të papajtueshme me shkencën është një pohim shumë serioz, i cili mund t'i kundërshtojë mbrojtësit e historisë së teksteve ungjillore.

Komentuesit e kanë hetuar bukur rrezikun. Ata përpiqen ta mundin vështirësinë duke thënë se nuk është fjala për drurin gjenealogjik komplet, se ungjilltarët nuk kanë përmendur emrat me qëllim, dhe se fjala është vetëm për "*qëllimin që të përcaktohet vija kryesore ose elementet qenësore të pasardhësve mbi bazë të realitetit historik*". Në tekste asgjë nuk na lejon të shtrojmë hipotezë, sepse është saktësuar mirë: filani lind filanin ose djali i këtij apo atij. Aq më tepër, sidomos për atë që i paraprin Abrahamit, ungjilltari i merr të dhënat nga burimet në Besëlidhjen e Vjetër, ku gjenealogjitë janë paraqitur në këtë formë:

X në atë moshë e lindi Y...Y jetoj kaq vjet dhe e lindi Z ...

Domethënë, nuk ka ndërprerje.

Një pjesë e gjenealogjisë së Jezusit sipas Lukës, para Abrahamit, nuk mund të pranohet nga njohuritë bashkëkohore.

## 2. PERIUDHA PREJ ABRAHAMIT DERI TE DAVIDI

Këtu të dy gjenealogjitë përputhen, me një apo dy emra të ndryshëm:

ndryshimi mund të shpjegohet me gabimin pa dashje të kopjuesve.

A thua këtu e vërteta është në anën e ungjilltarëve?

Historia e vendosur Davidin rreth 1.000 vjet, kurse Abrahamin rreth 1.800-1.850 vjet para erës sonë: 14 deri 16 breznit për afër tetë shekuj; a është e vërtetë kjo? Të themi se për këtë kohë tekstet ungjillore janë në kufirin e të mundshmes.

### 3. PERIUDHA PAS DAVIDIT

Medet, tekstet nuk përputhen aspak kur është fjala për gjenealogjinë davidiane të Jozefit, e cila sipas Ungjillit paraqet degën e Jezusit.

Ta lëmë anash falsifikimin e hapët në "*Codex Bezae Cantabrigiensis*" lidhur me atë që ka të bëjë me Lukën dhe ta krahasojmë atë që na transmetojnë dorëshkrimet më të vlefshme: "*Codex Vaticanus*" dhe "*Codex Sinaiticus*".

Në gjenealogjinë sipas Lukës, 42 emra janë vënë pas Davidit (nr. 35 ) deri tek Jezusi (nr. 77). Në gjenealogjië sipas Mateut janë përmendur 27 emra pas Davidit (nr. 14) deri tek Jezusi ( nr. 41). Domethënë, numri i paraardhësve (fiktivë) të Jezusit është i ndryshëm pas Davidit në të dy Ungjijtë. Pëveç kësaj, edhe vetë emrat janë të ndryshëm.

Por kjo nuk është e gjitha.

Mateu na thotë se e ka zbuluar se gjenealogjia e Jezusit prej Abrahamit ndahet në tre grupe me nga 14 emra: grupi parë prej Abrahamit deri tek Davidi; grupi i dytë prej Davidit deri te internimi në Babiloni; grupi i tretë nga internimi në Babiloni deri te Jezusi. Teksti i tij përmban vërtetë 14 emra në dy grupet e para, por në grupin e tretë - prej internimit në Babiloni deri te Jezusi - ka vetëm 13 emra dhe jo 14, si do të duhej, meqë tabela tregon se Salatieli mban numrin 29, kurse Jezusi numrin 41. Nuk ka asnjë variant sipas Mateut që jep 14 emra në këtë grup.

Më në fund, që të ketë sukses për të bërë 14 emra në grupin e tij të dytë, Mateu i lejon vetes liri të madhe lidhur me tekstin e Besëlidhjes së Vjetër. Emrat e gjashtë pasardhësve të parë ( prej numrit 15 deri në 20) janë në përputhje me të dhënat e Besëlidhjes së Vjetër. Por Mateu i ka maskuar tre pasardhës të Joramit ( nr. 20), të cilët, libri i dytë i Analeve nga Bibla, i

përmend se kanë qenë: Ahazja, Joasi, dhe Amasja. Në një vend tjetër, Jehonia (nr.28) për Mateun është bir i Josisë (nr.27), kurse, sipas librit tjetër, Mbretërit, nga Bibla, ndërmjet Josiut dhe Jehonisë duhet vendosur Eliakimi.

Kështu është treguar se si e ka modifikuar Mateu renditjen gjenealogjike nga Besëlidhja e Vjetër, për ta paraqitur një grup artificial prej 14 emrash ndërmjet Davidit dhe internimit në Babiloni.

Sa i përket faktit se mungon një emër në grupi e tretë kështu që asnjë tekst i tanishëm i këtij Ungjilli nuk i përmban 42 emrat e paralajmëruar, më pak çuditëmi me egzistimi e zbrazëtisë (do të mund të shpjegohej me një gabim shumë të vjetër të një shkruesi, që pastaj përsëritet) sesa me gati heshtjen e përgjithshme të komentuesve mbi këtë çështje. Si mos të vërehet zbrazëtia vallë? Heshtjen fetare e ndërpreu U. Trillig, i cili në librin e tij "*Ungjilli sipas Mateut*" ia kushton vetëm një rresht. Por e vërteta është shumë larg asaj që të lihet anash, sepse komentuesit e këtij Ungjilli, e së bashku me ta edhe ata të Përkthimit Ekumenik dhe të tjerët, si kardinal Danieli, zbulojnë rëndësinë shumë të madhe të simbolizimit 3 x 14 nga Mateu. Që ungjilltari ta ilustronte pa hezitim dhe për të arritur sukses në demonstrimin e tij me numrat, a nuk i la pa përmendur emrat biblik?

## KOMENTIMET E EKZEGETËVE BASHKËKOHORË

Në librin e tij "*Les Evangelis de l'Enfance*" (Ungjijtë prej Zanafillës, 1967) kardinal Danieli i jep vlerë simbolike të shkallës së parë "*skematizimit numerik*" të Mateut pasi që ai përcakton degën gjenealogjike të Jezusit, të cilën, gjithashtu, e vërteton edhe Luka. Për të Luka dhe Mateu janë "*historianë*" që kanë bërë "*hulumtime historike*", kurse "*gjenealogjia*" është marrë nga "*arkivi i familjes së Jezusit*". Duhet të saktësohet që këta arkivë nuk janë gjetur kurrë.

Kardinal Danieli anashkalon ata që kritikojnë pikëpamjen e tij: "*Mentaliteti perëndimorë, shkruan ai, i mosnjohjes së hebreo-krishterimit dhe mungesa e mënyrës së të menduarit semit kanë mashtruar aq shumë ekzegetë me rastin e interpretimit të Ungjijve. Ata kanë projektuar kategorië e veta platonike, karteziiane, hegeliane dhe hajdegeriane (sic). Atëherë është e kuptueshme se çdo gjë është përzier në shpirtin e tyre*".

Është e qartë se as Platoni, as Dekarti, as Hegeli dhe as Heidegeri nuk kanë të bëjnë aspak me qëndrimin kritik që mund të mbahet ndaj këtyre

gjenealogjive fantazioze.

Duke kërkuar kuptimin e tre herë katërmbëdhjetë sipas Mateut, autori humbet në supozimet të cilat vetëm mund të citohen: *"Mund të bëhet fjalë për dhjetë javë karakteristike për apokalipsën hebraike, tri te parat që i përgjigjen kohës prej Adamit deri tek Abrahamit duhet hequr: atëherë mbesin shtatë javë, gjashtë të parat korrespondojnë me gjashtë herë shtatë, që paraqesin tri grupe me nga të cilin fillon koha e shtatë e botës".* Një shpjegimi i tillë nuk ka nevojë për shpjegim.

Komentuesit e Përkthimit Ekumenik të Biblës-Besëlidhja e Re gjithashtu na ofrojnë variacione apologjetike numerike njësoj të papritura.

Për 3 herë 14 te Mateu:

a) 14 do të mund të ishte mbledhja numerike e tri bashkëtingëlloreve që e përbëjnë emrin David në hebraisht ( $D=4$ ,  $V=6$ ), prej këndeje:  $4+6+4=14$ .

b) 3 herë 14= 6 herë7, kurse *"Jezusi vjen në fund të javës së shtatë të Historisë së Shenjtë, e cila fillon me Abrahamin"*.

Te Luka ky përkthim jep 77 emra, prej Adamit deri te Jezusi, gjë që e bën të mundur që përsëri të përzihet numri 7 si pjesëtues prej 77 ( $7 \times 11 = 77$ ). Por, duket se te Luka numri i varianteve që i shtojnë apo i mungojnë emrat është i tillë, sa që lista prej 77 emrash, është përgjithësisht artificiale, por ajo ka një përparësi se është e përshtatshme për këtë lojë numrash.

Mundet që gjenealogjitë e Jezusit nga Ungjijtë të jenë temë e cila te komentuesit e krishterë ka shkaktuar akrobacionet më karakteristike dialektike, të cilat janë në nivel të fantazisë së Lukës dhe të Mateut.

## **V.KUNDËRSHTIT DHE GJËRAT E PABESUESHME NË TREGIME**

Secili prej katër Ungjijve përmban një numër të rëndësishëm të tregimeve që transmetojnë ngjarje të cilat mund të jenë karakteristike vetëm e një Ungjilli, të përbashkëta për shumicën e tyre ose për të gjithë. Kur është karakteristike vetëm e njërit Ungjill, ato ndonjëherë paraqesin probleme serioze: kështu për ndonjë ngjarje me rëndësi të madhe, çuditëmi se si për të bën fjalë vetëm një ungjilltarë: për shembull për shëlbimin e Jezusit në qiell në ditën e ringjalljes. Pëveç kësaj, një numër i konsiderueshëm i

ngjarjeve janë shpjeguar ndryshe e ndonjëherë ka ndryshime të mëdha të dy ose më shumë ungjilltarë. Të krishterët habiten shumë shpesh, kur marrin vesh se egzistojnë aq shumë kundërthënie ndërmjet Ungjijve, sepse me aq besim u është thënë se autorët e tyre kanë qenë dëshmitarë të ngjarjeve për të cilat flasin.

Më sipër kemi sinjalizuar vetëm disa nga këto gjëra të pabesueshme, të habishme dhe kontradiktore. Por sidomos ngjarjet e fundit të jetës së Jezusit, që pasuan pas Mundimit, janë objekt i tregimeve divergjente dhe kontradiktore.

### **TREGIMET MBI MUNDIMIN**

Vetë R. P. Roge vëren se Pashkët në krahasim me darkën e fundit të Jezusit me apostujt është vendosur në kohë të ndryshme në Ungjijtë sinoptikë dhe në Ungjillin e katërt. Gjoni e vendos darkën "*para kremtes së Pashkëve*", kurse tre të tjerët gjatë ditëve të Pashkëve. Prej kësaj, për shkak të dy divergjencave, rrjedhin gjëra vërtet të pabesueshme: ky episod bëhet i pakapshëm për shkak të pozitës së Pashkëve në krahasim me darkën, të fiksuara në atë mënyrë. Kur dihet se çfarë rëndësie kanë pasur Pashkët në liturgjinë hebraike dhe çfarë rëndësie ka pasur kjo darkë, në të cilën Jezusi përshëndetet me nxënësit, si të kuptohet që kujtimi mbi vendin e njëjës në krahasim me tjetrën në traditë, të cilën më vonë na kanë përcjellur ungjilltarët, është shkatëruar deri në atë masë?

Në një mënyrë të përgjithshme, tregimet mbi Mundimin ndryshojnë sipas ungjilltarëve, e sidomos në tre Ungjijtë e parë dhe në Ungjillin sipas Gjoni. Darka e fundit e Jezusit dhe Mundimi zënë vend tepër të madh në këtë të fundit, dy herë më shumë se te Marku dhe te Luka; teksti i tij është gati një herë e gjysëm më i gjatë se teksti i Mateut. Kështu Gjoni përcjell një fjalim shumë të gjatë të Jezusit para nxënësve, tregim ky që zë vend në katër kapituj (14 deri 17) të Ungjillit të tij. Gjatë kësaj bisede tepër sublime Jezusi u jep udhëzimet e fundit nxënësve të cilët do t'i lë dhe iu dorëzon porosinë e tij shpirtërore, por për këtë nuk gjendet asnjë gjurmë në Ungjijtë e tjerë. Përkundrazi, Mateu, Luka dhe Marku rrëfejnë lidhur me lutjen e Jezusit në Getsemani; Gjoni për këtë nuk flet.

## MUNGESA E TREGIMIT MBI THEMELIMIN E EUKARISTISË NË UNGJILLIN SIPAS GJONIT

Fakti më i rëndësishëm që e tmerron lexuesin e Mundimit në Ungjillin sipas Gjonit është se ai nuk përmend fare themelimin e Eukaristisë<sup>34</sup> gjatë darkës së fundit të Jezusit me nxënësit.

Nuk ka të krishterë që nuk e njeh ikonografinë e "*Darkës së fundit*" në të cilën Jezusi është ulur rreth tryezës, i rrethuar nga apostujt për herë të fundit. Piktorët më të mëdhenj e kanë paraqitur këtë mbledhje të fundit të Gjonit pranë Jezusit, në të cilën zakonisht shihej autori i Ungjillit të fundit që mban emrin e tij.

Sado e habitshme që mund të duket, shumica e specialistëve nuk e konsiderojnë apostullin Gjon autor të Ungjillit të katërt, e ai nuk përmend themelimin e Eukaristisë. E ky shugurim i bukës dhe i verës, që bëhet trupi dhe gjaku i Jezusit, është akt rëndësishëm liturgjik i krishterimit. Të tre ungjilltarët e tjerë flasin për të, edhe pse me shprehje të ndryshme, siç e kemi thënë më sipër. Gjoni për të nuk thotë asnjë fjalë. Të katër tregimet e ungjilltarëve kanë vetëm dy pika të përbashkëta: paralajmërimin e mohimit të Pjetrit dhe tradhëtinë e një apostulli {Juda, të cilin me emër e përmend vetëm Mateu dhe Gjoni}. Vetëm Gjoni flet për larjen e këmbëve të nxënësve nga Jezusi, në fillim të darkës.

Si të shpjegohet zbrazëtia e Gjonit?

Po qe se gjykojmë objektivisht, ajo që të vjen ndër mend, nëse supozohet se tregimi i tre ungjilltarëve të parë është i saktë, është supozimi mbi humbjen e ndonjë fragmenti në Ungjillin sipas Gjonit, i cili e ka transmetuar po atë episod. Por komentuesit e krishterë nuk janë ndalur vetëm në këtë supozim.

T'i shqyrtojmë disa pikëpamje.

Në veprën e tij "*Fjalor i vogël i Biblës*" ( Petit Dictionnaire de la Bible), A.Tricoli, në artikullin "*Darka e fundit*" shkruan: "*Darka e fundit e Jezusit me të Dymbëdhjetë gjatë së cilës e ka themeluar Eukaristinë. Tregimi për këtë e gjejmë në Ungjijtë sinoptikë ( referencat: Mateu, Marku, Luka), kurse Ungjilli i katërt na jep hollësira plotësuese". (Referenca: Gjoni). Në artikullin "Eukaristia", po ky autor shkruan: "*Themelimi i Eukaristisë është dhënë shkurt në tre Ungjijtë e parë: në katekizmin apostolik kjo çështje ka qenë me rëndësi të dorës së parë. Shën Gjoni i ka bërë plotësimet e**



*nevojshme në këto tregime të ngjeshura duke e përcjellur fjalimin e Jezusit mbi bukën dhe verën ( 6, 32-38)". Prandaj, komentuesi nuk e përmend se Gjoni nuk e transmeton themelimin e Ekaristisë nga Jezusi. Autori flet për "hollësira plotësuese", por nuk është fjala për hollësira që do ta plotësonin themelimin e Ekaristisë (thjesht, bëhet fjalë për larjen e këmbëve të apostujve). Sa i përket "bukës së jetës", për të cilën flet komentuesi, këtu është fjala për evokimin e Jezusit - jashtë Darkës së fundit - të dhuratës së përditëshme hyjnore "mannën" (bukën) në shkretëtirë, në kohën e daljes së hebrejve nga Egjipti, dalje të cilën e udhëhoqi Moisiu - evokim për të cilin flet vetëm Gjoni. Me të vërtetë në fragmentin vijues të Ungjillit të tij Gjoni përmend aludimin e Jezusit në Ekaristinë, në formë të një digresioni për bukë, por asnjëri nga ungjilltarët e tjerë nuk flet për këtë episod.*

Kështu, mund të habitemi njekohësisht me heshtjen e Gjonit lidhur me atë që transmetojnë tre ungjilltarët e tjerë dhe heshtjen e tyre lidhur me atë që Jezusi, sipas Gjonit, e paralajmëroi.

Komentuesit e Përkthimit Ekumenik të Biblës, Besëlidhja e Re, e pranojnë këtë zbrazëti në Ungjillin sipas Gjonit, por gjejnë këtë shpjegim për mungesën e tregimit mbi themeimin e Ekaristisë: "*Në një mënyrë të përgjithshme, Gjoni nuk i kushton kujdes aspak traditave dhe institucioneve të Izraelit të vjetër, gjë që ndoshta e ka shtyrë të mos tregojë rrënjosjen e Ekaristisë në liturgjinë e Pashkëve". Si të besojmë se mungesa e interesit për liturgjinë e pashkëve hebraike e ka shtyrë Gjonin mos të flasë mbi themelimin e aktit bazë të liturgjisë së fesë së re?*

Problemi aq shumë i habit egzegetët, saqë teologët vrasin mendjen për të gjetur forma më të hershme ose të ngjashme të Ekaristisë në episodet nga jeta e Jezusit, për të cilat flet Gjoni. Kështu për O. Culmannin, në librin e tij "*Besëlidhja e Re*" (Le Nouveau Teatament) "*Çudia në Kanë dhe shumëzimi i bukëve e parafigurojnë sakramentin e Darkës së Fundit të Shenjtë*" ("*Ekaristinë*"). Të përkujtojmë se në Kanë është bërë fjalë për kthimin e ujit në verë, pasi që kjo pije ka munguar në një dasëm ( mrekullia e parë e Jezusit, të cilën e përmend vetëm Gjoni (2, 1-12). Sa i përket shumëzimit të bukëve (Gjoni, 6, 1-13), qëllimi i tij ka qenë të ushqejë 5.000 njerëz me 5 bukë. Gjoni për këto ngjarje nuk ka bërë ndonjë komentim të posaçëm, prandaj krahasimi është imagjinatë e pastër e egzegetëve. Nuk shihet shkak i lidhjes që e vendos ai dhe njekohësisht stepemi kur i njëjti autor thotë se shërimi i një personi të paralizuar dhe një të verbri të lindur "*paralajmërojnë kryqëzimin*", kurse "*uji dhe gjaku, që pas vdekjes së Jezusit rrjedhin nga ijet e tij, bashkohen në një ngjarje*" që çon në kryqëzimin dhe në Ekaristi.

Një krahasim tjetër i të njëjtit ekzeget lidhur me Ekaristinë e ka cituar R.P. Roge në librin e tij "*Hyrje në Ungjij*" (Initiation a l' Evangile): "*Disa*

*teologë biblikë si Oscar Culmann, shkruan ai, në tregimin mbi larjen e këmbëve, para Darkës së fundit, shohin ngjashmërinë simbolike të themelimit të Eukaristisë ..."*

Është e vështirë të kuptohet baza mbi të cilën mbështeten të gjitha këto krahasime që i kanë shpikur komentuesit në mënyrë që më lehtë të pranohet zbrazëtia habitëse në Ungjillin sipas Gjonit.

## **DËFTIMI I JEZUSIT TË RINGJALLUR**

Shembulli i fantazisë së dorës së parë në tregim është përmendur që më parë në Ungjillin sipas Mateut, me përshkrimin e tij të fenomeneve jonormale që e kanë shoqëruar vdekjen e Jezusit. Ngjarjet që pasuan pas ringjalljes do të japin lëndë jo vetëm për tregime kontradiktore, po edhe për tregime ekstravagante të të gjithë ungjilltarët.

R.P. Roge, në librin e tij "*Hyrje në Ungjij*" (Initiation a l' Evangile), në faqen 182, na jep shembuj të konfuzionit, përshtjellimit dhe kontradiktës që ka në shkrimet:

Lista e grave që kanë ardhur tek varri nuk është plotësisht e njëjtë në të tre Ungjijtë sinoptikë. Te Gjoni është vetëm një Maria nga Magdalena. Por ajo flet në shumës sikur të ketë shoqe me vete: "*Ne nuk dimë ku e kanë vendosur*". Te Mateu, ëngjëlli i paralajmëron gratë se do të shohin Jezusin në Galile. Pak më vonë, Jezusi ju del përpara pranë varrit të tij. Luka duket se e ka hetuar këtë vështirësi dhe deri diku e ka ndrequr burimin e vet. Ëngjëlli thotë: "*Kujtohuni çfarë ju tha kur ishte në Galile...*" Dhe vërtetë, Luka i përmend vetëm tri dëftime... "*Gjoni vendos dy dëftime në distancë prej tetë ditësh, në shtëpinë në Jeruzalem; pastaj, për herë të tretë, afër liqenit, dmth në Galile. Mateu ka vetëm një dëftim, në Galile*". Komentuesi e heq nga ky hulumtim fundin e Ungjillit sipas Markut, i cili flet për dëftimet, sepse mendon se ai është "*pa dyshim i dorës së dytë*".

Të gjitha këto fakte janë në kundërshtim me përmendjen e dëftimeve të Jezusit në letrën e parë të Palit drejtuar Korintasve (15, 5-7), para më shumë se 500 vetave njëkohësisht, para Jakobit dhe të gjithë apostujve, duke mos e harruar edhe vetë Palin.

Është e habitshme se si pas kësaj, në të njëjtin libër R..Roge stigmatizon "*fantazmagoritë frazeologjike dhe feminare të disa apokrifëve*" mbi ringjalljen. Në të vërtetë, a thua këto shprehje nuk i përgjigjen plotësisht

Mateut dhe vetë Palit, i cili është në kontradiktë të plotë me ungjilltarët e tjerë lidhur me dëftimin e Jezusit të ringjallur?

Pëveç kësaj, egziston një kundërshtim mes tregimit nga Vepra e Apostujve, autor i të cilit është ungjilltari Luka, mbi dëftimi e Jezusit para Palit dhe të asaj që Pali na tregon shkurtimisht për këtë. Kjo e ka shtyrë R.P. Kannengieserin që në librin e tij *"Besimi në Ringjallje, Ringjallje e Besimit"* (1974) të thotë se Pali *"dëshmitari i vetëm i ringjalljes së Krishtit, zëri i të cilit depërton drejtpërdrejt deri te ne me anë të shkrimeve të tij kurrë nuk flet për takimin e tij personal me të Ringjallurin"* - *"Ai më me qejf ia ndalon vetes që ta përshkruaj"*.

Kundërshtimi mes Palit, dëshmitarit të vetëm, por të dyshimtë, dhe të Ungjijve është i hapët.

O. Culmanni, në librin e tij *"Besëlidhja e Re"* i shënon kundërthëniet ndërmjet Lukës dhe Mateut, meqë i pari këto dëftime i vendos në Jude, kurse tjetri në Galile.

Sa i përket kundërthënies Luka-Gjoni, të rikujtojmë se episodi që tregon Gjoni (21, 1-14) mbi bregun e liqenit të Tiberiadit, i cili, pastaj, do të zërë aq shumë peshq, saqë nuk do të mund t'i mbartë, është vetëm përsëritje e peshkimit të çuditshëm në po atë vend, në ngjallje të Jezusit, për të cilin flet Luka në (5, 1-11).

R.P. Roge në librin e tij na bind lidhur më këto dëftime se *"kjo mungesë lidhshmërie, kjo paqartësi, ky përshtjellim fusin besim"* pasi të gjithë këto fakte tregojnë se ungjilltarët nuk janë marrë vesh, sepse për ndryshe nuk do ta kishin lënë pa i kurdisur violinat e veta. Rezonimi është i habitshëm. Vërtetë, të gjithë ata, gjithashtu, kanë mundur t'i transmetojnë me sinqeritet të plotë t'i percjellin traditat e bashkësive të veta plotësisht të romantizuara, pa dijen e tyre: si të mos arrijmë deri te ky supozim kur ka aq shumë kundërthënie dhe gjëra të pabesueshme në parashikimin e ngjarjeve?

[faqja 2 nga 6](#) | [faqja 3](#) | [faqja 4](#) | [faqja 5](#) | [faqja 6](#)

## SHËLBIMI I JEZUSIT

Kundërthëniet vazhdojnë deri në fund të tregimeve, pasi as Gjoni, as Mateu nuk e përmendin Shëlbimin e Jezusit. Për të flasin vetëm Marku dhe Luka.

Sipas Markut ( 16, 19) Jezusi *"u ngrit në qiell dhe rri në të djathtë të Hyjit"*, pa saktësuar datën lidhur me ringjalljen e tij, por duhet vërejtur se fundi i Ungjillit sipas Markut, që përmban këtë fjali, nuk është autentik, por, sipas R.P.Roge, është tekst *"i shtuar më vonë"*, edhe pse për Kishën është kanonik!

i vetmi mbetet Luka i cili në një tekst të pakontestueshëm evokon episodin e Shëlbimit (24, 51): *"Jezusi u nda prej tyre dhe u ngrit në qiell"*. Ungjilltari e ka vendosur ngjarjen në fund të tregimit mbi ringjalljen dhe dëftimin e të njëmbëdhjetëve. Hollësirat e tregimit ungjillor implikojnë se Shëlbimi ka ndodhur në ditën e ringjalljes. Por në Veprat e Apostujve, Luka -i cili për tërë botën është autor i tyre- përshkruan (1, 2, 3) dëftimin e Jezusit para apostujve ndërmjet Mundimit dhe Shëlbimit me këto shprehje: *"A tyre pas mundimit të tij gjithashtu ju ofroi shumë dëshmi se është i gjallë: iu dëftua dyzet ditë dhe u foli për mbretërinë e Hyut"*. Kjo fjali nga Vepra e Apostujve shërbeu për caktimin e kremtes së krishterë të Shëlbimit dyzet ditë pas Pashkëve, kur kremtohet Ringjallja. Data është caktuar në kundërshtim me Ungjillin sipas Lukës; asnjë tekst ungjillor nuk e arsyeton.

I krishteri habitet kur e kupton këtë gjëndje, sepse kundërthënia është e qartë. Përkthimi Ekumenik i Biblës, Besëlidhja e Re, prapë i pranon faktet, por nuk flet gjerësisht mbi kundërthëniet, duke u kënaqur me atë që ta përmend rëndësinë që kanë pasur këto dyzet ditë për misionin e Jezusit. Komentuesit që dëshirojnë të shpjegojnë çdo gjë dhe t'i pajtojnë të papajtueshmet, me këtë rast na ofrojnë interpretime të çuditshme.

Kështu krahasimi i katër Ungjijve, botim i Shkollës Biblike të Jeruzalemit, i vitit 1972, përmban (lib. 2, fq. 451) komentime tepër të habitshme.

Vetë fjala shëlbim është kritikuar me këto shprehje: *"Vërtet, nuk ka ndodhur shëlbimi në kuptimin fizik, sepse Zoti nuk është më "lart, por poshtë".(sic). Është e vështirë të kuptohet kjo vërejtje, sepse është e vështirë të merret me mend si do të mund të shprehej Luka ndryshe.*

Në një vend tjetër, autori i komentimit sheh *"mjeshtërinë letrare"* në faktin se në *"Veprat është thënë se shëlbimi ka ndodhur dyzet ditë"*

*pas ringjalljes"; e ashtëquajtura "shkathtësi" ka "për qëllim që të theksojë se si periudha e dëftimeve të Jezusit në tokë po i afrohet fundit". Por, shton ai, në Ungjillin sipas Lukës "ngjarja është vendosur në mbrëmjen e të dielës së Pashkëve (Ringjalljes), pasi që ungjilltari nuk lë aspak interval ndërmjet episodeve të ndryshme për të cilat flet, pas zbulimit të varrit të zbrazët në mëngjes, pas ringjalljes..."- "... a nuk është kjo mjeshtri letrare, qëllimi i të cilës është që të lërë pak distancë në kohë për dëftimin e të ringjallurit?" (sic).*

Ndjenja e hutisë që shkaktojnë interpretimet e këtilla është edhe më e qartë në librin e R.P.Roge, i cili dallon ...dy shëlbime!

*"Derisa Shëlbimi, nga pikëpamja e Jezusit, koïncidon me Ringjalljen, ai, nga pikëpamja e nxënësve, ka ndodhur vetëm atëherë kur Jezusi pushon plotësisht t'ju manifestohet në mënyrë që t'u dërgohet Shpirti dhe të fillojë koha e Kishës".*

Lexuesi i cili nuk është në gjendje të kuptojë suptilitetin teologjik të argumentit të tij, i cili nuk ka asnjë fije bazë biblike, autori ia drejton një vërejtje të përgjithshme, model të llafazanërisë apologjetike:

*"Këtu, si edhe në shumë raste të tjera të ngjashme, problemi duket i pazgjithshëm vetëm nëse pohimet e Shkrimeve kuptohen shprehimisht, materialisht, duke harruar domethënien e tyre fetare. Nuk është fjala krijimin e realitetit të fakteve në simbolizimin e pabazë, por për kërkimin e intencës teologjike të atyre të cilët për ngjarjet shqisore na zbulojnë të fshehtat duke na dhënë shenja të papërshtatshëm me ndijimet e ngulitura të shpirtit tonë".*

## **BISEDIMET E FUNDIT TË JEZUSIT - MBROJTËSI NGA UNGJILLI SIPAS GJONIT**

Gjoni është ungjilltari i vetëm, i cili, në përfundim të Darkës së Fundit të Jezusit dhe para arrestimit të tij, tregon episodin mbi bisedën e fundit me apostujt, e cila përfundon me një fjalim tepër të gjatë: katër kapituj të Ungjillit sipas Gjonit (14 -17) i janë kushtuar kësaj ngjarje që nuk shënohet fare në Ungjijtë e tjerë. Por, prapë, në

to trajtohen çështje me interes, prespektivat e të ardhmes me rëndësi themelore, të shprehura me tërë madhësinë dhe madhështinë që e karakterizojnë këtë skenë lamtumirëse të Mësuesit me nxënësit.

Si mund të shpjegohet ajo se te Mateu, Marku dhe Luka mungon tregimi mbi një lamtumirë aq të prekshme, e cila përmban testamentin shpirtëror të Jezusit? Mund të bëhet kjo pyetje: a mos ka egzistuar më parë teksti tek këta tre ungjilltarë? A mos është hequr më vonë? Dhe pse? Të themi shkurt se nuk mund të jepet asnjë përgjigje: misteri mbetet i plotë lidhur me këtë zbrazëti të madhe në tregimin e tre ungjilltarëve të parë.

Ajo që dominon në tregim - është e kuptueshme në bisedën më të madhërishtme - është prespektiva e të ardhmes së njerëzve që e evokon Jezusi dhe kujdesi i Mësuesit që t'u drejtojë nxënësve të vet, e nëpërmjet tyre tërë njerëzimit, porositë dhe urdhërat e veta dhe më në fund të caktojë kush do të jetë udhëheqësi i cili njerëzit duhet patjetër t'i shkojnë pas kur ky të largohet. Vetëm tekstit i Ungjillit sipas Gjonit e quan me emrin grek Parakletos, që në frengjisht është bërë Paraclet. Ja disa nga fragmentet më qenësore sipas Përkthimit Ekumenik të Biblës, Besëlidhja e Re:

**"Nëse më doni, do t'i zbatoni urdhërat e mi. Unë do t'i lutem Atit dhe Ai do t'ju japë një mbrojtës tjetër"** (14,15 -16)

Çfarë do të thotë Mbrojtës? Teksti i Ungjillit sipas Gjonit, që e kemi tani, e shpjegon kuptimin e tij me këto fjalë:

**"E Shpirti i Shenjtë - Mbrojtësi, të cilin Ati do t'jua dërgojë në emrin tim, do t'ju mësojë të gjitha dhe do t'ju rikujtojë gjithçka që u kam thënë"**. (14, 26)

**"Ai do të dëshmojë për mua"**. (15, 26)

**"Është më mirë për ju të shkoj, sepse po s'shkova Mbrojtësi nuk do të vijë te ju, kurse po të shkoj, do ta dërgojë te ju. E kur të vijë Ai do t'ja dëshmojë botës mashtrimin lidhur me mëkatën, drejtësinë dhe gjykimin ..."** (16, 7-8).

**"E kur të vijë Ai - Shpirti i së Vërtetës - Ai s'do t'ju flasë prej vetvete, por do të flasë atë që do të dëgjojë dhe do t'ju zbulojë të ardhmen. Ai do të më lavdërojë mua..."** (16, 13-14).

(Tërheqim vërejtjen se fragmentet nga kreu 14-17 të Ungjillit sipas Gjonit, të cilët nuk i kemi cituar këtu, nuk e ndryshojnë aspak

kuptimin e përgjithshëm të këtyre citateve).

Nëse lexohet shpejt e shpejt, teksti francez që përcakton identitetin e fjalës greke Paraclet me Shpirtin e Shenjtë, me të shumtën nuk e tërheq vëmendjen. Për më tepër që nëntitujt e tekstit, të cilët përdoren përgjithsisht në përkthimet dhe në tekstet e komentimeve në veprat popullore, e orientojnë lexuesin drejt kuptimit që ortodoksia e mirë dëshiron t'u japë këtyre fragmenteve. Nëse do të haset në çfarëdo vështirësi në kuptimin e tij, sa saktësi do të gjendej aty që t'ja bëjnë të gjitha shpjegimet, sikurse ato të A. Tricotit që i jep në Fjalorin e vogël të Besëlidhjes së Re. Nga pena e këtij komentuesi, në artikullin "*Mbrojtësi*", me të vërtetë mund të lexohet kjo që vijon:

*"Këtë emër ose titull të tanskriptuar nga greqishtja në frengjisht e përdor vetëm shën Gjoni në Besëlidhjen e Re: katër herë kur e jep fjalimin e Jezusit pas "Darkës së Fundit ""(14, 16 dhe 26; 15, 26; 16, 7) dhe një herë në letrën e vet të parë (2, 1). Në Ungjillin sipas Gjorit fjala është për Shpirtin e Shenjtë dhe për mesazhin e Krishtit. "Paraclet" ka qenë emërtimi të cilin hebrjtë helenë të shekullit I e kanë përdorur me kuptimin ndërmjetësues, mbrojtës (...) Jezusi paralajmëron se Shpirti do të dërgohet nga Ati dhe i Biri dhe misioni i tij do të zëvendësojë Birin në rolin e ndihmësit mision të cilin e ka kryer në dobi të nxënësve të vetë gjatë jetës së tij të vdekshme. Shpirti do të ndërhyjë dhe do të veprojë si zëvendësim për Krishtin në cilësinë e mbrojtësit ose të ndërmjetësuesit të plotëfuqishëm".*

Ky koment e bën Shpirtin e Shenjtë udhëheqës të fundit të njerëzve pas zhdukjes së Jezusit. A përputhet ky me tekstin sipas Gjorit?

Duhet bërë pyetja sepse a priori duket e çuditshme që Shpirti i Shenjtë mund të përshkruhet me paragrafin që e cituam më sipër: **"Ai nuk do të flasë prej veteves, por do të flasë atë që dëgjon dhe do t'u shpallë të ardhmen"**.

Duket se është e pakonceptueshme që Shpirti i Shenjtë t'i përshkruhen cilësi të tilla se ai **"flet dhe thotë atë që dëgjon"**...Sa di unë, kjo pyetje që na imponon logjika, përgjithësisht nuk është objekt i komentimit.

Që të kemi një pasqyrë të saktë mbi problemin, duhet t'i referohemi tekstit themelor grek, gjë që është me rëndësi sepse është vërtetuar se ungjilltari Gjon ka shkruar greqisht e jo në ndonjë gjuhë tjetër. E

kemi konsultuar tekstin grek nga “*Novum Testamentum graece*”<sup>35</sup>.

Çdo kritikë serioze e teksteve niset nga kërkimi i varianteve. Këtu duket se në të gjitha dorëshkrimet e njohura të Ungjillit sipas Gjonit nuk ka ndonjë variant tjetër që do të mund të ndryshonte kuptimin e fjalisë, përveç asaj të fragmentit 14, 26, nga versioni i njohur në gjuhën sirishte të vjetër, e quajtur *Palimpsest*<sup>36</sup>. Këtu nuk përmendet Shpirti i Shenjtë, por vetëm Shpirti. A thua shkruesi e ka harruar thjesht, apo i ballafaquar me një tekst për kopjim, sipas të cilit Shpirti i Shenjtë do të dëgjonte dhe do të fliste, nuk ka pasur guxim atë që i është dukur absurde? Përveç kësaj vërejtjeje, nuk ka arsye të ngulim këmbë në variante të tjera, përveç në variante gramatikore të cilat nuk ndryshojnë aspak kuptimin e përgjithshëm. Është me rëndësi se kjo që u tha këtu lidhur me kuptimin e saktë të fjalëve “*të dëgjojë*” dhe “*të flasë*” vlen për të gjithë dorëshkrimet e Ungjijve sipas Gjonit.

Folja “*të dëgjojë*” nga përkthimi frëng është folja greke “*acouo*” që do të thotë percipimi i tingujve. Ajo, për shembull, në frëngjisht e ka dhënë fjalën “*acoustique*” (akustik), në anglisht “*acoustics*”, që ka kuptimin e shkencës mbi tingujt.

Folja “*të flasë*” nga përkthimi frëng është folja greke “*laleo*”, që ka kuptim të përgjithshëm emitimi i tingujve, kurse kuptim të veçantë “*të flasë*”. Kjo folje përsëritet shpesh në tekstin grek të Ungjijve për të shënuar ndonjë deklaratë solemne të Jezusit gjatë predikimit të tij. Domethënë, duket se shpjegimi që u bëhet njerëzve, për të cilin bëhet fjalë këtu, nuk konsiston në frymëzimin që do të vinte nga Shpirti i Shenjtë, por ai ka cilësi të qartë materiale për shkak të nocionit të emitimit të tingullit që lidhet me fjalën greke, e cila e përkufizon.

Dy foljet greke “*akouo*” dhe “*laleo*” përkufizojnë veprime konkrete që mund të lidhen vetëm me qënien e paisur me organin e të folurit. Prandaj, nuk është e mundur të aplikohen në Shpirtin e Shenjtë, përkatësisht nuk mund të jenë cilësi të Shpirtit të Shenjtë.

Domethënë, ashtu siç na e kanë përcjellur dorëshkrimet greke, teksti i këtij fragmenti, i një fjalie të vetme, e cila në Ungjillin sipas Gjonit përcakton identitetin ndërmjet Mbrojtësit dhe Shpirtit të Shenjtë: (14,26) **“E Shpirti i Shenjtë-Mbrojtës, të cilin Ati do t’ua dërgojë në Emrin tim ...”** është krejtësisht i pakuptueshëm nëse e pranojmë shprehimisht si Shpirt i Shenjtë.

Por nëse e heqim fjalën Shpirti i Shenjtë (to pneuma to agion) nga



kjo fjali, atëherë i tërë teksti i Gjonit bëhet i qartë. Ai në fund fundit është konkretizuar me një tekst tjetër të ungjilltarit, me letërën e parë, në të cilën Gjoni përdor të njëjtën fjalë “*Mbrojtësi*” për ta treguar thjesht Jezusin si ndërmjetsues të Zoti. Dhe kur Jezusi sipas Gjonit, thotë: ( 14, 16) “**Unë do t’i lutem Atit dhe Ai do t’ju japë një Mbrojtës tjetër**”, ai do të thotë se njerëzve do t’u dërgohet një ndërmjetësues “*tjetër*” të Zoti, si ka qenë edhe ai vetë gjatë jetës së tij tokësore.

Logjikisht kemi arritur deri aty që në Mbrojtësin sipas Gjonit të shohim qenie njerëzore, siç ka qenë dhe Jezusi, të paisur me aftësinë e të dëgjuarit dhe me aftësinë e të falurit, me aftësitë të cilat teksti grek i implikon formalisht. Domethënë Jezusi paralajmëron se Zoti më vonë do të dërgojë një qenie njerëzore në Tokë në mënyrë që ai të luajë rolin që ia ka përcaktuar Gjoni dhe i cili, me një fjalë, është roli i profetit që dëgjon zërin Hynor dhe u përsërit njerëzve porosinë e tij. Kështu është interpretimi logjik i tekstit të Gjonit, nëse fjalive u jepet kuptimi i vërtetë.

Prania e sintagmës “*Shpirti i Shenjtë*” në tekstin që e kemi sot do të mund të zbulonte shumë mirë një shtojcë të mëvonshme krejtësisht të qëllimshme, qëllimi i së cilës është modifikimi i kuptimit të mirëfilltë të një fragmenti, i cili, me paralajmërimin e ardhjes së një profeti pas Jezusit, ka qenë në kundërshtim me mësimet e kishave të krishtera që lindën dhe të cilat dëshiruan që Jezusi të jetë profeti i fundit.

## **PËRFUNDIMET**

Faktet që i përmendëm këtu dhe komentimet e cituara të ekzegetëve të krishterë shumë të njohur i demantuan pohime e ortodoksisë që mbështeten në linjën e miratuar nga koncili i fundit në lidhje me hitorikun absolut të Ungjijve: se ata përcjellin me vërtetësi atë që vërtetë e ka bërë dhe atë që ka mësuar Jezusi.

Arugumentet që i paraqitëm u takojnë kategorive të ndryshme.

Para së gjithash, t’i marrim vetëm citatat nga Ungjijtë që tregojnë kundërthënie të hapëta. Nuk mund të besohet në dy fakte që kundërshtojnë njëri-tjetrin. Nuk mund të pranohen disa gjëra dhe pohime të pabesueshme që janë në kundërshtim me faktet të cilat në

sajë të njohurive bashkëkohore janë vërtetuar në mënyrë të përkryer. Dy gjenealogjitë e Jezusit, që i gjejmë në Ungjijtë, dhe të pavërtetat që implikojnë ato, janë krejtësisht demonstrative në këtë pikëpamje.

Shumë të krishterë nuk dinë për këto kundërthënie, gjëra të pabesueshme dhe të papërputhshme me shkencën bashkëkohore dhe habiten kur i zbulojnë, aq shumë janë nën ndikimin e leximit të komentimeve që ofrojnë shpjegime subtile, të cilat janë në gjendje t'i qetësojnë me ndihmën e lirismit apologjetik. Kemi dhënë shumë shembuj karakteristikë të mjeshtresë së disa apologjetëve për ta maskuar atë që me turp e quajnë “*vështirësi*”. Vërtet janë shumë të rralla fragmentet nga Ungjijtë që pranohen si joautentikë, kurse Kisha i ka shpallur zyrtarisht si kanonikë.

Sipas R.P.Kannengiesser punimet shkencore të kritikës bashkëkohore të teksteve kanë zbuluar të dhëna që paraqesin “*revolucionin e metodave ekzegete*” dhe çojnë deri aty që “*më mos të kuptohen shprehimisht*” faktet “*e shkruara sipas rasteve*” ose “*luftarakisht*” që Ungjijtë i paraqesin për Jezusin. Njohuritë bashkëkohore, pasi e kanë ndriçuar historinë judeo-krishtere dhe të rivalitetit ndërmjet bashkësive, shpjegojnë ekzistimin e fakteve që i habisin lexusin e kohës sonë. Më nuk mund të mbrohet pikëpamja mbi ungjilltarët dëshmitarë, por këtë e mbrojnë edhe më tej shumë të krishterë. Punimet e Shkollës Biblike të Jeruzalemit (R.P. Benoid dhe R. P. Boismard) tregojnë shumë mirë se Ungjijtë kanë qenë shkruar, rishkruar dhe përmirësuar shumë herë. Kështu ata e kanë tërhequr vëmendjen e lexuesit se “*në më shumë se një rast duhet të heqin dorë nga ajo se po e dëgjojnë drejt për drejt zërin e Jezusit*”.

Karakteri historik i Ungjijve nuk është kontestues, por këto dokumenta, ndërmjet tregimeve që i përkasin Jezusit, na informojnë mbi mentalitetin e autorëve, të cilët janë gojëtarë të traditës së bashkësive të krishterë primitive të cilave u takojnë, e posaçërisht mbi luftat ndërmjet judeo-krishterëve dhe Palit: punimet e kardinal Danielit janë meritore për këto çështje.

Atëherë si të habitemi që ungjilltarët, qëllimi i të cilëve është të mbrojnë një pikëpamje personale, i ndryshojnë disa ngjarje nga jeta e Jezusit, si të habitemi me heshtjen e disa ngjarjeve, si të habitemi me karakterin romanizues të përshkrimeve të disa të tjerave?

Kemi arritur deri aty sa Ungjijtë t'i krahasojmë me këngët tona të trimërisë të letërsisë mesjetare. Krahasimi që mund të bëhet me “*Këngën mbi Rolandin*”, më të njohurën nga të gjitha, e cila në

mënyrë të romanizuar e paraqet një ngjarje të vërtetë, është sugjestiv. A dihet gjë për atë tregimin e një episodi autentik: mbi pritën që i është ngritur tërheqjes së Karlit të madh, të cilën e ka drejtuar Rolandi, në grykën e Roncevoksit? Ky episod me rëndësi dytësore sipas kronikës historike (Eginhard), ka ndodhur më 15 gusht 778; Ai është shndërruar në një vepër tepër të madhe trimërie, sa një betejë e luftës së shenjtë. Tregimi është fantastik, por, kjo fantazi nuk mund ta errësojë realitetin e një betejë që Karli i Madh ka qenë i detyruar ta ndër marrë për t'i siguruar kufijtë e vet nga përpjekja e popujve të tjerë për depërtim: këtu qëndron origjinalja, por mënyra epike e rrëfimit nuk e shlyen.

E njëjta gjë vlen edhe për Ungjijtë: fantazmagoritë e Mateut, kundërthëniet e hapta mes Ungjijve, gjërat e pabesueshme, mospërputhjet me të arriturat e shencës bashkëkohore, ndryshimet e vazhdueshme në tekste, bëjnë që Ungjijtë të kenë kapituj dhe fragmente që vetëm e zbulojnë imagjinatën e njeriut. Por këto mangësi nuk e vënë në dyshim ekzistimin e misionit të Jezusit: dyshimet rrinë pezull vetëm mbi zhvillimin e atij misioni.

## **KURANI                      DHE                      SHKENCA BASHKËKOHORE**

### **I**

### **HYRJE**

Një lidhje e tillë e Kur'anit dhe shkencës bashkëkohore a priori habit sepse bëhet fjalë për përputhjen e jo për mospërputhjen. Po a thua krahasimi i një libri fetar me pikëpamjet profane në të cilat mbështet shkenca nuk duket në sytë e shumicës si diçka paradoksale në kohën tonë? Me të vërtetë, sot shkencëtarët, përveç në disa

përjashtime, janë të frymëzuar me teori materialiste dhe shpesh janë indiferent ose kanë një urrejtje ndaj çështjeve fetare, që ata i konsiderojnë si të bazuara në legjenda. Për më tepër, kur në vendet tona Perëndimore flitet për shkencën dhe fenë, diptikun fetar e përfshijnë vetëm besimin hebraik dhe krishtërimin, por as që mendohet fare për ta futur edhe Islamin. Për të, në fund të fundit, janë dhënë mendime aq të pasakta, të cilat janë mbështetur në pikëpamje të gabuara, kështu që sot është shumë vështirë të paraqitet një pasqyrë lidhur me atë se ç'është në të vërtetë Islami.

Siç duket, si hyrje të çdo konfrontimi të Shpalljes Islame me shkencën, është absolutisht e nevojshme të jepet një pasqyrë e shkurtër e një feje që është aq pak e njohur në vendet tona.

Të gjitha gjykimet e gabuara që janë bërë për Islamin në Perëndim janë rezultat e mosnjohjes dhe i njollosjes sistematike. Por e pavërteta më e rëndë që është përhapur janë të pavërtetat që kanë të bëjnë me faktet, sepse nëse mashtrimet në gjykime mund të falen, paraqitja e fakteve në kundërshtim me të vërtetën nuk mund të falet. Njeriu çmeritet kur në veprat më serioze, që janë shkruar nga autorë shumë kompetentë, lexon fragmente të pavërteta. Ja një shembull: në Encyklopedia Unviersalis, libri 6 artikulli "Ungjijtë" është bërë aludim në ndryshimin në raport me Kur'anin dhe autori shkruan: "Ungjilltarët (...) nuk pretendojnë (...) si Kur'ani që të japin autobigrafinë të cilën Zoti, për çudi, ja ka diktuar Profetit..." Kur'ani nuk ka kurrëfarë lidhje me autobigrafinë: ai është predikim; sikur autori të kishte konsultuar përkthimin më të keq, ai do të mund të bindej në këtë. Ky konstatim është aq i kundër me të vërtetën sikur Ungjijtë t'i përkufizonim si tregim mbi jetën e një ungjilltari. Për këtë të pavërtetë mbi Kur'anin është fajtor një profesor i Fakultetit Teologjik të Jezuitëve në Lion! Thënia e të pavërtetave të këtij lloji bën që të krijohet pasqyrë e rreme mbi Kur'anin dhe Islamin.

Ka arsye për shpresë, pra, sepse sot fetë nuk janë si dikur të kthyer nga vetvetja dhe shumë prej tyre kërkojnë mirëkuptim reciprok. Si të mos çuditemi me faktin se në shkallën më të lartë të hierarkisë, katolikët e krishterë përpiqen të vënë kontakt me muslimanët, duke u përpjekur që të shmangin keqkuptimin dhe duke u kujdesur që t'i reformojnë mendimet jo të sakta të përhapura mbi Islamin.

Në Hyrjen e këtij libri unë e kam përmendur ndryshimin mjaft të rëndësishëm që ka ndodhur viteve të fundit dhe e kam përmendur një dokument që ka dalë nga Sekretariati i Vatikanit për jo të krishterët, i quajtur: "Orientimet për dialog ndërmjet të krishterëve dhe muslimanëve", një dokument tepër i rëndësishëm për qëndrimin

e ri që është mbajtur ndaj islamit. "Ai kërkon, - lexojmë në botimin e tretë (1970) të këtij studimi, - revizionin e qëndrimit tonë ndaj tij dhe kritikën e paragjytimeve tona... Duhet të merremi më parë me atë që shkallë-shkallë të ndryshojmë mentalitetin e vëllezërve tanë të krishterë. Kjo është para së gjithash e rëndësishme". Duhet të heqim dorë nga "paraqitja e vjetëruar që është trashëguar nga e kaluara dhe e shtrembëruar me paragjytime dhe shpifje... të pranohen padrejtësitë në raport me muslimanët për të cilat është përgjegjës Perëndimi i krishterë"<sup>37</sup>. Dokumenti i Vatikanit, i cili ka gati njëqind e pesëdhjet faqe, në këtë mënyrë përhap demantimin e mendimeve klasike që të krishterët i kanë pasur mbi Islamin dhe tregojnë se është ky dokument në të vërtetë.

Me titullin "Të lirohemi nga paragjykimet tona më të mëdha", autorët e këtij dokumenti ua drejtojnë këtë thirrje të krishterëve: "Këtu ne, gjithashtu, duhet të ndërmarim një pastrim të thellë të mentaliteteve tona. Ne veçanërisht mendojmë në disa gjykime të gatshme që i shprehim shpesh dhe shpejtë mbi Islamin. Duket se është kapitale që në asnjë mënyrë mos t'i kultivojmë në thellësi të zemrave tonë këto mendime shumë të ngutshme dhe arbitrare në të cilat nuk mund të njihet muslimani i sinqertë".

Njëri nga mendimet e tilla arbitrare të shkallës më të lartë është ai që na shtyn që në gjuhën tonë të përdorim sistematikisht fjalën All-llah për ta shënuar Zotin musliman, sikur muslimanët të besonin në një Zot tjetër që nuk është Zot i krishterë. Në arabishte fjala All-llah do të thotë Hyjni; pra është fjala për një hyjni të vetme gjë që implikon që përkthimi korrekt frënk mund të japë kuptimin e drejtë vetëm me anë të fjalës "Zot". Për muslimanin All-llahu nuk është askush tjetër përveç Zotit të Moisiut (Musait) dhe të Jezusit (Isai a.s.).

Dokumenti i Sekretariatit të Vatikanit për jo të krishterët këmbëngul në këtë fakt themelor me këto fjalë:

"Duket se është e kotë mbrohet mendimi, së bashku me disa Perëndimorë, që All-llahu me të ëvrtetë nuk është Zot! Tekstet e Koncilit kanë dhënë gjykim të drejtë për një pohim të tillë. Do të ishte vështirë të bëhej një rezymë më e mirë për besimin Islam në Zotin se sa e bën këtë kjo fjali në Lumena Gentiuma: "Muslimanët që e predikojnë besimin e Abrahamit e adhurojnë së bashku me ne të vetmin Zot mëshirëplotë, gjyqtarin e ardhshëm të njerëzve bë Ditën e Gjykimit..."

Prandaj, për këtë arsye, është e kuptueshme protesta muslimane

kundër zakonet shumë të shpeshtë që në gjuhët europiane nuk thuhet Zot, por "All-llah"... Muslimanët e arsimuar e kanë lavdëruar përkthimin e D. Massonit me që në të më në fund është shkruar "Zot" e jo "All-llah". Kurse teksti i Vatikanit thotë: "All-lalhu është e vetmja fjalë që të krishterët e gjuhës arabe e kanë për të shënuar Zotin".

Muslimanët dhe të krishterët e adhurojnë një Zot të vetëm.

Dokumenti i Vatikanit pastaj kritikon gjykimet e tjera të gabuara mbi Islamin.

Është shqyrtuar paragjykimi aq i përhapur mbi "fatalizmin musliman" dhe, me ndihmën e citateve nga Kur'ani dokumenti ja ka kundërvënë mendimin mbi përgjegjësinë e njeriut që do të jetë i gjykuar për veprat e veta. Ai tregon se pikëpamja mbi legjisllacionin Islamik është e gabuar dhe ja vë përballë pikpamjen mbi sinqeritetin e besimit duke i vituar dy fjali që kanë qenë të panjohura plotësisht nga Perëndimorët:

"Në fe nuk ka dhunë" (S2 - A256)

"... dhe nuk ju obligoi në fe me ndonjë vështirësi, në fenë e babait tuaj, Ibrahimit." (S22 - A78).

Përfytyrimit të përhapur mbi Islamin si fe të frikës, dokumenti ja kundërvë Islamin, si fe të dashurisë; dashuria ndaj të afërmit është rrënjësor ndaj besimit në Zotin. Ai e hedh e poshtë idenë e propagandës së rreme, sipas të cilës nuk ekziston morali musliman, si dhe atë, për të cilën mendojnë njësoj aq shumë hebrej dhe të krishterë, mbi fanatizmin musliman; komentimi është si vijon: "Gjatë historisë së tij Islami nuk ka qenë aspak më fanatik se krishterimi kur ka qenë fjala për shkaqe politike". Këtu autorët citojnë shprehje nga Kur'ani të cilat shprehje Perëndimorët i përkthejnë gabimisht si "luftë e shenjtë"<sup>39</sup> që në arabisht do të thotë "Al xhihad fi sabil All-llah, për përpjekje në rrugën e Zotit", "përpjekje në përhapjen e Islamit dhe në mbrojtjen e tij nga agresori". Dhe dokumenti i Vatikanit vijon: "Xhihadi nuk është në asnjë mënyrë kheremi biblik, ai nuk kërkon shfarosje, por kërkon të përhapë të drejtën e Zotit dhe të njerëzve në viset e reja". - "Dhunimet e kaluara të xhihadit kanë ndjekur, përgjithësisht, ligjet e luftës, kurse në kohën e kryqëzatave nuk kanë qenë gjithnjë muslimanët ata që kanë vlarë më së shumti". Dokumenti më në fund trajton paragjykimin sipas të cilit Islami do të ishte një "besim i ngurtë që adhuruesit e vet i mban në prapambetjen e Mesjetës së

dikurshme dhe i bën e paaftë që t'iu përshtaten të arriturave teknike të kohës bashkëkohore". Ai bën krahasime me situatën analoge që janë vërejtur në vendet e krishtera dhe deklaroi: "Ne (...) në elaborimin tradicional të mendimit musliman gjejmë pranimin e evoluimit të mundshëm të shoqërisë borgjeze".

Kjo mbrojtje e Vatikanit ndaj Islamit do t'i çuditë shumë, jam i sigurt, bashkëkohësit tanë që besojnë, qofshin ata muslimanë, hebrenj ose të krishterë. Ky është manifestim i sinqeritetit dhe i frymës së hapjes që në mënyrë të pazakonshme bie ndesh me qëndrimet nga kaluara. Por, sa pak Perëndimorë dinë për këto pikëpamje të reja që i mbajnë në nivelet më të larta të Kishës së krishterë.

Vetëm atëherë kur na bëhet e njohur ky fakt çuditëmi më pak kur të njihemi me ç'vepra konkrete ka qenë vulosur ky afrim: së pari kryetari i Sekretariatit të Vatikanit për jo të krishterët u prit të mbreti i Arabisë Saudite, Fejsali, pastaj u bë pritja solemene dijetarëve të mëdhenj nga Arabia te papa Pali VI, gjatë vitit 1974. Prej kësaj kohe kuptohet më mirë rëndësia e madhe shpirtërore e pritjes që ju bë dijetarëve të mëdhenj tek imzot Elchingeri, në katedralen e tij në Strasburg, gjatë së cilës prelati i ftoi dijetarët që të falen në korpusin e katedrales, gjë që ata e bënë para altarit, të kthyer në drejtim të Mekës. Nëse përfaqësuesit e nivelit më të lartë të botës muslimane dhe të krishterë, duke besuar në të njëjtin Zot, dhe duke respektuar reciprokisht dallimet, pajtohen ashtu sa të fillojnë një dialog fetar, a nuk është e natyrshme që edhe aspektet e tjera të çdo Shpalljeje të konfrontohen? Objekte të këtij konfrontimi këtu është shqyrtimi i Librave të Shenjtë në dritën e të arriturave dhe të njohurive shkencore që kanë të bëjnë me origjinalitetin e teksteve. Këtë shqyrtim duhet bërë për Kur'anin, ashtu siç është bërë edhe për besimin hebraik e të krishterë.

Marrëdhëniet mes besimeve dhe shkencës nuk kanë qenë të njëjta kudo dhe në të gjitha kohët. Është fakt se asnjë shkencë e një feje monoteiste nuk e dënon shkencën. Por duhet pranuar se në praktikë shkencëtarët janë grindur me autoritetet fetare të disa konfeksioneve. Në mesin e krishterë, gjatë shumë shekujsh, autoritetet përgjegjëse, me iniciativën e tyre dhe pa u mbështetur në tekstet autentike të Librave të Shenjtë, e kanë kundërshtuar zhvillimin e shkencës. Ata dalin kundër atyre që janë përpjekur t'i zhvillojnë duke ndërmarrë masa që i njohim dhe që shpesh i kanë detyruar shkencëtarët të emigrojnë, nëse kanë dashur t'i shpëtojnë stivës së druve, përveç rastit nëse janë penduar publikisht, e kanë ndërruar qëndrimin e tyre dhe janë lutur për falje. Me këtë rast merret si shembull shpesh rasti i Galileut, i cili ka qenë i ndjekur për

shkak se i ka korrigjuar zbulimet e Kopernikut mbi rrotullimin e Tokës. Ai ka qenë i dënuar për interpretimin e gabuar të Biblës, sepse asnjë Shkrim ( i Shenjtë) nuk ka mundur të citohet si duhet kundër tij.

Në Islam, qëndrimi ndaj shkencës ka qenë përgjithsisht i ndryshëm. Asgjë nuk është më e qartë se hadithi i famshëm i Profetit: "Kërkoje shkencën qoftë edhe në Kinë" ose ai tjetri, sipas të cilit, kërkimi i diturisë është detyrim i rreptë që i është imponuar çdo muslimani dhe muslimaneje. Është me rëndësi të madhe, siç do të shohim më tej në këtë pjesë të librit, që Kur'ani, i cili vazhdimisht thërret për kultivimin e shkencës, përmban shqyrtime të shumta të fenomeneve të natyrës me detale eksplikative që janë tërësisht në përputhje me të arriturat e shkencës bashkëkohore. Ekuivalentët e këtij lloji nuk egzistojnë në Shpalljen hebraiko-krishtere.

Përsëri do të ishte gabim të besohet se në asnjë kohë të historisë së Islamit besimtarët e tij nuk kanë pasur qëndrime të kundërta ndaj shkencës. Është fakt se në disa epoka detyrimi i arsimimit personal dhe arsimimit të tjerëve ka qenë kuptuar keq dhe se në botën muslimane, si edhe çdokund tjetër, ndonjëherë është bërë përpjekje që të ndalet progresi shkencor. Por, ta sjellim ndër mend se në periudhën e rritjes së Islamit, ndërmjet shekujve VIII dhe XII të erës së krishterë, është bërë një numër i madh hulumtimesh dhe zbulimesh shkencore në universitetet islamike, kurse në vendet tona të krishtera ka qenë imponuar kufizimi në zhvillimin shkencor. Në këtë epokë mu aty kanë egzistuar mundësi të shkëlqyeshme për kulturë. Në Bibliotekën e khalifit, në Kordobë, ka pasur 400.000 libra. Aty ka ligjëruar Averosi (Ibni Rushdi 1126- 1198)40. Aty është transmetuar shkenca greke, indase dhe persiane. Ja përse nga shumë vende të Europës kanë shkuar në Kordobë, ashtu siç shkojnë sot për përkryerjen e studimeve në SHBA. Sa dorëshkrime të vjetra kanë arritur deri tek ne me anë të shkencëtarëve arab të cilët në vendet e pushtuara sillnin kulturën! Sa i kemi borxh kulturës arabe në matematik (algjebra është arabe), në astronomi, fizikë (optika), gjeologji, botanikë, mjekësi (Avicena- Ibni Sina 980-1037) 41etj. Shkenca për herë të parë mori karakter ndërkombëtar në fakultetet islamike të Mesjetës. Në këtë epokë njerëzit kanë qenë më shumë të përshkuar me frymën fetare se sa janë sot, por kjo nuk i ka penguar që në mjedisin Islam të jenë njëkohësisht besimtarë dhe shkencëtarë. Shkenca ka qenë binjake e fesë; nuk ka qenë dashur të pushojë së qëni si e tillë.

Në vendet e krishtera, në këtë epokë mesjetare, kanë mbisunduar stagnimi dhe konformizmi absolut. Hulumtimin shkencor, si të



thuash, nuk e ka frenuar Shpallja hebraiko-krishtere, por atë e kanë bërë, po e përsërisim, atë e kanë bërë ata që janë shpallur ai zyrtarë të saj. Pas Rilindjes, reagimi i natyrshëm i shkencëtarëve ka qenë që t'u revanshohen kundërshtarëve të tyre të djeshëm dhe ky revansh vazhdon edhe në kohën tonë, deri në atë masë, sa që sot në Perëndim të flasësh për Zotin do të thotë të të konsiderojnë për të çuditshëm. Ky qëndrim i sulmon të gjithë të rinjtë që mësojnë në universitetet tona, duke përfshirë këtu edhe muslimanët.

Si mos të jetë kështu kur dihet se çfarë pikëpamje ekstreme kanë pasur shkencëtarët tanë më të njohur. Një fitues i çmimit Nobel për mjekësi ka provuar në vitet e fundit që në një libër, të cilën ia ka kushtuar publikut të gjërë, ta imponojë idenë se në sajë të rastit, materia e gjallë është krijuar vetëvetiu nga disa përbërës elementarë dhe se nga kjo materie e gjallë primitive, nën ndikimin e rrethanave të jashtme të shumëllojshme, janë formuar qenie të gjalla të organizuara për të arritur deri te kompleksi i çuditshëm siç është njeriu.

A thua çuditë e njohurive shkencore bashkëkohore në fushën e jetës nuk do ta detyronin ta çojnë në përfundim të kundërt personin që mendon? A thua organizmi, i cili drejton lindjen e jetës dhe mbajtjen e saj, nuk i paraqitet atij që e studion gjithnjë e më i komplikuar: sa më shumë të njihet në hollësi, aq më shumë shkakton admirim edhe më të madh. A thua njohja e tij nuk na shtyn se roli i rastësisë në fenomenin e jetës është gjithnjë e më pak i besueshëm? Sa më shumë të arrihen njohuri, e sidomos të tilla që i takojnë vogëlsisë së pakufishme, aq më të qarta janë argumentet që tregojnë se ka një Krijues. Por në vend se para këtyre fakteve njeriu të bëhet më i bindur dhe më modest, ai përkundrazi mburret me kryelartësi. Ai beson se është i autorizuar për ta përqeshur çdo ide mbi Zotin, ashtu siç e nënvlerëson çdo gjë që has në rrugën e tij, nëse ajo paraqet ndonjë pengesë për kënaqësinë dhe orekset e tij për t'u kënaqur. E tillë është shoqëria materialiste që është në ekspansion të plotë në Perëndim.

Çfarë force shpirtërore duhet t'i kundërvejmë kësaj ndotjeje të mendimit nga shumë shkencëtarë bashkëkohorë?

Para baticës së materializmit dhe pushtimit të Perëndimit nga ateizmi edhe krishtërimi edhe hebraizmi tregojnë paaftësi për t'u mbrojtur. Ata janë tërësisht të shushatur dhe nga dhjetëvjeçari në dhjetëvjeçar dobësohet rezistenca ndaj rrymës që kanoset të marrë gjithçka me vete. Për ateistin materialist krishterimi klasik është vetëm një sistem të cilin e kanë ndërtuar njerëzit dhe në të kanë

punuar gati dy mijëvjeçare për ta përforcuar autoritetin e një pakice mbi të afërmit e tyre. Ai në shkrimet judeo-krishtera nuk mund të gjejë gjuhën e cila së paku nga larg do të ishte e ngjashme me të tijën: këto përmbajnë aq të pavërteta, kontradikta dhe mungesë përputhshmërie me të arriturat e shkencës bashkëkohore, sa që ai refuzon së paku të marrë në shqyrtim tekstet të cilat shumica e pafund e teologëve dëshiron t'i ofrojë si tërësi të pandashme.

A i flitet për Islamin? Ai zgërdhohet me arrogancë të tillë të cilës i përgjigjet vetëm njohja e tij e mangët e lëndës. Si shumica e intelektualëve Perëndimorë, pa marrë parasysh çfarë bindjesh fetare kanë, ai për vete ka tepri impresive të përfytyrimeve të rreme.

Nga ky pikëvështrim duhet të arsyetojmë deri diku: para së gjithash, me përjashtim të pikëpamjeve tërësisht të reja të niveleve më të larta të katolicizmit, Islami në vendet tona ka qenë gjithnjë objekt i asaj që quhet "fyerje qindvjeçare". Secili Perëndimor, që për të ka marrë njohuri më të thella, e di se deri në ç'masë historia e tij, ideologjia e tij dhe qëllimet e tij kanë qenë të shëmtuara. Duhet t'i marrim njësoj parasysh faktet se dokumentet që janë botuar në gjuhët Perëndimore lidhur me këtë objekt, përveç studimeve shumë të specializuara, nuk ia lehtësojnë punën atij që dëshiron të marrë informacione.

Në të vërtetë njohja e Shpalljes Islamike nga ky pikëvështrim është themelore. Por ka raste kur fragmentet nga Kur'ani, më tepër ato që janë të lidhura me të dhënat e shkencës, janë përkthyer keq ose janë komentuar në atë mënyrë sa që shkencëtari do të kishte të drejtë - me arsye, natyrisht sikur - t'i kritikonte po të cilat kritika Libri nuk i meriton. Ja një hollësi që vlen të theksohet këtu: këto pasaktësi të përkthimit ose këto komentime të gabuar (që të dyja janë të lidhura shpesh), të cilat nuk do të ngjallnin habi para një apo dy shekujsh, sot e stepin shkencëtarin të cilin një fjali e përkthyer keq, e cila për këtë arsye përmban pohim shkencor të palejueshëm, e shtyn që të mos e marrë seriozisht në shqyrtim. Në kapitullin kushtuar riprodhimit njerëzor do të japim një shembull shumë karakteristik të këtij lloji të mashtrimit.

FORMIMI DHE EVOLUCIONI I GALAKTIKËS SË YJEVE DHE E SISTEMIT PLANETAR

Ç'kishte ekzistuar në fillim në hapësirën e pafund që e zënë galaktikat? Shkenca bashkëkohore mund të japë një përgjigje në këtë pyetje vetëm duke filluar prej një periudhe largësinë kohore të së cilës nuk mund ta shënojë me shifra.

Shkenca disponon me të gjitha shkaqet për të konsideruar se në kohët më të largëta Gjithësia është krijuar prej një mase, përkatësisht materie të gaztë, e cila përbëhej kryesisht nga hidrogjeni dhe pjesërisht nga heliumi në rrotullim të ngadalshëm. Kjo mjegullnajë e dendur pastaj është ndarë në shumë grupime me përmasa dhe masa të konsiderueshme. Astrofizikanët vlerësojnë se ato janë një miliard deri 100 miliardë herë më të mëdha se masa e sotme e Diellit, e cila është 300.000 herë më e madhe se e Tokës. Këto madhësi tregojnë rëndësinë e pjesëve të masës së gaztë, nga e cila pastaj do të krijohen galaktikat.

Grisja e re do t'i formojë yjet. Atëherë ndodhi një proces i kondensimit me ç'rast futen në veprim forcat e gravitetit (sepse këta trupa janë në lëvizje gjithnjë më të madhe dhe rrotullim më të shpejtë), presionet, ndikimi i fushave magnetike dhe rrezatimet. Yjet bëhen të shndritshëm duke vezulluar dhe duke i shndërruar forcat e gravitetit në energji termike. Në këtë kuadër futet në veprim edhe reaksioni termobërthamor dhe me fuzion atomet me peshë më të madhe formohen në dëm të atomeve më të lehta: kështu kalohet prej hidrogjenit në helium, pastaj në karbon dhe oksigjen, për të arritur gjer te metali e jometali. Kështu yjet bëjnë jetën e vet dhe astronomia bashkëkohore i klasifikon mbi bazë të fazave të evoluimit të tyre. Yjet e kanë edhe kohën e vdekjes: është vërejtur sesi në fazën e fundit të evoluimit bëhet zvogëlimi i madh dhe i shpejtë i disa yjeve të cilët bëhen "trupa të vërtetë shkëmborë".

Planetët, posaçërisht Toka, gjithashtu rrjedhin prej një procesi të ndarjes, duke filluar nga baza fillestare çfarë ishte fillimisht mjegullnaja. Por, mëse një çerek shekulli nuk kundërshtohen indikacionet se Dielli ishte kondensuar në brendinë e një mjegullnaje të jashtëzakonshme dhe se planetet e kishin bërë të njëjtën gjë në periferi të kësaj mjegullnaje gjigante e cila e kishte rrethuar atë. Duhet të vërejmë (e kjo është me interes të madh për lëndën për të cilën kemi fjalën këtu) se nuk kishte vazhdimësi në formimin e elementit tokësor. Ekziston paralelizëm evolutiv me njëjtësinë e prejardhjes. Këtu shkenca na jep njohuri mbi epokën në të cilën ishin zhvilluar ngjarjet, të cilat i përmendëm ashtu si janë zhvilluar, në mënyrë mjaft të saktë. Derisa vjetërsia e Galaktikës sonë vlerësohet përafërsisht në 10 miliardë vjet, pak më shumë se 5 miliardë vjet më vonë, sipas kësaj hipoteze, do të marrë pjesë në formimin e sistemit diellor. Hulumtimi i radioaktivitetit natyror mundëson që vjetërsia e Tokës dhe momenti i formimit të Diellit të vlerësohet 4,5 miliardë vjet, me një saktësi së paku prej 100 milion vjetësh, sipas përlllogaritjes së disa shkencëtarëve. Kjo saktësi provokon të nderohet pasi edhe pse 100 milionë vjet janë një periudhë e madhe, raporti ndërmjet pasaktësisë maksimale dhe kohës

së përgjithshme që matet është 0,1:4,5 ose 2,2%.

Kështu astrofizikanët kanë arritur gjer në një shkallë të lartë të njohurive të procesit të përgjithshëm të formimit të sistemit diellor, për të cilin mund të konkludojmë si vijon: kondensimi dhe dendësimi i masës së gaztë në rrotullim e sipër, ndarja në grupe të veçanta të cilat i ka lënë Dielli dhe planetet, në mes tyre Tokën. Këto të arritura të shkencës lidhur me njohuritë mbi mjegullnajën fillestare dhe mënyrën e ndarjes së saj të pafund, në shumë yje të grumbulluar në galaktika, nuk lë kurrëfarë dyshimi në ligjshmërinë e konceptit mbi shumësinë e botëve, por ato nuk ofrojnë kurrëfarë saktësie për ekzistimin në Gjithësi të diçkaje, e cila pak a shumë mund t'i ngjajë Tokës.

## KONCEPTI I SHUMËSISË SË BOTËVE

Astrofizikanët e sotëm konsiderojnë se është krejtësisht e mundur prania e planeteve të ngjashëm me Tokën. Sa i përket sistemit diellor, asnjë njeri i arsyeshëm nuk mendon se në një planet tjetër të këtij sistemi ka kushte të përgjithshme që janë të ngjashme me ato të Tokës. Duhet, pra, t'i kërkojmë jashtë sistemit diellor. Ekzistimi i tyre eventual jashtë këtij konsiderohet si i mundshëm për këto shkaqe.

Konsiderohet se në Galaktikën tonë afër gjysma e të 100 miliardë yjeve duhet të kenë sistemin planetar sikurse Dielli. Vërtetës këta 50 miliardë yje kanë sistem sikurse të Diellit, rrotullim të ngadalshëm, veti që të bën të mendosh se rreth tyre ekzistojnë planetet si satelitë. Largësia e këtyre yjeve është e tillë që satelitët planetarë të supozuar nuk janë të dukshëm, por ekzistimi i tyre konsiderohet shumë i besueshëm për shkak të disa karakteristikave të orbitave: valëzimi i lehtë i orbitave të yjeve është shenjë e pranisë së një shoqëruesi sateliti planetar. Kështu ylli i Bernardit do ta kishte së paku një shoqërues planetar, masa e të cilit është më e madhe se e Jupiterit e, ndoshta, edhe dy satelitë. P. Guerin ka shkruar: "Është e qartë se sistemet planetare janë me shumicë të përhapur në Gjithësi. Sistemi diellor dhe Toka nuk janë të vetmit..." Dhe si përkrahje: "Jeta, si edhe planetet që i japin strehim, është e përhapur në tërë Gjithësinë, gjithkund ku ka gjetur kushte fiziko-kimike të nevojshme për fillimin dhe zhvillimin e saj".

## MATERIA NDËRYJORE

Proçesi bazë i formimit të Gjithësisë ishte përbërë nga kondesimi i materies fillestare të mjegullnajës së Gjithësisë, pastaj në ndarjen e saj në pjesë të cilat në fillim formuan masat galaktike. Këto pastaj u copëtuan në yje, të cilat, sikurse nënproduktet e prodhimit, dhanë planetët. Këto ndarje të pandërprera kanë lënë ndërmjet grupimeve të elementëve kryesorë ato që do t'i quanim mbetje, përkatësisht mbeturina. Këto quhen me termin e njohur shkencor: materie galaktike ndëryjore. Kjo materie është përshkruar herë si mjegullnajë shndritëse me shkëlqim të madh të cilat përhapin dritën që e marrin nga yjet e tjerë, e që, sipas astrofizikantëve, kanë mundur të formohen prej "pluhurit" ose "avullit", herë si mjegullnaja të errëta, me dëndësi të dobët ose si materie ndëryjore dhe më diskrete, e njohur për pengimin e matjeve fotometrike në astronomi. Ekzistimi i "urave" të materieve ndërmjet galaktikave është i padyshimtë. Sido që të jenë rradhitur këto gazra, ata, për shkak të hapësirës gjigante që zënë për arsye të largësisë reciproke të paskajshme të galaktikave, kishin mundur t'i përshtaten një mase, e cila, ndonëse me dëndësinë e saj të dobët mund të tejkalojë tërësinë e masave galaktike. A. Boichot kësaj ekzistence të masave ndërmjet galaktikave i jep rëndësi të shkallës së parë, e cila do të mund "të ndryshojë dukshëm idenë mbi evolucionin e Gjithësisë".

Në dritën e këtyre arritjeve të shkencës së sotme, duhet të shqyrtojmë përsëri idetë bazë mbi krijimin e Gjithësisë, të nxjerra prej Kur'anit.

## KONFRONTIMI ME TË DHËNAT KUR'ANORE MBI KRIJIMN

T'i hulumtojmë pesë pika të rëndësishme për të cilat Kur'ani ofron të dhëna të sakta kur është fjala për krijimin.

1. Gjashtë periudhat kohore të krijimit të qiejve dhetë Tokës sipas Kur'anit, mbulojnë formimin e trupave qiellorë, formimin e Tokës dhe zhvillimin e këtyre të fundit, kur ende nuk ishte bërë (me "ushqimin" e saj) e banueshme për njeriun. Për këtë të fundit, ngjarjet sipas tregimit Kur'anor janë zhvilluar në katër periudha kohore. A duhet në këtë të vërejmë epokat teologjike të cilat i përshkruan shkenca bashkëkohore, kurse njeriu, siç është e njohur, është paraqitur në kvartar (periudha e katërt e formimit të Tokës). Kjo është hipoteza e rëndomtë, sepse askush nuk mund të përgjigjet në këtë pyetje.

Por duhet kuptuar se për formimin e trupave qiellorë dhe për formimin e Tokës ishin të nevojshme dy faza, sikurse shpjegohet në ajetet 9 gjer në 12 të sures 41. Shkenca neve na mëson se nëse merret si shembull (dhe i vetmi shembull i

mundshëm) formimi i Diellit dhe nënprodukti i tij -Tokës, procesi është zhvilluar me kondensimin e mjergullnajës së parë dhe copëtimin të saj. Pikërisht këtë e shpreh Kur'ani në mënyrë krejt eksplicite duke përmendur proceset, të cilat, duke u nisur nga "avulli" qiellor, prodhuan bashkimin e pastaj copëtimin. Këtu vërejmë njëjtësinë e përkryer të të dhënave kur'anore me ato shkencore.

2. Shkenca ka vërtetuar gërshetimin e dy ngjarjeve të formimit të një ylli (siç është Dielli) dhe të satelitëve të tij ose njërit nga satelitët e tij (siç është Toka). A nuk paraqitet ky gërshetim edhe në tekstin kur'anor, siç e thamë më sipër ?

3. Pajtueshmëria ndërmjet pohimit mbi egzistimin e këtij "avulli" në fazën fillestare të Gjithësisë, për të cilën flet Kur'ani, për të treguar gjendjen paradominuese të materies së gaztë, e cila atëherë e kishte formuar, dhe konceptonit mbi mjergullnajën e Gjithësisë të fazës fillestare, sipas shkencës bashkëkohore, është e qartë.

4. Shumësia e qiejve që në Kur'an është shprehur me simbolin e numrit 7, rëndësinë e të cilit e pamë më sipër, e konfirmon vërtetësinë e saj në shkencën bashkëkohore përmes konstatimeve të astrofizikantëve mbi sistemet e galaktikave dhe numrit të shumtë të tyre. Përkundrazi shumësia e tokëve analogjike me Tokën tonë, së paku sipas disa pikëpamjeve të saja është kuptim që buron nga teksti Kur'anor, realitetin e të cilit shkenca akoma nuk e ka demonstruar: megjithëse shkencëtarët e konsiderojnë krejtësisht të besueshme.

5. Ekzistimi i një ndërkrijimi, midis qiejve dhe Tokës, që është shprehur në Kur'an, mund të krahasohet me urat e materieve të cilat janë të pranishme jashtë sistemeve astronomike të organizuara.

Nëse, ndërkaq, të gjitha pyetjet të cilat i parashtron tregimi kur'anor nuk janë të vërtetuara shkencërisht deri më sot, përsëri nuk ekziston as më i vogli kundërshtim ndërmjet teksteve kur'anore që kanë të bëjnë me krijimin, dhe njohurive bashkëkohore mbi formimin e Gjithësisë. Në fakt, kjo meriton të thuhet për Shpalljen kur'anore, sepse u pa qartë se teksti i Besëlidhjes së Vjetër, të cilën e kemi sot në dispozicion, ka dhënë hollësi që nuk janë të pranueshme nga këndvështrimi shkencor. Megjithatë, nuk kemi pse të çuditemi për këtë kur e dimë që teksti priftëror, përkatësisht teksti që e shkruajtën priftërinjtë lidhur me tregimin mbi krijimin në Bibël, e kanë shkruar priftërinjtë e kohës së persekutimit babilonik, të cilët kishin qëllime legaliste, që i kemi saktësuar dhe të cilat në atë frymë bashkuan tregime të ndryshme në përshtatje me pikëpamjet e tyre teologjike. Egzistimin e një dallimi të këtyllë në mes tregimit biblik dhe të dhënave kur'anore mbi krijimin është edhe më interesant ta theksojmë për shkak të akuzave krejtësisht arbitrare që nuk e kishin kursyer Muhammedin a.s. prej fillimit të Islamit: se gjoja e kishte kopjuar tregimin biblik. Akuza për temën e krijimit nuk ka aspak bazë. Si ka mundur një njeri para më shumë se 14 shekujsh ta korrigjojë tregimin, i cili ishte në qarkullim, duke i eliminuar trillimet nga pikëpamja shkencore dhe t'i

shpallë nga vetvetja të dhënat, saktësinë e të cilave shkenca përfundimisht do ta vërtetojë në kohën tonë. Një supozim i tillë është i paqëndrueshëm. Kur'ani mbi krijimin jep përshkrim krejtësisht të ndryshëm prej atij në Bibël.

## PËRGJIGJET NË VËREJTJE

Egzistimi i ngjashmërisë ndërmjet tregimit biblik e kur'anor sa i përket temave të tjera, posaçërisht të atyre që kanë të bëjnë me historinë e fesë, është i pakontestueshëm. Megjithatë, është mjaft interesant të theksojmë nga pikëvështrim se gjersa Jezusit (Isai a.s.) nuk i shihet për të madhe që e ka huazuar evokimin e ngjarjes së njëjtë dhe të këshillave biblike, në vendet tona perendimore nuk ngurrohet aspak të qortohet Muhammedi. që i ka huazuar në predikimin e tij, duke thënë se ai është mashtrues pasi ato i paraqet si Shpallje. Por, ku është ajo dëshmi se Muhammedi a.s. në Kur'an ka reproduktuar atë që rabinët (priftërinjtë hebraik) kanë mundur t'ia mësojnë ose t'ia diktojnë? S'ka më bazë thënia të cilës një murg i krishterë i ka dhënë arsim solid teologjik. Le të lexohet prapë ajo çfarë thotë R. Blochere për këtë "trillim" në librin e tij Le Probleme de Muhammed( Çështja e Muhammedit)<sup>54</sup>.

Theksohet, gjithashtu njëfarë njëjtësie mes disa dëshmive kur'anore dhe besimeve të cilat shkojnë në kohë shumë të lashta, pa dyshim shumë më herët se Bibla.

Në një formë të përgjithshme është dëshiruar të shihet fryma e disa miteve në Librat e Shenjtë, p.sh. : besimi polinezian në ekzistimin e ujrave fillestar të zhytur në errësirë, të cilat ndahen me të paraqiturit e dritës. Atëherë formohen qielli dhe Toka. Le të krahasohet ky mit me tregimin mbi krijimin sipas Biblës dhe padyshim do të gjejmë gjëra të njëjta, por do t'ishite krejtësisht e pavend të akuzohet Bibla se e ka huazuar këtë mit kozmologjik.

Ky tregim është i njëjtë edhe me pikëpamjen kur'anore mbi copëtimin e materies fillestare, e cila e ka formuar Gjithësinë në fazën fillestare - pikëpamje të cilën e mbron dhe shkenca bashkëkohore - si të dalë prej miteve të ndryshme kozmologjike, të cilat në këtë ose në atë mënyrë tregojnë diçka të përafërt.

Është interesant t'i analizojmë për së afërmi këto besime dhe tregime mitike sepse shpesh paraqitet idea fillestare, vetvetiu e besueshme dhe, në raste të konsiderueshme, e ngjashme me atë që ne sot dimë ose që supozojmë se dimë, por që, në mit, shartohen përshkrime fantazmagorike. I tillë është koncepti mjaft i përhapur mbi qiellin dhe Tokën, që në fazën fillestare ishin ngjitur dhe më vonë u ndanë. Kur, si në Japoni, krahas kësaj lidhet figura e vezës dhe shprehja kaotike, natyrisht, si në çdo vezë, me një embrion në brendësi, shtesa imagjinare ia merr tërë seriozitetin kësaj pikëpamjeje. Në vendet e tjera, me të do të lidhet bima e cila rritet për ta ngritur qiellin dhe për ta ndarë Tokën dhe qiellin; edhe këtu fantazia e

shtojcës së hollësishme i jep mitit një vulë të veçantë. Po, përsëri me këtë nuk është zvogëluar karakteristika e përbashkët, me pikëpamjen mbi një masë të vetme në fillim të procesit evolutiv të Gjithësisë, e cila, duke u copëtuar, solli deri te "botët" e ndryshme që ne i njohim. Nëse këtu i kemi përmendur këto mite kozmogonike, të zhveshura nga të gjithë hollësitë fantazioze që i përcjellin këto besime dhe, të shënuara, përkundrazi, me shprehje dhe fjalë të përmbajtura dhe në konformitet me të arriturat bashkëkohore të shkencës, këtë e kemi bërë për ta vënë në dukje petkun me të cilën i kishte veshur fantazia imagjinuese e njeriut dhe për ta theksuar ndryshimin e thellë që ekziston ndërmjet dëshmimeve kur'anore mbi temën.

Me karakteristika të tilla, tekstet kur'anore mbi krijimin duke marrë parasysh se janë thënë para 14 shekujsh, nuk duket se mund të kenë shpjegim njerëzor.

IV.

#### ASTRONOMIA NË KUR'AN

Kur'ani përmban shumë meditime mbi qiejtë. Në kapitullin e sipërm kushtuar krijimit, kemi vërejtur se janë përmendur shumë qiejtë dhe Toka, si dhe ekzistimi i asaj që Kur'ani e përkufizon si ndërkrijim, përkatësisht meskrijim "në mes qiejve dhe Tokës", si realitet të cilën shkencë bashkëkohore e ka dëshmuar. Ajetet që kanë të bëjnë me krijimin në një farë mënyre e kanë dhënë kuptimin e përgjithshëm mbi përmbajtjen e qiejve, dmth për tërë atë që është jashtë Tokës sonë.

Pëveç ajeteve të cilat në mënyrë të veçantë e përshkruajnë krijimin, 40 ajete të tjera ofrojnë të dhëna të sakta astronomike të cilat janë plotësuese të këtyre të dhënave. Disa janë jo vetëm mbi formën e Gjithëkrijuesit dhe Organizatorit të të gjitha sistemeve të yjeve dhe të planeteve, për të cilët dimë se janë të rradhitur në baraspeshë, mbajtjen e të cilës Njutoni e ka shpjeguar me anë të Ligjit të tërheqjes reciproke të trupave.

Ajetet e para të cilat i kemi cituar këtu nuk motivojnë aspak për meditim shkencor: qëllimi i tyre është thjesht të tërheqë vëmendjen në gjithëfuqinë e Zotit. Megjithatë, duhet t'i përmendim që të krijohet përfytyrimi real mbi mënyrën në të cilën teksti kur'anor, para gati 14 shekujsh e ka paraqitur organizimin e Gjithësisë.



Këto aluzione paraqesin fakte të reja të Shpalljes Hyjnore. As Ungjijtë, as Besëlidhja e Vjetër (nëse lihen anash botëkuptimet mbi krijimin në tregimin biblik, pasaktësinë e së cilës e pamë së bashku) nuk merret me organizimin e botës. Kur'ani hollësisht e shqyrton këtë temë. Me rëndësi është ajo që përmban ai, por edhe atë që ai nuk e përmban. Ai, me fjalë të tjera, nuk përmban teori mbi organizimin e botës qiellore të cilat në atë kohë ishin të respektuara dhe pasaktësinë e të cilës shkenca e vërteton më vonë. Më tutje do të ofrojmë shembuj për këtë. Ky aspekt i llojit negativ duhet të theksohet<sup>55</sup>.

#### A. MEDITIME TË PËRGJITHSHME MBI QIELLIN.

Surja 50, ajeti 6 ka të bëjë me njerëzimin përgjithësisht:

"A nuk ata me vëmendje kah qielli se si mbi ta kemi ndërtuar atë, e kemi zbukuruar atë duke mos pasur në të ndonjë zbrazëti?"

" Ai krijoi qiejt pa shtylla, sikurse po i shihni ..." 31 - A 10).

"All-llahu është Ai që ngriti qiejt pa ndonjë shtyllë. Ju i shihni ato. Ai mbizotroi Arshin dhe nënshtroi Diellin dhe hënën ..." (S13 – A2).

Këto dy ajetet e fundit nuk e pranojnë besimin mbi bazë të të cilit Kupa qiellore në sajë të shtyllave mbajtëse nuk përplasat përtokë.

"Ai e ngriti qiellin dhe Ai vuri drejtësinë." (S55 - A7).

"Ai mban qiellin të mos bjerë në tokë pos nëse dëshiron Ai" (S22 - A65).

Dihet se largësia e masave qiellore në distanca të mëdha, propocionale me madhësitë e vetë masave paraqet bazën e ekuilibrit të tyre. Sa më të largëta të jenë masat, aq më të dobta do të jenë forcat tërheqëse midis tyre. Sa më të afërta të jenë ato, aq më shumë ndikojnë njëra mbi tjetrën: p.sh rasti i Hënës, e afërt me Tokën (mendohet në kontekstin astronomik), e cila sipas Ligjit të tërheqjes ndikon në ujin e detit, nga ky ndikim lind fenomeni i baticës. Nëse dy trupa qiellor do të afroreshin jashtë mase, atëherë përplasja e tyre do të ishte e pashmangshme. Nënshtrimi ndaj një rendi është *conditio sine qua non* i mungesës së çrregullimit (pertubacionit).

Aq shpesh përkujtohet nënshtrimi i qiejve ndaj rendit hyjnor. Zoti i thotë të Dërguarit: "Thuaj: kush është Zoti i shtatë qiejve dhe Zoti i Arshit të madh?" (S23

- A86).

E pamë se me shtatë qiej duhet kuptuar shumësi e jo numër i caktuar.

"Dhe për ju nënshtroigjithë ç'ka në qiell dhe ç'ka në tokë, njëmend për njerëzit më thellë, në këto ekzistojnë argumente." (S45 - A13).

"Dielli dhe Hëna udhëtojnë sipas një përcaktimi të saktë"56. (S55 - A5).

"Ai është krijuesi i dritës së mëngjesit. Natën e bëri kohë pushimi, e Diellin dhe hënën për përlllogaritjen e kohës ..."57 (S55 – A97)

"Për ju nënshtroi Diellin dhe hënën që në mënyrë të zakonshme udhëtojnë vazhdimisht. Për ju përshtati edhe natën dhe ditën." 58. (S14 - A33).

Këtu një ajet e plotëson tjetrin: parallogaritja për njësimin e kohës për të cilat është fjala kanë për pasojë rregullsinë e lëvizjes së trupave qiellorë të shqyrtuara, që është shprehur me fjalën da'ib, pjesoren e kohës së tashme të foljes domethënia fillestare e së cilës ishte të punojmë me kujdes dhe me ngulm në diçka. Këtu i jepet kuptimi "përpjekje për të punuar diçka me kujdes dhe në vazhdimësi, pa ndryshime, sipas një shprehje të caktuar".

"Edhe Hënës i kemi caktuar fazat (pozicionet) derisa të kthehet në trajtën e harkut (rrem i hurmës së tharë). (S36 – A39)".

Këtu aludohet me degën e lakuar të palmës, e cila, duke u tharë, merr formën e draprit të Hënës. Më vonë do të plotësojmë komentimin.

"Dhe për ju nënshtroi natën dhe ditën dhe Diellin e hënën. Edhe yjet janë të nënshtroar me urdhrin e Tij. Vërtet, në këto ka argumente për një popull që mendon". (S16 - A12).

Përmendet ndikimi praktik i këtij organizimi të përkryer qiellor duke insistuar në interesin e tij për lëvizjen e njeriut në Tokë dhe det, si dhe për llogaritjen e kohës. Kjo vërejtje është e kuptueshme kur ta kujtojmë se Kur'ani në fillim ka qenë predikim që i drejtohej njerëzve që ishin të aftë ta kuptojnë vetëm gjuhën e thjeshtë me të cilin shërbeheshin në jetën e përditshme.

"Ai është, që krijoi yjet për ju që me ta të orientoheni në errësira kur jeni në tokë ose në det. Vërtetë Ne i shpjeguam argumentet tona për një popull që di të mendojë."(S6–A97)

"Vuri dhe shenja të tjera ( për orientim ditën), ndërsa (natën) ata orientohen me anëne yjeve." (S16 - A16).

"Ai e bëri Diellin shndritës, e hënën dritë dhe asaj (hënës) ia caktoi fazat, që ta dini numrin e viteve dhe llogarinë. Allahu nuk krijoi këtë për tjetër, pos me qëllim të caktuar. Ai ia sqaron argumentet një populli që kupton". (S10 - A5).

Këtu imponohet një vërejtje. Gjersa Bibla i cilësoi si "ndriçues", Diellin dhe Hënën duke shtuar vetëm një herë mbiemrin i madh kurse për tjetrin e vogël, Kur'ani si njërit, është dhe tjetrit, ja përshkruan edhe ndryshimet e tjera e jo vetëm ato të dimensioneve. Vërtet, ndryshimi është vetëm verbal, por si t'ju shpjegojë njerëzve të asaj epoke e të mos habiteshin duke shprehur idenë se Dielli dhe Hëna nuk janë ndiçues me natyrë identike.

## B. NATYRA E TRUPAVE QIELLORË

### DIELLI DHE HËNA

Dielli është dritë (diyâ'), kurse Hëna kthjelltësi (nûr). Ky përkthim duket se është më i saktë nga ai që i zëvendëson dy shprehje. Thënë shkurt, ndryshimi në kuptim është i dobët, ndonëse diyâ' i takon rrënjës (daw') e cila në fjalorin klasik të Kazimirskit përkthehet si shkëlqim, shndrit (thuhet për flakën etj.), megjithëse ky autor emrin për të cilin është fjala i jep kuptim të njëjtë thellësisë, krahas kuptimit të dritës.

Por ndryshimi ndërmjet Diellit dhe Hënës në Kur'an do të saktësohet me anë të krahasimeve të tjera.

"I madhërishtëm është Ai që krijoi yjet në qiell dhe vendosi në të dritë (diell) e hënë që ndriçon." (S25 - A61).

"A nuk ekeni parë se si Allahu krijoi shtatë palë qiej (me kate). Dhe në ta hënën e bëri dritë, Diellin e bëri ndriçues". (S 71 - A15,16).

"Dhe Ne kemi ndërtuar mbi ju një shtatëshe të fortë. Dhe kemi vënë ndriçuesin që flakëron". (S 78 - A12-13)

Ndriçuesi flakëruet është në mënyrë të qartë Dielli.

Këtu Hëna është përkufizuar si trup i cili ndriçon (munir) nga rrënja e njëjtë sikurse nûr (kthjelltësia e cila përdoret për Hënë). Dielli krahasohet me kandilin (Sirag) dhe me kandilin që flakëron (uahhag).

Një njeri nga epoka e Muhammedit a.s. ka mundur pa dyshim të dallojë Diellin, yllin përvëlues, të njohur mirë nga njerëzit e shkretëtirës dhe Hënë, yllin e freskisë së natës. Pra krahasimet lidhur me ta, të cilat gjenden në Kur'an janë krejtësisht të natyrshme. Ajo që është interesante në këtë është të përmbajturit në krahasime dhe mungesa e çdo elementi krahasues në tekstin kur'anor, i cili përdoret në atë kohë, kurse në ditët tonë do të dukej fantazmagorik.

Dihet se Dielli është yll i cili nga djegia e tij e brendëshme prodhon nxehtësi dhe dritë intesive, ndërsa Hëna nuk është e ndritshme vetvetiu por vetëm reflekton dritën që merr nga Dielli dhe paraqet yllin inert së paku në (shtresat e saj të jashtme). Asgjë në tekstin kur'anor nuk është kundër njohurisë që kemi sot për këta dy trupa.

## YJET

Dihet se yjet si dhe Dielli, janë trupa qiellorë, qendra të fenomeneve të ndryshme nga të cilat fenomeni më i lehtë që shihet është prodhimi i dritës. Këta janë yje që kanë shkëlqimin vetjak.

Trembëdhjet herë e hasim në Kur'an fjalën (nagm, në shumës nugúm); kjo rrjedh nga rrënja që do të thotë të shfaqurit, të shikuarit. Fjala tregon trupin e dukshëm qiellor pa parandjenjë mbi natyrën e tij : a është ky transmetues i dritës ose reflektues i thjeshtë i dritës së marrë. Që të saktësojë se objekti i shënuar është me të vërtetë ai që ne e quajmë yll, i shtohet një cilësor, si në suren 86, ajeti 1 - 3:

"Pasha qiellin dhe yllin ndriçues ( të natës)! E ku di ti se çka është tariku- trokitësi? Ai është ylli që shpon (errësirën me dritë). (S 86, A 1-3)

Ylli i mbrëmjes në Kur'an është cilësuar me fjalën takhib , e cila tregon atë që flakëron, digjen dhe depërton nëpër diçka (këtu nëpër errësirën e natës). Përveç kësaj po kjo fjalë përdoret si shenjë për meteorët (surja 13, ajeti 10); ata janë rezultat i një djegje.

## PLANETËT

Është e vështirë të thuhet nëse vërtet janë përmendur në Kur'an me kuptim të saktë që u jepet këtyre trupave qiellorë.

Planetët nuk janë të ndritshëm vetvetiu. Ata sillen rreth Diellit. Toka jonë u takon atyre. Edhe nëse supozohet se ka edhe diku tjetër dihet vetëm për ata të sistemit diellor.

Pesë planetët jashtë Tokës kanë qenë të njohur që në lashtësi, si: Mërkuri, Venera, Marsi, Jupiteri dhe Saturni kurse tre janë zbuluar në kohën bashkëkohore: Urani, Neptuni dhe Plutoni.

Duket se Kur'ani i quan me emrin kaëkab (shumës kaëâkib) dhe nuk e saktëson numrin e tyre. Ëndrra e Jusufit i përmend 11 në suren 12, por, sipas përkufizimit kemi të bëjmë me një tregim imagjinar siç duket, një përkufizim i mirë i domethënies së kësaj fjale në Kur'an është dhënë në një ajet shumë të njohur, kuptimi i thellë i të cilit është krejtësisht shpirtëror, e për të kanë diskutuar shumë dhe ekzegetët. Ai është gjithsesi tepër interesant për shkak të krahasimit që është bërë lidhur me fjalën e cila, si duket, shënon planetin.

Teksti që na intereson është ky:

"Zoti është dritë e qiejve dhe e Tokës. Drita e tij është e ngjashme me kamaren në të cilin është kandili. Kandili është një qelq kupor, e qelqi është sikurse planeti me shkëlqim margaritar..."60 (S24 - A35).

Këtu vërtet bëhet fjalë mbi projektimin e dritës në një trup të cilin e reflekton (qelqi) duke i dhënë shkëlqimin e margaritarit, sikurse planetit të ndriçuar nga Dielli. Kjo është hollësia e vetme eksplikative e kësaj fjale që mund të gjendet në Kur'an.

Kjo është fjalë e përmendur dhe në ajete të tjera. Në disa prej tyre nuk mund të përcaktohet saktë për cilët trupa qiellorë bëhet fjalë (surja 6, ajeti 76 dhe surja 82, ajeti 1-2).

Por, njimend duket se në një varg mund të bëhet fjalë për trupa qiellorë, të cilët mbi bazë të njohurive të reja shkencore, i njohim si planetë. Në suren 37, ajeti 6 lexojmë këtë:

"Ne e kemi stolitur qiellin tuaj më të afërt me planetë".

A thua shprehja kur'anore "qielli më i afërt" mund ta tregojë sistemin diellor? Dihet se mes elementeve qiellorë më afër nesh nuk ekzistojnë elemente të tjera të përhershme përveç planetëve: Dielli është ylli i vetëm në sistemin që mban emrin e tij. Nuk dimë se për çfarë trupa të tjerë qiellorë mund të bëhet fjalë këtu, përveç për planetët. Domethënë, duket se përkthimi i bërë është i drejtë dhe Kur'ani përmend ekzistimin e planetëve sipas përkufizimit bashkëkohor.

### QIELLI MË I AFËRT

Disa herë Kur'an përmend qiellin më të afërt dhe trupat qiellorë që e përbëjnë atë, ndër të cilët janë, siç duket nga ajo që pamë më sipër, në rend të parë, planetët. Por, kur ai i lidh shqyrtimet e pastërta shpirtërore me njohuritë materiale, që janë të kuptueshme për ne sot, meqë sot jemi të arsimuar me shkencën bashkëkohore, kuptimi bëhet shumë i paqartë.

Kështu ajeti i fundit i cituar do të mund të kuptohej lehtë, por kur ajeti i ardhshëm (7) i të njëjtës sure (37) flet për "ruajtjen nga çdo shejtan inatçi", "ruajtjen" e cila është përmendur edhe në suren 21, ajeti 32 dhe në suren 41, ajeti 12, hasim në shqyrtime që ndryshojnë nga të parat.

Gjithashtu, ç'kuptim t'i japim shprehjes "goditjes së shejtanit" të cilën ajeti 5 i sures 67 e vendos në qiellin më të afërt? A mos ndoshta "kandilat" që janë përmendur në po këtë ajet kanë të bëjnë me meteorët<sup>61</sup>, të cilët i kemi përmendur më sipër?

Si duket të gjitha këto ndryshime e kanë vendin jashtë këtij studimi. Këtu i kemi përmendur për shkak të tërësisë, por nuk duket se të dhënat shkencore, në gjëndjen ekzistuese, do të mund të ndriçonin më mirë një objekt që tejkalon gjykimin njerëzor.

### C. STRUKTURA QIELLORE

Ajo që është në Kur'an lidhur me këtë çështje i takon para së gjithash sistemit diellor, por gjithashtu aludon në fenomene që e kalojnë vetë sistemin diellor dhe të cilat janë zbuluar në kohën bashkëkohore.

Dy ajete shumë të rëndësishëm bëjnë fjalë për orbitat e Dielli dhe të Hënës:

"Ai është që krijoi natën dhe ditën, Diellin dhe hënën dhe secili noton n1 orbitë". (S21-A33)

"As Dielli nuk mund ta arrijë hënën, e as nata para ditës, po secili noton në një galaksion". (S36-A40)

Kështu në mënyrë të qartë është përmendur fakti i rëndësishëm: ekzistimi i orbitave për Hënën dhe Diellin dhe është aluduar në lëvizjen e këtyre trupave në hapësira me anë të lëvizjes vetjake.

Për më tepër, me rastin e leximit të këtyre ajeteve paraqitet një fakt i llojit negativ: është theksuar se Dielli lëviz nëpër një orbitë pa e saktësuar se çfarë është ajo orbitë në raport me Tokën. Në kohën e Shpalljes së Kur'anit është besuar se Dielli sillet, kurse Toka është pikë e palëvizshme. Ky ishte sistemi geocentrik i cili ka qenë i njohur nga Ptolemeu, në shekullin II p.e.s., dhe i cili do të qëndrojë si teori deri në shekullin XVI, në kohën e Kopernikut. Kjo pikëpamje që ka qenë e pranuar në kohën e Muhammedit a.s. nuk del askund në Kur'an, as këtu, as në ndonjë vend tjetër.

## EKZISTIMI I ORBITËS PËR HËNËN DHE DIELLIN

Atë që këtu e përkthejmë si orbitë është fjala arabe falak të cilës shumë përkthyes të Kur'anit në frengjisht i japin kuptimin e sferës. Ky është me të vërtetë kuptimi fillestar i fjalës. Hamidullahu e ka përkthyer si orbitë.

Fjala (falak) i kishte hutuar komentuesit e Kur'anit, të cilët nuk kanë mundur ta paramendojnë rrugën rrethore të Hënës dhe të Diellit, dhe për këtë arsye në vetvete krijuan pak a shumë përfytyrime të sakta ose krejtësisht të gabuara mbi lëvizjen në hapësirë të këtyre dy trupave qiellor. Në përkthimin e tij të Kur'anit, si Hamza Bubeker përmend interpretime të ndryshme: "Një lloj boshti si shufra e hekurt rreth së cilës sillet mulliri; kupa e qiellit, orbitë, shenja e Zodiakut, shpejtësia, vala...". Ai shton këtë mendim të komentuesit të njohur të shek. X, Tabarisë: "E kemi për detyrë të heshtim kur nuk dimë". Kjo tregon sa të paaftë kanë qenë njerëzit atëherë që ta kuptojnë këtë nocion të orbitës për Diellin dhe Hënën. Është e qartë se interpretimi i këtyre ajeteve nuk do të shpiente në vështirësi të tilla, sikur fjala të shprehte ndonjë nocion nga astronomia e kohës së Muhammedit a.s. Domethënë, në Kur'an ka ekzistuar një nocion i ri i cili do të kuptohej shekuj më vonë.

## 1. PËR HËNËN

Në kohën tonë është shumë i përhapur mendimi se ky satelit i Tokës sillet rreth saj me përsëritje periodike prej 29 ditësh<sup>63</sup>. Por duhet korrigjuar vija rrethore absolute e orbitë, sepse astronomia bashkëkohore ia lejon një lëvizje të konsiderueshme boshtit, kështu që largësia Tokë - Hënë, e vlerësuar në largësinë 384.000 km, është largësi mesatare.

Më sipër pamë si e ka theksuar Kur'ani dobinë e vëzhgimit të lëvizjeve të Hënës për matjen e kohës.

"Ai e bëri Diellin shndritës, e hënë dritë dhe asaj (hënës) ia caktoi fazat, që ta dini numrin e viteve dhe llogarinë. Allahu nuk krijoi këtë për tjetër, pos me qëllim të caktuar. Ai ia sqaron argumentet një populli që kupton". (S10-A5, e citur në fillim të këtij kapitulli).

Kjo llogaritje është kritikuar shpesh si arkaike, jopraktike dhe joshkencore në krahasim me sistemin tonë të mbështetur në rrotullimin e Tokës rreth Diellit, i cili në kohën tonë shprehet në kalendarin julian.

Kjo kritikë çon në dy vërejtje:

a) Kur'ani para 14 shekujsh i është drejtuar banorëve të Gadishullit arabik, të cilët e kanë aplikuar njësimin hënor të kohës. Ka qenë e udhës që t'u flitet në vetmen gjuhë të cilën kanë mundur ta kuptojnë dhe të mos u shkaktohet pështjellim në zakonet e tyre, të marrjes së shenjave hapsinore dhe kohore për orientim, të cilët edhe ishin mjaft efikas. Dihet se banorët e shkretëtirës kanë qenë të mësuar me vëzhgimin e qiellit, me orientimin me anë të yjeve dhe me llogaritjen e kohës sipas fazave të Hënës, të cilat kanë qenë mjetet më të thjeshta dhe më të sigurta.

b) Nëse lihen anash specialistët për këto çështje, në përgjithësi injorohet përputhja e shkëlqyeshme ndërmjet kalendarit julian dhe atij hënor: 235 muaj hënor përputhen saktësisht me 19 vjet julian prej 365 ditësh e një çerek; gjatësia e viteve tona prej 365 ditë nuk është e përkryer, pasi kjo kërkon korrigjim në çdo katër vjet (vitet e brishta). Me kalendarin hënor, fenomene të njëjta përsëriten në çdo të nëntëmbëdhjetin vit të vitit julian: ky është cikli i Metonit, astronomit grek, i cili në shek. V p.e.s. zbuloi përputhshmërinë e saktë të kohës diellore dhe hënore.

## 2. SA I PËRKET DIELLIT

Ekzistimi i orbitës kuptohet vështirë për arsye se jemi mësuar të konsiderojmë se sistemi ynë diellor është i organizuar rreth tij. Që të kuptohet ajeti Kur'anor duhet të vëzhgohet pozita e Diellit në Galaktikën tonë dhe, mbi bazë të kësaj, t'i referohemi pikëpamjeve të shkencës bashkëkohore.



Galaktika jonë përmban një numër të madh yjesh të shpërndarë nëpër një disk, i cili është më i dendur në qendër sesa në periferi. Aty Dielli është në një pozitë të larguar nga qendra e diskut. Meqë Galaktika rrotullohet rreth vetes me qendrën e vet si bosht, del se Dielli rrotullohet rreth të njëjtës qendër në orbitë rrethore. Astronomia bashkëkohore i ka përlllogaritur elementet e saj. Shaplei në vitin 1917 e ka përlllogaritur se Dielli është larg qendrës së Galaktikës 10 kiloparsek<sup>64</sup> që i përgjigjet përafërsisht largësisë prej 300.000.000.000.000.000 km. Që të bëjnë një rrotullim rreth vetes Galaktika dhe Dielli duhet të kalojnë një periudhë përafërsisht prej 250 milion vjetësh në këtë rrotullim Dielli lëviz me një shpejtësi prej afër 250 km/sek.

I tillë është rrotullimi orbital i Diellit të cilin e shpalli Kur'ani para 14 shekujsh, ekzistimin dhe koordinatat e të cilit i ka vërtetuar astronomia bashkëkohore.

#### ALUZIONI NË LËVIZJEN E HËNËS DHE TË DIELLIT NË GJITHËSI ME LËVIZJE VETJAKE

Ky nocion nuk paraqitet në përkthimet e Kur'anit nga njerëzit e shkolluar të letërsisë, të cilët, duke mos e njohur astronominë, fjalën arabe e cila shpreh këtë lëvizje e kanë përkthyer me një nga kuptimet e fjalës "notoj", e kështu është rasti edhe me përkthimet në frëngjisht, në anglisht, në përkthimet e njohura të Jusuf Aliut<sup>65</sup>.

Fjala arabe e cila bën aluzion në transferimin me lëvizje vetjake është fjala sahaba (jasbahuna në tekstin e dy ajeteve). Të gjitha kuptimet e foljes implikojnë lëvizjen e ndërlidhur me lëvizjen vetjake të trupit i cili lëviz. Kjo është "notoj" nëse lëvizja bëhet në ujë, kurse lëvizja me anë të këmbëve të veta është tokësore. Mezi mund të jepet ideja mbi lëvizjen në Gjithësi që e implikon kjo fjalë, përveç duke përdorur kuptimin fillestar.

- Hëna ë bën rrotullimin e vet rreth vetes për aq kohë sa e kryen lëvizjen rreth Tokës ose përafërsisht për 29,5 ditë, prandaj gjithnjë ka të njëjtën pamje.

- Dielli rrotullohet rreth vetes për afër 25 ditë. Ekzistojnë disa karakteristika të rrotullimit për ekuatorin dhe për polet, për të cilat nuk do të bënim fjalë këtu, por në tërësinë e tij ylli është nxitur nga një lëvizje rrotulluese.

Domethënë, duket se në Kur'an një nuancë e foljes aludon në lëvizjet karakteristike të Diellit dhe të Hënës. Këto lëvizje të dy trupave qiellorë i kanë vërtetuar të dhënat e shkencës bashkëkohore, por nuk mund ta kuptojmë se si një njeri i shekullit VII të epokës sonë, sado i ditur të ketë qenë për kohën e tij, gjë që nuk

është rasti me Muhammedin a.s. - ka mundur ta mendojë.

Ndonjëherë këtë pikëpamje e kundërshtojnë disa shembuj të mendimtarëve të mëdhenj të lashtësisë të cilët në mënyrë të pakontestueshme i kanë shpallur disa fakte, që shkencë bashkëkohore i ka vërtetuar si të sakta. Ata në njëfarë mënyre mezi kanë mundur të mbështeten në deduksionin shkencor dhe më shumë kanë ndjekur rrugën e arsytimit filozofik. Shpesh përmendet rasti i pitagoristëve, të cilët, në shek. IV para erës sonë, e kanë mbrojtur teorinë e rrotullimit të Tokës rreth vetvetes dhe rrotullimin e planetëve rreth Diellit, teori të cilën do ta vërtetojë shkencë bashkëkohore. Kur të bëhet krahasimi me rastin e pitagoristëve, është e lehtë të hidhet hipoteza mbi Muhammedin a.s., mendimtarin gjenial, i cili vetvetiu e ka menduar atë që shkencë bashkëkohore do ta zbulonte shumë shekuj pas tij. Duke bërë këtë, harrohet thjesht të përmendet forma të tjera të kontributit intelektual të këtyre gjenive të mendimit filozofik dhe të gabimeve ( mashtrimeve ) të mëdha me të cilat janë ngjyrosur veprat e tyre. Kështu nuk duhet harruar se pitagoristët gjithashtu kanë mbrojtur teorinë e mos lëvizjes së Diellit në Gjithësi, që e kanë bërë qëndër të Botës, duke e menduar përqëndrimin e Gjithësisë vetëm rreth tij. Zakonisht te këta filozofë të mëdhenj të lashtësisë hasim në përzjerje të ideve të sakta dhe të gabuara mbi Gjithësinë. Shkëlijimin që u japin veprave të njeriut për pikëpamjet përparimtare që i përmbajnë ato, nuk duhet të na bëjnë të harrojmë pikëpamjet e gabuara që na kanë mbetur trashëgim nga po këto vepra. Kjo është ajo që vetëm në pikëpamje shkencore ndahet nga Kur'ani, sepse shumë tema që përmenden në Kur'an janë të lidhura me njohuritë bashkëkohore, e në të nuk mund të hasim në asnjë pohim i cili do të ishte në kundërshtim me atë që e ka vërtetuar shkencë e kohës sonë.

#### NDËRRIMI I DITËS DHE I NATËS

Në epokën në të cilën është konsideruar se Toka është qëndër e Botës dhe Dielli është në lëvizje në krahasim me të, cilës krijesë njerëzore nuk do ta përmendte lëvizjen e Diellit me rastin e ndërrimit të ditës dhe të natës? Por diçka të tillë nuk shkruan në Kur'an, i cili këtë temë e trajton si më poshtë:

" ..., Ai e mbulon ditën me natën, që me të shpejtë e kërkon atë (mbulimin e dritës së ditës)..."(S7- A54)

"Për ata është argument edhe nata, prej së cilës largojmë ditën, kurse ata mbesin në terr(S36-A37)

"A nuk e di se Allahu e fut (errësirën) natën në ditë dhe e fut (dritën) në natë,..."

(S31- A29)

" Ai natën ia mbështjell (vendit të) ditës dhe ditën ia mbështjell natës;..." (S39-A5)

Ajeti i parë (S7-A54) nuk ka nevojë për komentim. I dyti ( S36-A37 ) thjesht dëshiron të na ofrojë pamjen.

Para së gjithash, ajeti i tretë (S31-A29) dhe i katërt (S39-A5).

Si duket fjala "mbështjell" është mënyra më e mirë, si në përkthimin e R. Blacher, për të përkthyer fjalën arabe kawwara. Kuptimi i hershëm i kësaj foljeje është mbështjellja spirale e turbanit rreth kokës; në të gjitha kuptimet e tjera është ruajtur kuptimi i mbështjelljes.

Por, çfarë ndodh në të vërtetë në Gjithësi? Si e kanë parë mirë astronautët amerikanë dhe që kanë fotografuar nga anijet e tyre kozmike, sidomos nga distanca shumë të largëta nga Toka, p.sh nga Hëna , Dielli pandërprerë (përveç gjatë zënies -eklipsit) e ndriçon gjysëmsferën tokësore të vendosur kundrejt tij, kurse gjysëmsfera tjetër ndodhet në errësirë. Pasi Toka rrotullohet rreth vetes, kurse ndriçimi ngel po ai, i palëvizshëm, një zonë e ndriçuar në formë gjysëmsfere rrotullohet për 24 orë rreth Tokës, kurse gjysëmsfera që ka mbetur në errësirë për të njëjtën kohë bën rrotullim të njëjtë. Ky ndërrim i pandërprerë i ditës dhe i natës është përshkruar në mënyrë të përsosur në Kur'an. Kjo në kohën tonë është e lehtë për t'u kuptuar nga njerëzit, meqë kemi njohuri mbi palëvizshmërinë (relative) të Diellit dhe mbi rrotullimin e Tokës. Ky proces i mbështjelljes së pandërprerë, me depërtim të vazhduar të një sektori në një sektor tjetër, është shprehur në Kur'an sikur të jetë menduar në epokën e Tokës së rrumbullakët, gjë që pa dyshim nuk është rastësi.

Krahas këtyre shqyrtimeve mbi ndërrimin e ditës dhe të natës, duhet t'i lidhim evokimet e shumësisë të lindjes dhe të perëndimit në disa nga ajetet e Kur'anit, interesi i të cilit është vetëm përshkruar, pasi këto fenomene mund të zbulohen me vëzhgimin më banal. Ato janë përmendur këtu me qëllim, në mënyrë që sa të jetë e mundur të riprodhohet në tërësi ajo që Kur'ani e përmban lidhur me atë temë.

Këto janë, p.sh:

- në suren 70, ajeti 40, shprehja: "Pra betohem në Zotin e lindjeve dhe e të perëndimeve, se Ne kemi fuqi" ;

- në suren 55, ajeti 17, jo: "Zotit i dy lindjeve dhe Zot i dy perëndimeve";

- në suren 43, ajeti 38, evokimi: "...Ah, të kishim qenë larg mes vete sa lindja me perëndimin;..." " është pasqyrë që shpreh pafundësinë e largësisë ndërmjet dy

pikave.

Vëzhguesi i lindjes dhe i perëndimit të Diellit e di që Dielli lind në pika të ndryshme të lindjes dhe perëndon në pika të ndryshme të Perëndimit, sipas stinëve të vitit. Shenjat e shënuara në çdo horizont përcaktojnë pikat e fundme që caktojnë dy lindje dhe dy Perëndime, ndërmjet të cilave gjatë vitit vendosen mespikat. Fenomeni që është përmendur këtu mund të thuhet se është banal. Por veçanërisht meriton vëmendje ajo që ka të bëjë me tema të tjera të shqyrtuara në këtë kapitull, në të cilin përshkrimi i fenomeneve astronomike që i evokon Kur'ani është konform me pikëpamjet bashkëkohore.

#### D. EVOLUCIONI I GJITHËSISË

Duke i përkujtuar idetë bashkëkohore mbi formimin e Gjithësisë e kemi treguar evolucionin që ka ndodhur duke filluar nga mjergullnajat fillestare e deri te formimi i galaktikave, i yjeve dhe i sistemit diellor, deri në paraqitjen e planeteve që kanë rrjedhur nga Dielli në një shkallë të evolucionit të tij. Të dhënat bashkëkohore lejojnë mendimin që në sistemin diellor dhe përgjithësisht në Gjithësi evolucionin vazhdon akoma. Kur dihet kjo, atëherë si mos ta krahasojmë me disa pohime që i gjejmë në Kur'an, kur evokohen manifestimet e plotëfuqisë së Zotit?

Në disa raste Kur'ani rikujton se: "... Ai mbizotëroi Arshin dhe nënshtroi Diellin e hënën që çdo njëri udhëton deri në një afat të caktuar;..."

Këtë fjali e gjejmë në suren 13, ajeti 2; në suren 31, ajeti 29; në suren 35, ajeti 13; në suren 39, ajeti 5.

Por, për më tepër, ideja mbi afatin e caktuar është e lidhur me idenë mbi cakun në suren 36, ajeti 38:

" Dhe Dielli udhëton për në kufirin e vet ( në cakun përfundimtar). Ai është (udhëtim) përcaktim i Ngadhënjyesit, të Dijshmit."

Kufiri i caktuar është përkthim i fjalës mustekarr. Nuk ka dyshim se me këtë fjalë është e lidhur ideja mbi vendin e caktuar.

Si duket konfrontimi i këtyre i pohimeve me të dhënat që i ka vërtetuar shkencë bashkëkohore?

Kur'ani ja cakton Diellit afatin evolutiv dhe cakun. Hënës gjithashtu ia cakton

afatin. Që të mund të kuptohet domethënia e mundshme e këtyre pohimeve, duhet t'i sjellim ndër mend njohuritë bashkëkohore mbi evolucionin e yjeve në përgjithësi, e të Diellit në veçanti, dhe, me anë të konkluzionit, mbi formacionet qiellore të cilat detyrimisht e ndjekin lëvizjen e tyre në Gjithësi, e të cilave u përket Hëna.

Dielli është yll, vjetërsinë e të cilit astrofizikanët e vlerësojnë në 4,5 miliard vjet. Si për të gjitha yjet edhe për të mund të caktohet stadi evolutiv. Dielli tani është në stadin e parë, të cilin e karakterizon transformimi i atomeve të hidrogjenit në atome të heliumit: stadi i tanishëm, teorikisht, do të duhej të zgjaste edhe 5,5 miliard vjet, sipas llogaritjeve të bëra tek yjet e tipit të Diellit, stadi të parë të tanishëm, tek yjet e tipit të Diellit, ia caktojnë kohëzgjatjen e përgjithshëm prej gjithsej 10 miliard vjet. Pas këtij stadi, siç është vërejtur tek yjet e tjerë, pason stadi i dytë të cilin e karakterizon përfundimi i transformimit të hidrogjenit në helium, pasojë e të cilit janë zgjerimi i shtresave të jashtme dhe ftohja e Diellit. Në stadin e fundit drita është e zvogëluar shumë dhe densiteti i rritur shumë: kjo shihet në tipin e yjeve të cilëve u është dhënë emri i xhuxhëve të bardhë.

Nga e gjithë kjo nuk duhet mbajtur mend datat, të cilat janë interesante vetëm sa për të dhënë vlerësimin e përafërt të faktorit kohë, por vetëm atë që më së shumti del në pah: kuptimi i evolucionit. Të dhënat bashkëkohore e bëjnë të mundur parashikimin që brenda disa miliardë vitesh kushtet në sistemin diellor nuk do të jenë këto të sotmet. Si edhe për yje të tjerë, transformimet e të cilëve janë regjistruar deri në stadin e fundit, mund të parashikohet fundi edhe për Diellin.

Ajeti i dytë që është dhënë më sipër (S36 - A38) evokon se Dielli shkon drejt cakut të vet.

Astronomia bashkëkohore e ka caktuar në mënyrë të përkryer duke i dhënë edhe emrin e apeksit diellor: sistemi diellor me të vërtetë lëviz në Gjithësi drejt një pike të vendosur në yllësinë e Herkulit, në fqinjësi me yllësinë Vega (yllësia e Lirës), koordinatat e të cilit janë të përcaktuara mirë: lëvizja ka shpejtësi të caktuar prej 19 km/sek.

Të gjitha këto të dhëna nga astronomia meritojnë të paraqiten lidhur me dy ajetet e Kur'anit, të cilët, siç duket përputhen me njohuritë e sotme shkencore në mënyrë të përkryer.

## ZGJERIMI I GJITHËSISË

Zgjerimi i Gjithësisë është fenomeni më madhështor që e ka zbuluar shkencën

bashkëkohore. Ky sot është kuptimi i përcaktuar mirë, kurse diskutimet bëhen vetëm rreth shembullit sipas të cilit zbatohet.

I sugjeruar nga teoria e përgjithshme e relativitetit, zgjerimi i Gjithësisë ka bazë fizike në hulumtimin e spektrit të galaktikave; lëvizja sistematike e spektrit të tyre kah pjesa e kuqe shpjegohet me largimin reciprok të galaktikave. Kështu sipërfaqja e Gjithësisë rritet vazhdimisht e ky zgjerim është më i madh, për aq sa largohet nga ne. Shpejtësitë me të cilat trupat qiellorë lëvizin në këtë zgjerim të pandërprerë mund të shkojnë nga pjesë të shpejtësisë së dritës deri në vlera më të mëdha se ajo.

A mund të krahasohet ajeti vijues nga Kur'ani (surja 51, ajeti 47), në të cilën Zoti flet, me të arriturat shkencore bashkëkohore?

" Ne me forcën tonë e ngritëm qiellin dhe Ne e zgjerojmë atë."66 (S51, A47)

Qielli, përkthim i fjalës sema', a nuk është pikërisht Gjithësia jashtë Tokës, për të cilën këtu bëhet fjalë?

Atë që ne e kemi përkthyer "Ne e zgjerojmë" është pjesorja e kohës së tashme të shumësit muësiu'na të foljes auuasaa' që do të thotë: zgjerim, shtrirje, zgjerim hapsinor, kur është fjala për objektet.

Disa përkthyes, të paaftë për ta kuptuar domethënien e fjalës së fundit, i japin kuptimin që më duket i gabuar si "Ne jemi plotë gjërësi" (R. Blachere). Autorë të tjerë ia qëllojnë domethënies por nuk kanë guximin ta thonë: Hamidullahu, në përkthimin e vet të Kur'anit, flet për zgjerimin e qiellit, të Gjithësisë, por me pikëpyetje. Ka të tillë, të cilët, duke u mbështetur në komentimet e veta të mendimeve të autorizuar shkencore, ia japin kuptimin që e kemi treguar këtu. I tillë është rasti me komentimin e Muntahabit, të cilin e boton Këshillin Suprem i Punëve Islamike në Kajro; ata pa as më të voglin dyshim e përmendin zgjerimin e Gjithësisë.

## E. PUSHTIMI I GJITHËSISË

Nga ky pikëvështrim, tre ajetet kur'anore meritojnë ta tërheqin tërë vëmendjen. Njëri në mënyrë të qartë shpreh atë që u takon njerëzve ta realizojnë dhe çfarë do të realizojnë. Në dy ajetet e tjera, Zoti evokon çudinë që do t'u ndodhte jobesimtarëve nga Meka, sikur të mund të ngjiteshin në qiell, duke aluduar kështu në një supozim i cili nuk do të ketë pasoja për këta të fundit.

1. Ajeti i parë ajeti 33 nga surja 55:

"O turmë e xhinve dhe e njerëzve, nëse keni mundësi të dilni përtej kufijve të qiejve të tokës, depërtoni pra, po nuk mundeni vetëm me ndonjë fuqi të fortë (por ju nuk e keni atë). (A33 nga S55)

Përkthimi të cilin e dhamë këtu kërkon disa shpjegime plotësuese:

a) Fjala frënge "si" shpreh kushtin e cila zbulon në mënyrë të njëjtë mundësinë, si dhe supozimin e realizueshëm dhe të porealizueshëm. Gjuha arabe është në gjendje që ta nuancojë kushtin në mënyrë tejet eksplicite. Ekziston fjala që shpreh mundësinë (ida), një tjetër që të shprehet supozimi i realizueshëm (in), dhe një e tretë që të shprehet supozimi i porealizueshëm (leë). Ajeti të cilin po e shqyrtojmë konsideron se fjala është për supozimin e realizueshëm, të shprehur me anë të in. Kur'ani domethënë evokon mundësinë materiale të realizimit konkret. Ky ndryshim gjuhësor formalisht e eleminon interpretimin e pastër mistik të cilin kanë provuar t'ia japin gabimisht këtij ajeti.

b) Zoti iu drejtohet xhinëve dhe njerëzve e jo në thelb personave alegorik.

c) "Depërtim i kundërt" është përkthimi i fjalës nefedhe pas të cilës vjen parafjala min,e cila, sipas fjalorit të Kazimirit, domethënë depërtim, kalim përtej dhe dalje përtej një trupi (p.sh thuhet për shigjetën e cila del në anën kundërt). Ajo domethënë evokon depërtimin e thellë dhe daljen në anën tjetër të zonave për të cilat bëhet fjalë.

d) Fuqia (sultan) të cilën duhet ta kenë njerëzit për arritjen e këtij qëllimi duket se është fuqi e cila buron nga i Plotëfuqishmi.

Nuk ka dyshim që ky ajet tregon mundësinë që do ta kenë njerëzit dikur për ta kryer atë që ne, në epokën tonë, ndoshta në mënyrë shumë të papërshtatshme, e quajmë pushtim të Gjithësisë. Duhet të theksojmë që teksti kur'anor nuk e vëren vetëm depërtimin nëpër zonën e qiejve, por edhe nëpër zonat e Tokës, ky është hululumtim i thellësive.

2. Dy ajetet e tjera janë nxjerrë nga surja 15, ajeti 14 dhe 15. All-llahu iu flet jobesimtarëve nga Meka, si tregon edhe kjo pjesë e sures:

"Edhe sikur Ne t'u hapnim atyre një derë në qiell dhe të ngjiteshin vazhdimisht lart në të (e të shihnin ëngjëjt e fshehtësitë). Ata gjithqysh do të thonin: " Neve na janë ndalë sytë (të pamët). Jo, ne jemi njerëz të magjepsur." ( S15 - A 14 -15)

Kjo është shprehje e habitë para një pamje të papritur, të ndryshme nga ajo që njeriu mund ta paramendojë.

Fjalja kushtore është futur këtu me anë të fjalës leë e cila shpreh supozimin që nuk do të realizohet kurrë për ata për të cilët bën fjalë kjo pjesë.

Domethënë në pikëpamje të pushtimit të Gjithësisë ndodhemi në mesin e dy pjesëve të tekstit kur'anor, nga të cilat njëra bën aluzion në atë që një ditë do të realizohet në saj të fuqisë që Zoti do t'ia japë intelektit dhe aftësisë zbuluese të njeriut, kurse e dyta evokon ngjarjen të cilën nuk do ta përjetojnë jobesimtarët e Mekës, nga e cila rrjedh karakteri i kushtëzimit, i cili nuk do të realizohet... Por këtë ngjarje do ta përjetojnë të tjerët siç e supozon ajeti i parë i cituar. Ai i përshkruan reaksionet e njerëzve para pamjes së papritur e cila ndodh që t'iu shfaqet udhëtarëve të Gjithësisë: shikime të shqetësuar, përshtypje e magjepsjes...

Mu kështu astronautët e përjetuan këtë aventurë të çuditshme në vitin 1961, me rastin e fluturimit të parë të njeriut rreth Tokës. Dihet, se kur të ndodhemi nga ana tjetër e atmosferës së Tokës, qielli nuk shihet askund me pamjen e tij të kaltër që u tregohet tokësorëve, e i cili është rezultat i fenomenit të absorbimit<sup>67</sup> të dritës së Diellit në shtresat atmosferike. Kur njeriu ndodhet në Gjithësi, në anën tjetër të atmosferës tokësore, ai sheh një qiell të zi, kurse Toka i duket e mbështjellur në një si unazë ngjyrë të kaltër, për shkak të fenomeneve të ngjashme të absorbimit të dritës në atmosferën tokësore, kurse Hëna, e cila nuk ka atmosferë, shihet me ngjyrat e veta në sfondin e errët të qiellit. Domethënë një pamje krejtësisht e re për njeriun paraqitet në Gjithësi, pamje fotografitë e të cilës janë bërë klasike për njerëzit e kohës sonë.

Edhe këtu, kur e ballafaqojmë tekstin e Kur'anit me njohuritë bashkëkohore, si mos të impresionohemi me saktësitë për të cilat nuk mund të supozojmë se rrjedhin nga mendimi i një njeriu, i cili ka jetuar para 14 shekujsh.

V

## TOKA

Sikurse temat e trajtuar më parë, edhe ajetet kur'anore, që bëjnë fjalë për Tokën, janë të shpërndarë në tërë Librin. Libri i klasifikimeve është i rëndë: kjo që po e paraqesim është krejtësisht personale.

Për të qenë shpjegimi i qartë duket se, para së gjithash, mund të veçohet një numër i konsiderueshëm i ajeteve të cilat shpesh, duke trajtuar më shumë tema, kanë një domethënie të përgjithshme, kurse paraqesin po aq thirrje drejtuar njerëzve në mënyrë që me anë të shembujve të paraqitur të mendojnë mbi bamirësinë e Zotit.



Mund të veçojmë grupe të tjera të ajeteve që kanë të bëjnë me tema më të veçanta, siç janë:

- cikli i ujit dhe i deteve
- relievi i Tokës
- atmosfera e Tokës

#### A. AJETET ME RËNDËSI TË PËRGJITHSHME

Duke dhënë argumente me të cilat njerëzit duhet të nxiten për të menduar mbi bamirësinë e Zotit ndaj atyre që i ka krijuar, këto ajete aty-këtu përmbajnë pohime që janë me interes të konfrontohen me të dhënat e shkencës bashkëkohore. Por, nga ky pikëvështrim, ajetet mund të jenë me interes edhe më të madh për shkak se nuk shprehin besime të shumëllojshme për disa fenomene natyrore, në të cilat njerëzit kanë besuar në kohën e Shpalljes së Kur'anit- besime të ndryshme, gabimet e të cilave do t'i vërtetojë më vonë njohuria shkencore.

Këto ajete shprehin të vërteta të thjeshta, të lehta për t'u kuptuar nga ata të cilëve u është drejtuar Kur'ani, për shkaqe gjeografike, banorëve të Mekës dhe Medinës, beduinëve të Gadishullit arabik, në një anë, dhe meditime të përgjithshme, nga të cilat bota e arsimuar, në të gjitha vendet dhe në të gjitha kohët, mund të nxjerri mësim kur përpiqet të meditojë, gjë që është karakteristikë universalitetit të Kur'anit, nga ana tjetër.

Pasi asnjë klasifikim i këtyre ajeteve nuk është i dukshëm në Kur'an, ato këtu janë paraqitur sipas renditjes numerike të sureve.

"Ai (All-llahu), i cili për ju e bëri tokën shtrat (vendbanim) e qiellin kulm, e prej qiellit ju lëshojë shi me të cilin ju siguroi lloje të frutave si ushqim për ju, pra mos i përshkruani All-llahut shokë, duke qenë se ju e dini (që Ai nuk ka shokë). (S2-A22)

" Është fakt se në krijimin e qiejve dhe të tokës, në ndërrimin e natës e të ditë, të anijes që lundron në det që u sjell dobi njerëzve, në atë shi që e lëshon All-llahu prej së larti e me te ngjall tokën pas vdekjes së saj dhe përhapë në te nga çdo lloj

gjallese, në qarkullimin e erërave dhe reve të nënshtuara mes qiellit e tokës, (në të gjitha këto) për një popull që ka mend ka argumente." (S2- A164)

"E tokën e kemi shtruar dhe në të kemi vënë kodra dhe kemi bërë që në të të mbijnë bimë të caktuara të të gjitha llojeve. Dhe Ne ju kemi krijuar juve në të jetesën (mjetet për jetesë) e edhe atyre për të cilët ju nuk jeni furnizues. (S15-A19-20)

"E nuk ka asnjë send që të mos ta ketë burimin te Ne, po Ne, nuk e japim atë ndryshe vetëm sipas një mase të caktuar (të nevojshme). (S15-A21)

këtu duhet parë një sure me kujdes se ka një ngatërrim (S20A62)

" Hani ju dhe kullotni kafshët tuaja(nga ato bimë). Vërtet , për të gjitha këto (që u përmendën) ka argumente për ata që kanë mendje të shëndoshë. (S20 - A54)

" A është Ai që tokën e bëri vendqëndrim e nëpër të bëri të rrjedhin lumenj, dhe asaj (tokës) i bëri (male) përforcues, dhe në mes dy deteve bëri ndarje. A ka përveç All-llahut Zot tjetër? Jo, por ju shumë pak përkujtoni. (S27 - A61)

Këtu bëhet aluzion në stabilitetin e përgjithshëm të kores së Tokës. Dihet se në kohët e mugëta të Tokës, shtresa sipërfaqësore e saj ishte jostabël para ftohjes. Stabiliteti i kores së Tokës përsëri nuk është absolut, meqë eksiztojnë zona në të cilat kohë pas kohe bijnë tërmete. Sa i përket përvijimit mes dy deteve, kjo është figurë përmes të cilës tregohet mungesa e përzierjes së ujit të lumenjve me atë të deteve në sipërfaqen e grykave të mëdha, si do të shihet më poshtë.

"Ai është që juve tokën ua bëri të përshtatshme, andaj, ecni nëpër pjesë të saj dhe shfrytëzoni begatitë e Tij, vetëm te Ai është e ardhmja." (S67 - A15)

"E pastaj tokën e sheshti." (S79 - A30)

"Dhe prej saj nxorri ujin e saj dhe kullosat e saj." (S79 - A31)

"Kurse kodrat ia përforcoi" (S79 - A32)

"Si furnizim për ju dhe për kafshët tuaja." (S79 - A33)

Në shumë prej këtyre ajeteve është theksuar vlera e ujit dhe pasoja praktike e pranisë së tij në Tokë - pjelloria e Tokës. Uji, në të vërtetë, në vendet me shkretëtirë, është element numër një që e kushtëzon jetën e njeriut. Por evokimi në Kur'an e tejkalon këtë veçori gjeografike. Është theksuar karakteri i planetit të pasur me ujë, i vetëm në sistemin diellor. Pa ujë Toka do të ishte trup i vdekur si Hëna. Kur'ani ia jep vendin e parë ujit në evokimin e fenomeneve natyrore të

Tokës. Cikli i ujit është përshkruar këtu me saktësi të pazakontë.

## B. CIKLI I UJIT DHE I DETEVE

Kur sot i lexojmë ajetet e Kur'anit, njëri pas tjetrit, që flasin për rolin e ujit në jetën e njerëzve, na duket se të gjithë ajetet shprehin ide krejt të qarta. Shkaku i kësaj është shumë i thjeshtë: në epokën tonë pak a shumë të gjithë e dimë në mënyrë të saktë se si kryhet qarkullimi i ujit në natyrë.

Por kur e marrim parasysh se sa të ndryshme kanë qenë pikëpamjet e lashta për këtë çështje, vërejmë se të dhënat kur'anore nuk zbulojnë pikëpamje mitike që janë përdorur dhe në elaborimin e të cilave spekulimet filozofike kanë pasur ndikim më të madh sesa të dhënat nga vëzhgimet e bëra. Nëse njerëzit, në mënyrë empirike, kanë arritur deri te njohuri të kufizuara, por të dobishme dhe praktike, për përmirësimin e ujitjes, përkundrazi, pikëpamjet e tyre mbi qarkullimin e ujit në tërësi do të ishin të vështira për t'u kuptuar sot. Kështu do të ishte e thjeshtë për t'u marrë me mend se ujërat nëntokësore rrjedhin nga depërtimi i rreshjeve në Tokë. Por, në kohët e lashta citohet si përjashtim pikëpamja e njëfarë Vitruvit, i cili, në Romën e shekullit të parë para epokës sonë, e ka mbrojtur këtë ide. Kështu pas shumë shekujsh, të cilëve u takon edhe epoka e Shpalljes së Kur'anit, njerëzit kanë pasur pikëpamje krejt të gabuara mbi sistemin e ujrave.

Në artikullin "Hidrologjia", të botuar në Encyclopedia Universalis dy specialistë për këto probleme, G. Castany dhe B. Blavoux, kryejnë këtë hulumtim didaktik historik:

Në shekullin VII p.e.s. Talesi nga Mileti e ka mbrojtur teorinë e shtyrjes së ujit të oqeanit në brendësi të kontinentit, rënien në tokë dhe depërtimin e tij në tokë nën ndikimin e erës. Edhe Platoni e ka mbrojtur këtë ide dhe ka menduar se kthimi i ujit në oqean bëhet nëpërmjet një humnere të madhe, Tatarit. Kjo teori do të ketë ithtarët e vet të flaktë deri në shek. XVIII, para Dekartit. Aristoteli ka supozuar se avulli i ujit nga toka kondensohet në honet e thella dhe të ftohta të bjeshkëve dhe formon liqene nëntokësorë që i mbushin burimet. Atë do ta pasojë Seneka (shek. I p.e.s.) dhe do të ketë ithtarë të shumtë deri në vitin 1877, ndër të cilët vlen të përmendet O. Volger. Pikëpamja e parë e pastër mbi qarkullimin e ujit do t'i bjerë ndër mend Bernard Palissys, i cili në vitin 1580 pohon se ujrata nëntokësorë rrjedhin nga depërtimi i shiut në tokë. Këtë teori do ta vërtetojë E. Marioti dhe P. Pero në shek. XVII.

Në pjesët e Kur'anit që po i japim në vijim nuk ka asnjë jehonë të pikëpamjeve jo

të sakta që u përmendën deri tani e të cilat janë ditur në kohën e Muhammedita.s. :

" Ne, nga qielli lëshuam shiun e dobishëm dhe me të bëmë qetë kultivohen kopshte e drithëra që korren. Dhe rritëm trungje të gjata hurmash me fruta të paluar njëri mbi tjetrin. Ushqim për njerëz, dhe me të, Ne e ngjallëm tokën e vdekur , e kështu do të jetë edhe ringjallja." (S50-A9,10,11)

" Ne e lëshuam me masë ujin nga qielli dhe atë e përqëndrojmë në tokë. Po Ne kemi mundësi edhe ta humbim atë (ujin). Dhe me anën e tij Ne mundësuam për ju kopshte hurmash e rrushi, që në to keni shumë pemë dhe hani prej tyre." (S23-A18,19)

" Ne i lëshojmë erërat mbarësuese, e nga qielli (retë) lëshojmë shi dhe atë ju japim ta pini, e ju nuk mund ta ruani atë." (S15 - A22)

Ekzistojnë dy mundësi për interpretimin e ajetit të fundit (S15 - A22). Erërat që pjalmojnë mund të konsiderohen pllenuese të bimëve me anë të bartjes së polenit, por kjo mund të lidhet edhe me shprehjen figurative e cila me analogji thekson rolin e erës, që një re, e cila nuk lëshon shi, kthehet në re që lëshon rrebesh shiu. Ky rol është theksuar shpesh, si në ajetin vijues:

" Allahu është Ai që lëshon erërat, e ato i lëkundin retë dhe Ne i derdhim ato në një vend të thatë dhe me atë ujitje e ngjallim tokën pas vdekjes së saj. Ja kështu është ringjallja."(S35-A9)

Këtu po shohim se pjesa e parë e këtij ajeti ka stil tregimtar dhe, pa kapërcim, pason një shpallje e Zotit. Modifikime të tilla të papritura në formë bisedimi janë të shpeshta në Kur'an.

" Allahu është Ai që lëshon erërat, e ato i lëkundin retë dhe Ai i shtrinë lart si të dojë i bën ato edhe të ndara në pjesë, dhe përmes tyre e sheh se si bie shi, e kur ia lëshon atë kujt të dojë prej robërve të vet, ja, ata gëzohen."(S30-A48)

"Ai është që i lëshon erërat si myzhde pranë mëshirës (shiut) së Tij e kur ato (erërat) bartin re të mëdha, Ne i sjellim mbi një tokë të vdekur dhe lëshojmë në të ujin (shiun), dhe me të (me ujin)nxjerrim të gjitha frutat. Kështu i nxjerrim (i ngjallim) të vdekurit, ashtu që të përkujtoni (fuqinë e Zotit)." (S7-A57)

" Edhe Ai është, që i lëshon erërat myzhde në prag të mëshirës sëTij (shiut) dhe Ne lëshuam prej qiellit ujë të pastër. Që me të t'i japim jetë një toke të vdekur dhe që t'u japim të pijnë atyre që i krijuam, kafshë e shumë njerëz." (S25-A48,49)

"... në atë furnizim që Allahu e lëshon prej qiellit dhe me të, pasi të ketë vdekur e ngjall tokën; dhe në qarkullimin e erërave për një popull që logjikon ka

argumente." (S45-A5)

" Ai e lëshon ujin (shiun) nga qielli e sipas madhësisë së tyre rrjedhin përrocka, kurse vala bart mbi vete shkumë të fryer lart ..." (S13-A17)

Zoti e urdhëron Profetin:

" Thuaj: " Më tregoni, nëse uji juaj humbet në thellësi, kush do t'ju sjell ujë mbitokësor (burimor)." (S67-A30)

"A nuk e sheh se Allahu lëshon ujë nga qielli dhe atë e shpërndan në tokë nëpër burime, mandej me të mbijnë bimë të llojeve dhe të ngjyrave të ndryshme, pastaj ajo thahet dhe ti e sheh atë të zverdhur dhe pastaj e bën atë pleh." (S39-A21)

"Dhe në të Ne u kemi bërë kopshte hurmash e rrushi dhe në të u kemi dhënë burime (uji)." (S36-A34)

Rëndësia e burimeve, furnizimi i tyre me ujin e shiut dhe shpërndarja në burime është theksuar në tri ajetet e fundit. Fakti meriton që të ndalemi në të në mënyrë që të përkujtojmë pikëpamjet dominuese të mesjetës, siç janë ato të Aristotelit, sipas të cilave burimet mbushen nga liqenet nëntokësorë. Në artikullin e vet "Hidrologjia", të botuar në Encyclopedia Universalis, M. M. Rémenierés, profesor në Ecole Nationale du Génie rural, des Eaux et Forêts, përshkruan etapat kryesore të hidrologjisë dhe kujton punimet madhështore të dikurshme për ujitjen, posaçërisht në Lindjen e Mesme, duke tërhequr vërejtjen se me tërë ato ka udhëhequr empirizmi, sepse idetë e atëhershme kanë dalë nga pikëpamjet e gabuara. Ai vazhdon : "Duhet të presim Rilindjen (përafërsisht ndërmjet viteve 1400 - 1600) në mënyrë që pikëpamjet e pastra filozofike tua lirojnë vendin hulumtimeve të mbështetura në observimet objektive të fenomeneve hidrologjike. Leonardo da Vinçi (1452 - 1519) kundërshton pohimet e Aristotelit. Në studimin e tij Shqyrtim i çuditshëm mbi natyrën e ujrave dhe burimeve natyrore e artificiale ("Discours admirable de la nature des eaux et fontaines tant naturelles qu'artificielles, Paris 1570), Bernard Palissy bën interpretimin konkret të qarkullimit të ujit e sidomos furnizimin me shi".

Do ta shohim se vërejtjen e fundit e gjejmë në ajetin 21 të sures 39, që evokon shpërndarjen e ujrave të shiut në burimet në Tokë.

Shiu dhe breshëri janë trajtuar në ajetin 43 të sures 24:

"A nuk e ke parë se si Allahu drejton retë, pastaj i bashkon, i bënë grumbull ato dhe atëherë e sheh shiun se si rrjedh prej tyre. Ai lëshon prej së larti, nga retë e mëdha si kodra breshër dhe me te goditë këdo, e ja largon atij që do...."

Fragmenti tjetër meriton komentim (surja 56, ajeti 68 - 70).

" A e shihni ujin që po pini? Aju elëshoni atë prej reve, apo Ne jemi që e lëshojmë? Sikur Ne të dëshirojmë e bëjmë atë të njelmët, përse nuk falenderoni?"

Të përmendësh faktin se Zoti ka mundur ta bëjë ujin të njelmët, i cili natyrisht nuk është i tillë, është mënyrë e të shprehurit të plotëfuqisë së Zotit. Mënyra e dytë e rikujtimit të kësaj plotëfuqie është sfidë drejtuar njeriut për ta lëshuar shiun nga retë. Por derisa e para është thjesht shaka, e dyta mund të mos jetë në epokën bashkëkohore, në të cilën teknika bën të mundshëm që shiu të bjerë në mënyrë artificiale. A thua aftësia e njeriut për të prodhuar shi të madh i kundërvihet pohimit kur'anor?

Ky nuk është rast, sepse duhet të merren parasysh kufijtë e aftësive të njeriut në këtë fushë. M. A. Facy, kryeinxhinier i meteorologjisë kombëtare, ka shkruar në artikullin "Rreshjet", në Encyclopedia Universalis: "Kurrë nuk do të mund të arrijmë të bëjmë të bjerë shi nga reja e cila nuk i ka karakteristikat e resë me shi ose nga reja e cila ende nuk e ka arritur shkallën përkatëse të evolucionit (të pjekurisë)". Njeriu, prandaj, me anë të mjeteve të përshtatshme teknike vetëm mund të shpejtojë procesin e reshjeve pasi të jenë krijuar kushtet natyrore. Sikur të ishte ndryshe, atëherë nuk do të kishim thatësirë, por kjo nuk është arritur akoma. Të jesh zotërues i shiut dhe i kohës së mirë akoma është një ëndërr. Njeriu me dëshirën e tij nuk mund ta ndërprejë ciklin e vendosur, i cili siguron qarkullimin e ujit në natyrë, cikël i cili, sipas njohurive të hidrologjisë bashkëkohore, mund të përmblihet si vijon:

Rrezatimi i nxehtësisë së Diellit shkakton avullimin e oqeanëve dhe të të gjitha sipërfaqeve tokësore të mbuluara ose të ngopura me ujë. Avulli i liruar në këtë mënyrë ngrihet në atmosferë dhe duke u dendësuar në të formon re. Atëherë ndërhyjnë erërat për t'i shpërndarë në largësi të ndryshme retë e krijuara në këtë mënyrë. Atëherë, ato, herë mund të zhduken duke mos dhënë shi, herë masat e tyre bashkohen me masat e reve të tjera që të krijohen dendësi më të mëdha, herë duke u ndarë për të dhënë shi në një shkallë të caktuar të evolucionit të reve. Kur shiu bie në dete (që përbëjnë 70% të sipërfaqes së Tokës), cikli mbyllet shpejt. Shiu i cili bie në tokë mund të thithet pjesërisht nga bimët dhe të marrë pjesë në rritjen e tyre; këto, me anë të frymëmarrjes, e kthejnë një pjesë të ujit në atmosferë. Pjesa tjetër e ujit të shiut pak a shumë depërton në tokë, nga e cila, nëpërmjet rrjedhave ujore, drejtohet kah oqeanet ose depërton në brendësi të tokës për t'u kthyer në rrjetin e sipërfaqes së tokës me anë të burimeve dhe të burimeve të tjera që humbin në tokë.

Nëse këto të dhëna të hidrologjisë bashkëkohore krahasohen me ato që dalin nga ajetet e shumta të Kur'anit, të cituara në këtë kapitull, do të konstatojmë ekzistimin e përputhshmërisë së konsiderueshme ndërmjet të dhënave të hidrologjisë dhe të

Kur'anit.

DETET

Nëse ajetet kur'anore kanë ofruar materiale për t'i krahasuar me njohuritë bashkëkohore mbi ciklin e ujit në natyrë në përgjithësi, kur është fjala për detet nuk është kështu. Asnjë fragment i Kur'anit që ka të bëjë me këtë nuk fton për konfrontim me të arriturat shkencore në kuptim të mirëfilltë të fjalës. Por, përsëri, nuk është hiç më pak e domosdoshme të theksojmë se asnjë fragment i Kur'anit mbi detet nuk përmban udhëzime në besime, mite ose në bestytini të epokës.

Një numër i konsiderueshëm ajetesh që bëjnë fjalë për oqeanet dhe lundrimin ofrojnë si tema për meditim shenjat e plotëfuqisë së Zotit, që burojnë nga vëzhgimi vijues.

Këto ajete janë:

" ... dhe për të mirën tuaj u vuri në shërbim anijet, të lundrojnë nëpër det me urdhrin e Tij, e në shërbimin tuaj i vuri edhe lumenjtë." (S14-A32)

"Pastaj, Ai është që nënshtroi detin, që prej tij të hani mish të freskët, e prej tij të nxirrnin stoli që i bani (i vishni), e i sheh anijet si çajne (lundrojnë ) në të (me ushtimëe çajne ujin në det). Ua nënshtroi që të shfrytëzoni nga begatitë e Tij dhe ashtu të falenderoni (Zotin)." (S16-A14)

"A nuk e sheh se anijet lundrojnë në sajë të mirësisë së Allahut, e për t'ju treguar juve madhërinë e Tij..."(S31-A31)

"Dhe të Atij janë anijet lundruese të ngritura lart si kodra në det."(S55-A24)

"Argument për ta është dhe ajo se Ne pasardhësit e tyre (të Ademit) i bartëm në anije të mbushur përplot. Dhe ngjashëm me të, u krijuam atyre diçka që t'i hipin. E sikur të duam Ne, i përmbytim ata, e nuk ka efekt as lutja e tyre dhe as që do të shpëtonin. Përveç nga mëshira jonë ndaj tyre, dhe që të përjetojnë të mirat deri nënjë kohë të caktuar."( S36-A41-44)

Këtu është e qartë se bëhet fjalë për anijet që bartin njerëzit nëpër det, ashtu si dikur anija e barti Nuhun dhe të tjerët që ishin në të dhe ua bëri të mundur të arrijnë deri në tokë.

Nga të gjitha ajetet kur'anore që janë kushtuar vëzhgimit të deteve, mund të

veçohet një fakt tjetër, sepse tregon një aspekt krejt të veçantë. Kështu tri ajete bëjnë aluzion në disa karakteristika të lumenjve të mëdhenj kur derdhen në oqean. Njihet mirë fenomeni që haset shpesh: mospërzierja direkte e ujrave të njelmët të deteve dhe të ujrave të ëmbël të lumenjve të mëdhenj. Mendohet se Kur'ani tërheq vërejtjen në rastin e grykës së Eufratit dhe të Tigris, të cilët, me bashkimin e tyre, krijojnë si të thuash një "det" të gjatë 150 kilometra, Shat el Arab. Në fund të gjirit, ndikimi i baticave dhe zbaticave krijon fenomenin fatlum të fryrjes së ujit të ëmbël në brendi të tokës, duke siguruar ujitje të mjaftueshme. Që të kuptohet si duhet teksti i (ajeteve), duhet ditur se fjala det shpreh kuprtimin e përgjithshëm të fjalës arabe bahr, e cila do të thotë masë e madhe uji dhe përdoret si për oqean ashtu edhe për lumenj shumë të mëdhenj, si: Nili, Tigris, Eufrati.

Në vijim po i japim tri ajete që evokojnë fenomenin:

"Ai la të lirë të bashkohen dy dete, ky (njëri) i pijshëm dhe i shijshëm, e ky (tjetri) i njelmët e i idhët, e mes tyre bëri si të jetë ndonjë pendë, pritë që të mos përzihen." (S25 - A53)

"E nëse janë të njëjtë dy dete; ky i ëmbël shuan etjen dhe pirja e tij është e lehtë e ky tjetri i njelmëti djeg. E prej secilit ju hani mish të freskët, nxirni stoli që i bani; e, i sheh anijet se si çajnë ujin për të kërkuar të mirat e Tij. Ashtu që ju të falenderoni." (S35 - A12)

"Ai i lejoi dy dete të puqen ndërmjet vete. Ndërmjet atyre të dyve është një pengues që ata të dy nuk e kapërcejnë... Prej atyre të dyve nxirren margaritarë e diamantë." (S55 - A19,20, 22)

Pos përmendjes të faktit kryesorë, këto ajete përmendin pasuritë që nxirren nga ujrat e ëmbël dhe të njelmët: peshk, stoli për rroba, margaritar dhe merxhan. Sa i përket fenomenit të mospërzierjes së ujrave të lumenjve me ato të deteve në grykë, duhet të dihet se ky nuk është specifik vetëm për Eufratin dhe Tigrin, që përmenden në tekst, por edhe për lumenjtë e tjerë të cilët nuk përmenden. Rrjedhat e ujrave me gjerësi shumë të mëdha, siç janë: Misisipi ose Jang-Ce, tregojnë të njëjtën veçori: përzierja e ujrave të tyre bëhet ndonjëherë larg në detin e hapët.

### C. RELIEVI I TOKËS

Përbërja e Tokës është e ndërlikuar. Sot mund të themi se është e përbërë nga një shtresë e thellë, ku mbretërojnë temperatura tepër të larta, me një pjesë qendrore në të cilën shkrihen shëmbinjte dhe me një shtresë sipërfaqësore, me koren e Tokës, të fortë dhe të ftohtë. Kjo shtresë është mjaft e hollë, prej disa kilometrash deri në



disa dhjetra kilometra më se shumti, kurse rrezja e Tokës është pak më e madhe se 6.000 km: kjo do të thotë se korja nuk paraqet as të njëqindtën pjesë të rrezes së sferës. Në këtë cipë, nëse mund të thuhet kështu, kanë ndodhur fenomene gjeologjike. Në thelbin e tyre qëndrojnë shtresimet nga të cilat janë krijuar vargmalet; formimi i tyre në gjeologji quhet orogjeneza. Prosesi ka rëndësi të madhe sepse dukurisë së relievit që do ta përbëjë një mal i përgjigjet, në thellësi, thellësira proporcionale e kores së Tokës e cila siguron bazën në shtresën e ulët.

Historia e shpërndarjes së deteve dhe tokave në sipërfaqe të rruzullit të Tokës është e re dhe akoma është shumë e paplotë edhe për periudhat më pak të vjetra dhe të njohura më mirë. Me siguri paraqitja e oqeaneve që e përbëjnë hidrosferën është e vjetër dhe përafërsisht 500 milion vjet. Nga fundi i paleozoikut kontinentet formonin një masë unike e më vonë u shpërndanë. Herën tjetër, kontinentet ose pjesët e tyre dolën mbi sipërfaqe me krijimin e maleve në zonat oqeanike (p.sh. rasti i kontinentit verioatlantik dhe një pjesë e Evropës).

Sipas ideve bashkëkohore, me tërë historinë e formimit të tokave të larta dominon paraqitja e vargmaleve. I tërë evolucioni i Tokës, nga paleozoiku deri në kvartar, klasifikohet në funksion të "fazave arogjenetike" të cilat, edhe vetë, janë të grupuara në "cikle" me emra të njëjtë, çdo formim i relievit të maleve ka reperkusionet e veta në barazpeshën ndërmjet deteve dhe kontinenteve. Kjo ka bërë që të zhduken disa pjesë të tokave të dala në sipërfaqe, për t'u paraqitur të tjerat, duke e ndryshuar shpërndarjen e sipërfaqeve kontinentale dhe oqeanike, para qindra milionë vjetësh, kështu që pjesa kontinentale sot zë vetëm 3/10 e sipërfaqes së planetit.

Kështu, në mënyrë jo të saktë dhe jo të plotë, mund të bëhen konkludime për transformimet që kanë ndodhur para qindra milion vjetësh.

Sa i përket relievit të Tokës Kur'ani përmend, pothuajse, vetëm formimin e maleve. Në të vërtetë, nga pikëvështrimi i interesit tonë, shumë pak mund të thuhet për ajetet që shprehin vetëm kujdesin e Zotit për njerëzit, në krahasim me formimin e Tokës si në ajetet që vijojnë:

"All-llahu juve ua bëri tokën të sheshtë. Që nëpër të të ecni rrugëve të gjëra." S72 - A19,20)

"Edhe tokën Ne e kemi shtruar, sa shtrues të mirë jemi." (S51 - A48)

Shtroja që është shtruar dhe shtrirë është korja ose korja e Tokës, e cila është e fortë dhe në të cilën mund të jetojmë, meqë shtresat më të thella të rruzullit të Tokës janë tepër të nxehta, të lëngshme dhe të papërshtatshme për çfarëdo lloj të jetës.

Janë shumë të rëndësishme fragmentet e Kur'anit që kanë të bëjnë me malet dhe

aluzionet në stabilitetin e tyre, si pasojë e fenomenit të shtresimit.

"...Edhe kodrat se si janë vendosur! Edhe tokën se si është shtruar!" (S88 - A19,20)

Konteksi i këtyre ajeteve i thërret jobesimtarët që të kthejnë shikimet e tyre në drejtim të disa fenomeneve natyrore, ndërmjet të cilave është toka dhe malet. Nga ky tekst gjithashtu del qartë kuptimi i rrënjëve në brendësi të Tokës, kurse në ajete vijuese këtë e saktësojnë edhe më mirë:

"A nuk e bëmë Ne tokën të përshtatëshme (për jetë). Ndërsa kodrat shtylla." (S78 - A6 -7)

Shtyllat në të cilat aludohet këtu janë ato që shërbejnë për përforcimin çadrave në tokë(autad,shumësi uatad).

Gjeologët bashkëkohorë i përshkruajnë shtresat e tokës (gjë që bën të mundshëm që relievet të kenë themel) me madhësi të ndryshme që shkon prej një kilometër në dhjetra kilometra. Ky fenomen i rrudhjes bën që korja e Tokës të jetë stabile.

Kështu nuk çuditemi fare kur në disa fragmente të Kur'anit lexojmë disa mendime mbi malet, siç janë p.sh:

"Kurse kodrat i përforcoi."(S79 - A32)

" ...e në tokë vendosi kodra të rënda që të mos luajnë vendit bashkë me ju..." (S31 - A10)

Fjalja e njëjtë përsëritet në suren 16, ajeti 15. Po kjo ide është shprehur me pak ndryshim në suren 21, ajetin31:

"Dhe në të (tokë) Ne kemi krijuar bjeshkë të paluhatëshme që të mos i lëkundë ata..." (S21 - A31)

Këto ajete shprehin atë se mënyra e vendosjes së maleve i përshtatet stabilitetit të tyre, gjë që edhe përputhet në tërësi me të dhënat e gjeologjisë.

#### D. ATMOSFERA E TOKËS

Pëveç disa aspekteve që në mënyrë më të saktë bëjnë fjalë për qiellin dhe të cilat janë shqyrtuar në kapitullin paraardhës, Kur'ani përmban disa fragmente që kanë të bëjnë me fenomenet në atmosferë. Sa i përket konfrontimit të tyre me të arriturat

shkencës bashkëkohore, edhe këtu, si kudo, do të vërejmë vetëm se nuk do të ketë kundërthënie me njohuritë tona shkencore lidhur me fenomenet e përmendura.

#### LARTËSIA MBIDETARE

Një mendim i përgjithshëm mbi ndenjën e shqetësimit që ndjehet në lartësinë mbidetare, e cila vjen gjithnjë duke u rritur, sa më lartë që të ngjitemi, është shprehur në ajetin 125 të sures 6:

"Atë që All-llahu dëshiron ta udhëzojë, ia zgjeron zemrën për (pranuar) Islamin. Atë që dëshiron ta lërë në humbje, zemrën etij ia bën shumë të ngushtë sikur të ngjitej në qiell. Kështu All-llahu lëshon dënimin mbi ata që nuk besojnë." (S6 - A125)

Disa kanë pohuar se kuptimi i shqetësimit të lartësisë nuk ka qenë i njohur për arabët në kohën e Muhmmedit a.s. Por duket se kjo nuk është ashtu: egzistimi i maleve të larta në Gadishullin arabik deri mbi 3.500 merta e bën pak të mundshme mosnjohjen e vështirësive të frymëmarrjes gjatë ngjitjes në lartësi. Ka komentues të tillë që me këtë kanë dashur të shohin paralajmërimin e pushtimit të Gjithësisë, gjë që duket se duhet të hidhet poshtë në mënyrë kategorike, së paku kur është fjala për këtë fragment.

#### ELEKTRICITETI ATMOSFERIK

Elektriciteti atmosferik dhe pasojat e tij: rrufeja, breshëri janë pretekse për vërejtje vijuese:

"Ai është që ju shfaq vetëtimën trishtuese (nga ndonjë fatkeqësi), por edhe shpresëdhënëse (për shi), dhe formulon re të dendura." (S13 - A12)

"Ndëkaq, mumurima madhëron (Zotin një) me falenderimin (që i takon) e Tij, (e madhërojnë) edhe ëngjëjt nga droja ndaj Tij. E Ai dërgon rrufetë dhe me ato godet kë të dojë. Ndërsa idhujtarët polemizojnë rreth All-llahut, e Ai është ndërshues i rreptë." (S13 - A13)

"A nuk e ke parë se si All-llahu drejton retë, dhe pastaj i bashkon, i bën grumbull ato dhe atëherë e sheh shiun si rrjedh prej tyre. Ai lëshon prej së larti nga retë e mëdha si kodra breshër dhe me të goditë këdo, e ia largon atij që do. Shkëlqimi i vetëtimës së dritës së resë gati se s'të merr të parit." (S24 - A43)

Në këto dy ajete egziston shprehja e korelacionit të qartë ndërmjet formimit të reve

të rënduara nga shiu ose nga breshëri dhe krijimit të rrufesë: i pari është objekt i dëshirës për shkak të bamirësisë që sjell, kurse i dyti është objekt i frikës, pasi reshja e tij i është nënshtruar vendimit të Plotëfuqishmit. Lidhja ndërmjet këtyre dy fenomeneve është në përputhje me njohuritë e sotme mbi elektricitetin atmosferik.

## HIJA

Fenomeni mbi hijen dhe lëvizjen e saj që për kohën tonë është shpjegim banal është objekt i mendimeve si më poshtë:

"A nuk po shohin ata (keqbërësit) se çdo send që e krijoi All-llahu, e sjell hijen e vet djathtas dhe majtas duke iu përlurur All-llhut (duke bërë sexhde)dhe duke qenë respektues e përlulës e si e mbajnë veten lart disa njerëz). (S16 - A48)

"A nuk e sheh se si Zoti yt e zgjati (andej e këndeje) hijen, e sikur të kishte dashur do ta linte në një vend, pastaj Diellin e bëmë rrëfytes të saj. Pastaj Ne atë e tërheqim pak nga pak." (S25 - A45, 46)

Pëveç asaj që ka të bëjë me përluljen ndaj All-llahut të çdo sendi të krijuar, duke e përfshirë edhe hijen e sendit, dhe marrjes së sërishme nga All-llahu të çdo manifestimi të fuqisë së Tij, tekstit kur'anor aludon në lidhjet e hijes me Diellin. Duhet të rikujtojmë se në kohën e Muhammedit a.s. ka egzistuar besimi se lëvizja e hijes ka qenë e kushtëzuar nga lëvizja e Diellit nga lindja në Perëndim. Kjo edhe gjeti zbatim në orën diellore për matjen e kohës ndërmjet lindjes dhe perëndimit të Diellit. Këtu Kur'ani flet për fenomenin dhe nuk përmend shpjegimin që ka dominuar në epokën e Shpalljes së tij: këtë shpjegim do ta pranonin njerëzit gjatë shumë shekujve pas epokës së Muhammedit a.s., por më në fund do të vërehej pasaktësia e tij. Kështu Kur'ani flet vetëm për rolin e Diellit si tregues i hijes. Këtu konstatojmë mungesën e çfarëdo mospajtimi dhe asaj që dihet mbi fenomenin në kohën bashkëkohore.

## VI.

### BOTA BIMORE DHE SHTAZORE

Në këtë kapitull janë mbledhur shumë ajete të cilat bëjnë fjalë për prejardhjen e jetës, disa nga aspektete botës bimore dhe për tema të përgjithshme ose të veçanta që kanë të bëjnë me botën shtazore. Grupimi në një klasifikim racional i ajeteve të shpërndara nëpër tërë Librin duket i përshtatshëm për të dhënë idenë mbi tërësinë e të dhënave kur'anore lidhur me të gjitha këto çështje.

Për temat e këtij dhe të kapitullit vijues hulumtimi i tekstit kur'anor ndonjëherë është posaçërisht delikat për shkak të disa vështirësive që janë të leksikut. Ato edhe mund të kapërcehen, por vetëm pas shqyrtimit të të dhënave shkencore që kanë të bëjnë me temën e trajtuar, posaçërisht kjo vlen për atë që lidhet me qëniet e gjalla: bimët, shtazët dhe njeriun - se konformimi me mësimet shkencore është i domosdoshëm që të gjendet kuptimi i disa dëshmive kur'anore në këto fusha.

Prandaj është e kuptueshme se shumë përkthime të këtyre fragmenteve, të cilat i kanë bërë njerëzit me kulturë, një shkencëtarë i vlerëson si të pasakta. E njëjta gjë vlen edhe për komentimet kur autorët e tyre nuk kanë dituri shkencore të nevojshme për ta kuptuar tekstin.

faqja 4 nga 6 ||| faqja 5 faqja 6

#### A. PREJARDHJA E JETËS

Kjo çështje e ka preokupuar njeriun e të gjitha kohëve - edhe për të edhe për qëniet e gjalla që rrethojnë. Këtu do ta shqyrtojmë nga aspekti i përgjithshëm. Rasti i njeriut, ardhja e tij në Tokë dhe riprodhimi janë objekt i shumë punimeve të rëndësishme dhe do të trajtohet në kapitullin vijues.

Duke shqyrtuar prejardhjen e jetës në një plan shumë të përgjithshëm, Kur'ani e evokon me saktësi maksimale në një ajet i cili njëlloj flet edhe për procesin e formimit të Gjithësisë, që e

cituum dhe e komentuum më sipër.

"A nuk e dinë ata, të cilët nuk besuan se qiejt e toka ishin të ngjitura, e Ne i ndamë ato të dyja dhe ujin e bëmë bazë të jetës së çdo sendi; a nuk besojnë?" (S21 - A30)

Kuptimi i prejardhjes nuk sjell dyshim. Fjala mund të ketë kuptimin se çdo gjë e gjallë e ka prejardhjen nga uji. Të dy kuptimet e mundshme janë në përputhje të plotë me të dhënat shkencore: jeta e ka prejardhjen nga uji dhe uji është përbërësi i parë i çdo qelize të gjallë. Pa ujë nuk është e mundshme asnjë jetë. Posa të diskutohet mbi mundësitë e jetës në një planet, menjëherë bëhet pyetja: a thua ky planet ka sasi të mjaftueshme të ujit?

Të arriturat bashkëkohore na bëjnë të mundshme të mendojmë se gjallesat më të vjetra do të kenë qenë bimët: algat e vjetra që janë gjetur në epokën parakambrike, d.m.th në tokat më të vjetra që njihen deri më sot. Me siguri se elementet e botës shtazore janë paraqitur pak më vonë: ato gjithashtu kanë ardhur nga oqeani.

Ajo që këtu po e përkthejmë si ujë është fjala mâ', e cila gjithashtu ka kuptimin e ujit nga qielli, si dhe të ujit të oqeanit, ose të çfarëdo lëngu tjetër. Në kuptimin e parë, uji është element i domosdoshëm i çdo jete bimore:

"...Ai e lëshon shiun nga qielli!" - Vetëm Ne bëjmë që me ndihmën e tij të mbijnë elementete çifteve të bimëve të ndryshme" 68. (S20 - A53)

Kjo është përmendja e parë e çifteve të bimët, nocioni për të është përdorur në formën e saj të pacaktuar për të shprehur atë që është bazë e egzistimit të çdo shtaze:

"All-llahu të gjitha shtazët i krijoi prej lëngu"69. (S24 - A45)

Më poshtë do të shohim se fjala mund të përdoret për farën e lëngët.

Kështu, qoftë kur është fjala për prejardhjen e jetës në përgjithësi, për elementin që bën të mbijë bima nga toka ose për embrionin shtazor, të gjitha pohimet e Kur'anit mbi prejardhjen e jetës janë në përputhje të plotë me arritjet shkencore bashkëkohore. Asnjë mit mbi prejardhjen e jetës, që kanë qenë të shumtë në atë epokë, nuk ka zënë vend në tekstin e Kur'anit.

## B. BOTA BIMORE

Këtu nuk mund t'i citojmë fragmentet e shumtë të Kur'anit, në të cilët bamirësia e Zotit evokohet me rastin e karakterit bamirës të shiut i cili që të mbijë vegjetacioni.

"Ai është që për ju lëshoi nga (qielli) lart ujë, që prej tij të keni për të pirë dhe prej tij të keni bimë që në to do t'i kullotni (bagëtinë)." (S16 - A10)

" Me atë (shiun) mbijnë, për të mirën tuaj, të lashtat, ullinjtë, hurmat, rrushnajat dhe nga të gjitha frutat(e pemëve). Në këto (të mira) ka argumente për një popull që vështron. (S16 - A11)

"Ai është që lëshoi nga lartë shiun e me të nxorri bimën e çdo sendi dhe prej bimës gjelbërim dhe prej tij(prej gjelbërimit) kokrra të dendura në kallinj. E nga hurmat, nga sythi i tyre kalaveshë të afërt (për t'i vjelë). Edhe kopshtie me hardhi, ullinj e shegë të ngjashme (në dukje) e të shumëllojshme (në shije). Shikoni pra frutat e tyre kur i formojnë dhe kur piqen (të gjitha nga shiu). Edhe në këto ka fakte për njerëzit që besojnë. (S6 - A99)

"Ne, nga qielli lëshuam shiun e dobishëm dhe me të bëmë që të kutivohen kopshte e drithëra që korren." (S50 - A9)

"Dhe rritëm trungje të gjatë hurmash me fruta të paluar njëri mbi tjetrin. (S50 - A10)

"Ushqim për njerëz, dhe me të, Ne e ngjallëm tokën e vdekur, e kështu do të jetë edhe ringjallja." (S50 - A11)

Këtyre shqyrtimeve të përgjithshme Kur'ani ju shton edhe të tjera që kanë të bëjnë me aspekte më të kufizuara:

### EKUILIBRI QË ËSHTË VENDOSUR NË BOTËN BIMORE

"E Tokën ... ekemi bërë që në të të mbijnë bimë të caktuara të të gjitha llojeve. (S15 -- A19)

### DALLIMI I USHQIMIT

"E në tokë, copa sipërfaqesh, të ngjitura njëra me tjetrën, kopshte të hardhisë, të mbjella (të shumëllojshme) dhe hurma (bimë këto) që

janë të degëzuara në shumë trupa dhe jo të degëzuara (nga një filiz) e të gjithë ujitën nga një ujë, dhe Ne shijen në ngrënie të frutave të tyre e kemi dalluar njëri prej tjetrit. Edhe kjo dëshmon me argumente për njerëzit e mençur. (S13 - A4)

Është interesante të vërejmë egzistimin e këtyre ajeteve që të dalë në pah matura në përdorimin e shprehjeve dhe mungesa e ndonjë vërejtje që do të mund të tregonte më parë besimin e epokës, sesa të së vërtetës themelore. Por, vëmendjen e tërheqin, sidomos, dëshmitë e Kur'anit mbi riprodhimin në botën shtazore.

### RIPRODHIMI I BIMËVE

Duhet ta rikujtojmë edhe një herë se riprodhimi në botën bimore kryhet në dy mënyra: seksuale dhe joseksuale. Këtu duhet të themi se vetëm mënyra e parë meriton të quhet riprodhim, sepse përcakton një proces biologjik, qëllimi të cilit është paraqitja e bimës së re, të njëjtë me atë që e ka lindur.

Riprodhimi joseksual është shumëzim i thjeshtë, sepse ky sjell deri te fragmentarizimi i një organizmi, i cili, i ndarë nga vetë bima, do të arrijë zhvillim që e bën të ngjashëm me atë nga e cila ka rrjedhur: Gilermoni dhe Manzheni e konsiderojnë "rast i posaçëm i rritjes". Shembull shumë të mirë e të thjeshtë për këtë na e jep fidani: dega e prerë e një bime, e futur në tokë dhe e ujitur si duhet, regenerohet duke zhvilluar rrënjë të re. Për këtë qëllim disa nga bimët kanë organe të specializuara, të tjerat i lëshojnë embrionet të cilat sillen si farat, nëse mund të shprehemi kështu, që janë rezultat i një procesi të riprodhimit seksual.

Riprodhimi seksual i bimëve bëhet me anë të mbarësimit të elementeve mashkullorë dhe femërorë, të cilat u takojnë formacioneve krijuese të bashkuara ose të ndara në të njëjtën bimë.

Kur'ani vetëm këtë e shqyrton:

"Ai e lëshon shiun nga qielli! "Vetëm Ne bëjmë që me ndihmën e tij të mbijnë elementet e çifteve të bimëve të shumëllojshme". (S20 - A53)

Elementi çift është përkthim i fjalës zeug (shumës azuag) kuptimi themelor është: ajo që, e marr nga tjetri, bën çiftin; fjala ka të bëjë si me bashkëshortët, ashtu edhe me këpucët, në mënyrë të barabartë.

"E ti e sheh tokën e thatë - të vdekur, e kur Ne ja ia lëshojmë asaj



shiun ajo gjallërohet, shtohet dhe nga të gjitha llojet rritë bimë të këndshme." 70 (S22 - A5)

"... Ne kemi lëshuar shi e kemi bërë të mbijnë në të nga të gjitha llojet e dobishme. (S31 - A10)

"Dhe ai është, i cili tokën e shtriu, dhe në të krijoi kodra e lumenj dhe prej secilit frut bëri dy lloje (çift)..." (S13 - A3)

dihet se fryti është fund i procesit të riprodhimit të bimëve të larta, të cilat e kanë organizimin më të përpunuar dhe më të larta, të cilat e kanë organizimin më të përpunuar dhe më kompleks. Stadi që i paraprin frytit është lulja me organet e veta mashkullore (pjalmin) dhe femërore (mugujt). Këto të fundit, pas marrjes së polenit, japin fryta, të cilat pas pjekjes, lirojnë farat. Çdo fryt, d.m.th nënkupton ekzistimin e organeve mashkullore dhe femërore. Këtë dëshiron të na thotë ajeti Kur'anor. Por, duhet vërejtur se në disa lloje frytat mund të rrjedhin nga lulet e pafekondhuara (frytat partenokarpik), siç janë bananet, disa lloje të ananasit, të fikut, të portokallit dhe të hardhisë. Por, ato rrjedhin nga bimët me gjini të caktuar.

Riprodhimi përfundohet me ndihmën e procesit të mbirjes së farës , pas zbërthimit të cipës së jashtme të saj (që mund të jetë kondenzuar në bërthamë). Ky zbërthim bën të mundshëm daljen e rrënjëve, të cilat do të thithin prej tokës atë që është e nevojshme për bimën me jetë të ngadaltë, siç është fara, në mënyrë që ajo të zhvillohet dhe të japë bimën e re.

Një ajet Kur'anor aludon në këtë mbirje:

"S'ka dyshim, All-llahu është zbërthyes i farës (i kokrrës prej saj) dhe i bërthamës (së pemës). Ai nxejrr të gjallin nga i vdekuri dhe i ai është nxjerrës i të vdekurin nga i gjalli. Ky është All-llahu, e si atëherë shmangeni (nga besimi)?" (S6 - A95)

Kur'ani i cili përsërit shpesh ekzistimin e elementeve të çifteve në botën bimore, e shënon këtë nocion të çifteve në mënyrë të përgjithshme, kufijte e së cilës nuk janë të saktësuar.

"I pastër nga të metat është Ai që krijoi të gjitha llojet (çiftet) nga çka mban toka, nga vetë ata dhe nga çka nuk dinë. (S36 - A36)

Mund të bëjmë shumë supozime mbi rëndësinë e këtyre gjërave të cilat njerëzit nuk i kanë njohur në kohën e Muhammedi a.s. dhe te të

cilat sot dallojmë strukturat dhe funksionimin në çifte, në renditje të pakufishme të vogël dhe të madhe, në botën e gjallë dhe në atë të vdekur. Është me rëndësi t'i mbajmë mend nocionet e shprehura në mënyrë të qartë dhe që të vërtetojmë një herë e mirë se nuk ka papajtueshmëri me shkencën e sotme.

### C. BOTA SHTAZORE

Shumë çështje në Kur'an, që kanë të bëjnë me botën shtazore, janë objekt i vëzhgimeve që kërkojnë t'i qasemi konfrontimit me njohuritë bashkëkohore shkencore në këto pika të veçanta. Por edhe këtu do të ofronim një shikim jo të plotë të asaj që e përmban Kur'ani lidhur me këtë temë, sikur mos ta përmendnim fragmentin vijues, ku krijimi i disa elementeve të botës shtazore evokohet për t'i nxitur njerëzit të mendojnë mbi bamirësitë e Zotit ndaj tyre. Këtë fragment, në të vërtetë, e citojmë për të dhënë shembullin e mënyrës se si Kur'ani evokon përshtatjen e harmonishme të krijimit me nevojat e njerëzve, e në këtë rast të veçantë të bujkut, sepse ky nuk nxit për lloje të tjera të hulumtimit.

"Edhe kafshët Ai i krijoi dhe në sajë të këtyre ju mund të mbroheni (nga të ftohtit), keni edhe dobi të tjera dhe prej tyre hani. Në to (në kafshët) ju shihni hijeshi (idili) kur në mbrëmje ato i ktheni ( nga kullosat)dhe kur në mëngjes i lëshoni(për në kullosë). Ato bartin barën tuaj (të rëndë) në ndonjë vend (të largët) që ju do të arrinit atje me shumë vështirësi (me gjysëm shpirti). Vërtet, Zoti juaj është shumë Bamirës dhe shumë Mëshirues. Edhe kuajt (i krijoi) edhe mushkat edhe gomarët, për t'ju hipur atyre dhe si stoli, e Ai krijoi (për hipje) çka ju (tash) nuk dini." (S16 - A5,6,7,8)

Pëveç këtyre shqyrtimeve të përgjithshme, Kur'ani i vë në dukje disa të dhëna mbi tema shumë të ndryshme, siç janë:

- riprodhimi në botën shtazore
- ekzistimi i bashkësive shtazore
- meditim mbi bletët, merimangën, zogjtë
- dëshminë mbi prejardhjen e qumështit shtazor.

#### 1. RIPRODHIMI NË BOTËN SHTAZORE

Këtë në tërësi e evokojnë ajetet 45 dhe 46 të sures 53:

"Dhe Ai është që krijoi llojet - mashkullin dhe femrën. Nga pika e farës që hidhet". (S53 - A45,46).

Elementi i çiftit është i njëjtë shprehje si ajo që e kemi hasur në ajetet që kanë të bëjnë me riprodhimin e bimëve. Këtu janë shënuar gjinitë. Një hollësi shumë karakteristike është theksimi i saktësisë së sasisë së vogël të lëngut që është e nevojshme për riprodhim. Pasi është po ajo fjalë që tregon spermën e përdorur për njeriun, në kreun vijues do të bëjmë komentimin lidhur me rëndësinë e kësaj vërejtjeje.

## 2. EKZISTIMI I BASHKËISVE SHTAZORE

"Nuk ka asnjë gjallesë në tokë dhe as shpendë që fluturojnë me dy krahë e që nuk i janë ndarë në grupe (të ndryshme), sikurse edhe ju (Zoti i krijoi i pajisi si juve). Asgjë nuk kemi lënë pasdore nga evidenca. Më në fund te Zoti i tyre do të tubohen." (S6 - A38)

Shumë pika të këtij ajeti kanë nevojë për komentim. Së pari, si duket, është evokuar fati i kafshëve pas vdekjes: Islami për këtë çështje, pa dyshim, nuk ka kurrëfarë doktrine. Pastaj, parapërcaktimi i përgjithshëm, për të cilin, si duket, bëhet fjalë këtu, i kufizuar në struktura dhe organizimin funksional i cili kushtëzon mënyrën e sjelljes: shtaza reagon në nxitës të ndryshëm të jashtëm në funksion të një kushtëzimi të veçantë.

Sipas Blacherit, një komentues i vjetër siç është Razi, ka menduar se ky ajet vështron vetëm veprimet instiktive me të cilat kafshët i bëjnë nderime Zotit.

Shejh si Bubaker Hamza, në komentet e përkthimit të tij të Kur'anit, flet për "instiktin, i cili, mbi bazë të urtësisë hyjnore, i detyron të gjithë qëniet e gjalla të grupohen për t'u riprodhuar dhe të organizohen në bashkësi, të cilat, për të qenë të afta për jetë, kërkojnë që puna e çdo anëtari t'i shërbejë tërë grupit".

Këto sjellje të kafshëve janë studiuar me vëmendje në dhjetëvjeçarët e fundit dhe si rezultat u zbuluan bashkësi të vërteta shtazësh. Është e sigurtë që hulumtimi i rezultatit të punës të një bashkësie ka mundur të na shtyjë kaheër që të pranohet nevoja e organizimit shoqëror. Por vetëm pak kohë më parë janë zbuluar mekanizma që i drejtojnë këto organizime te disa lloje. Rasti i bletës është pa dyshim rasti i studiuar më së miri dhe më i njohuri. Rreth sjelljes së

saj është i lidhur emri i von Frishit. Von Frishi, Lorenci dhe Tinbergeni me të drejtë e kanë marrë çmimin Nobel për vitin 1973.

### 3. MEDITIMET PËR BLETËT MERIMANGAT DHE SHPENDËT

Kur specialistët për sistemet nervore dëshirojnë të marrin shembuj të argumentuar në mënyrë bindëse të organizimit të çuditshëm, i cili drejton sjelljet e shtazëve, shtazët që ndoshta përmenden më së shpeshti janë bletët, merimangat dhe shpendët (sidomos shpendët shtegetarë). Për çdo rast mund të vërtetohet që këto tri grupe paraqesin shembuj shumë të bukur të një organizimi të lartë.

Fakti që Kur'ani e përmend këtë trio shëmbullore të botës shtazore, nga pikëpamja shkencore i përgjigjet tërësisht karakterit jashtëzakonisht interesant të të gjitha shtazëve të përmendura këtu.

#### BLETA

Ajo në Kur'an është objekt i komentimit më të gjatë:

" Zoti yt i dha instikt bletës: "Ndërto shtëpi nëpër kodra (male), nëpër drunj (pemë) dhe nëpër kulmet që ata(njerëzit) i ndërtojnë. (S16 - A68)

Pastaj ha nga të gjitha (llojet) frutat dhe futu nëpër rrugët e nënshtruara (e të mësuara ) prej Zotit tënd. Nga barqet e tyre (të bletëve) del lëng , ngjyra e të cilit është e ndryshme dhe në të cilin ka shërim (bar- ilaç) për njerëzit. Edhe në këtë ka arsye për atë popull që mendon thellë." (S16 - A69)

është e vështirë të dihet çka do të thotë saktësisht urdhëri që me bindje të ndiqet rruga e Zotit, nëse kjo nuk është nga pikëvështrimi i përgjithshëm. Ajo që mund të thuhet në funksionin e njohurive të arritura nga studimi i sjelljes së saj, është se këtu - ashtu si dhe në secilin prej të tri rasteve të shtazëve që përmenden si shembull në Kur'an - organizimi i jashtëzakonshëm nervor është pikëmbështetje e sjelljes. Dihet se nga mënyra e fluturimit të tyre bletët mund të komunikojnë ndërmjet tyre; ato janë në gjendje që në këtë mënyrë t'u tregojnë familjeve të tyre në cilin drejtim dhe sa larg ndodhen lulet për grumbullimin e mjaltit. Prova e njohur e von Frishit tregoi domethënien e lëvizjes së insektit, qëllimi i të cilit është dërgimi i informacionit ndër bletët punëtore.

## MERIMANGA

Merimanga përmendet në Kur'an që të theksohet brishtësia e vendbanimit të saj, më i brishti nga të gjithë. Ky është vendbanim aq i pasigurtë, thotë teksti kur'anor si ai që njerëzit ja rrëmbyen vetvetes duke zgjedhur zota jashtë Zotit.

"Shembulli i atyre, të cilët veç Allahut morën mbrojtës (zota idhujsh), është si shembulli i merimangës që thur shtëpi, e sikur ta dinin ata, më e dobëta shtëpi është shtëpia e merimangës."(S29 - A41)

Pëlhurën e merimangës, me të vërtetë, e krijojnë fijet e mëndafshta të cilat i tajitin gjendrat e shtazës, diamtri i të cilës është i papërfillshëm. Brishtësinë e saj njeriu nuk mund ta imitojë. Natyralistët pyesin për planin e çuditshëm të punës që e rregjistrojnë qelizat nervore të shtazës dhe i cili ja bën të mundshme të endë në mënyrë të përkryer gjeometrike; por, për këtë Kur'an nuk bën fjalë.

## SHPENDËT

Shpendët përmenden shpesh në Kur'an, ato janë të pranishëm në mënyrë episodike në jetën e Ibrahimit, Jusufit, Daudit, Sulejmanit dhe Isai a.s.t. Më sipër e kemi theksuar ajetin i cili ka të bëjë me bashkësitë e shtazëve tokësore dhe të shpendëve:

"Nuk ka asnjë gjallesë në tokë dhe as shpendë që fluturojnë me dy krahë e që nuk i janë ndarë në grupe (të ndryshme), sikurse edhe ju(Zoti i krijoi i pajisi si juve). Asgjë nuk kemi lënë pasdore nga evidenca. Më në fund te Zoti i tyre do të tubohen." (S6 - A38)

Dy ajete të tjera vënë në dukje nënshtrimin e rreptë të shpendëve ndaj fuqisë së Zotit.

"A nuk po i shohin ata shpendët fluturues në ajrin e qiellit, të cilët nuk i mban kush, përveç Allahut. Edhe në këto ka fakte për njerëzit që besojnë." (S16 - A79)

"A nuk i shikuan ata shpezët mbi ta krahëhapur dhe kur krahët i palojnë, ato nuk i mban tjetër në ajër pos Fuqplotit. Ai është që çdo send e sheh dhe e di."(S67 - A19)

Përkthimi i një fjale të secilit të këtyre ajeteve është punë delikate. Përkthimi që e kemi bërë këtu shpreh idenë se Zoti me fuqinë e tij

mban shendët në fluturim. Fjala arabe për të cilën bëhet fjalë është amsaka, kurse kuptimi i saj i parë është të vënët e dorës mbi, kapje, mbajtje, ndalesë e dikujt.

Është shumë e mundur të krahasohen këto ajete që theksojnë veçanërisht varësinë e ngushtë ndërmjet sjelljes së shpendëve lidhur me rendin e Zotit dhe zbulimet bashkëkohore që tregojnë pikën e përkryerjes që e kanë arritur disa lloje të shpendëve në programimin e shtegëtimit të tyre. Sepse vetëm ekzistimi i programit të migrimit, i rregjistruar në kodin gjenetik të shpendëve, mund t'i shpjegojë fluturimet e komplikua dhe tepër të gjata që janë në gjendje t'i bëjnë shpendët shumë të rinj, pa përvojë paraprake, pa kurrëfarë udhëtreguesi, që në ditën e caktuar të kthehen në cakun prej nga janë nisur. Në librin e tij *La Puissance et la Fragilité*<sup>74</sup> (Fuqia dhe Dobësia), profesor Hamburger përmend si shembull rastin e njohur "muttonbird" nga paqësori dhe rrugës së tij prej tetë deri në njëzet e pesë mijë kilometra largësi<sup>75</sup>. Pranohet se direktivat komplekse për një rrugëtim të tillë janë të shkruara detyrimisht në qelizat nervore të shpendëve. Ato me siguri kanë qenë të programuara. Kush është programisti?

#### 4.PREJARDHJA E PËRBËRËSVE TË QUMËSHTIT TË SHTAZËVE

Prejardhja e përbërësve të qumështit të shtazëve është përcaktuar në harmoni të plotë me njohurinë bashkëkohore (surja 16, ajeti 66). Mënyra e përkthimit dhe interpretimit të këtij ajeti është krejt personale, sepse përkthimet, edhe këto bashkëkohoret japin kuptim të atillë që, sipas mendimit tim nuk mund të pranohet. Ja dy shembuj<sup>76</sup>:

Përkthimi i R. Blacherit<sup>76</sup>:

"Ju njimend keni mësuar nga grigjat tuaja! Ne ju ushqejma me qumësht të pastër, shumë të shijshëm për ata që e pijnë, që vjen nga ajo që është në barqet e tyre, ndërmjet ushqimit të tetur dhe gjakut".

Përkthimi i profesor Hamidullahut<sup>77</sup>:

"Vërtet keni për çka të mendoni në kafshët. Nga ajo që e kanë në barqet e tyre, ndërmjet plehut dhe gjakut, Ne ju japim, të pini qumësht të pastër dhe të pijshëm për ata që e pijnë".

Çdo fiziolog të cilit do t'ja jepnim këto tekste do të përgjigjej se janë shumë të paqartë, sepse në ta nuk ka aspak përputhje as me

botëkuptimet më elementare bashkëkohore. Këta rreshta nga ana tjetër janë vepër të arabistëve shumë të njohur. Por, dihet mirë se një përkthyes, sado që të jetë ekspert, mund të bëjë gabim në përkthimin e shprehjeve shkencore, nëse nuk është i specializuar në disiplinën për të cilën bëhet fjalë.

Përkthimi që më duket i drejtë është përkthimi vijues:

"Me të vërtetë ju mund të nxirrni mësim nga kafshët tuaja: Ne ju japim të pini atë që ndodhet brenda trupave të tyre (e që) zë fill nga kontakti i përmbajtjes ushqyese të zorrëve dhe gjakut, qumështin e pastër, të lehtë për ta pirë ata që e pijnë". (S16 - A66).

Ky interpretim është shumë i afërt me atë të Muntahabit në vitin 1973 të cilin e boton Këshilli Suprem i Punëve Islamike në Kajro që mbështetet me të dhënat e fiziologjisë bashkëkohore.

Në pikëpamjen e leksikut, përkthimi i propozuar arsyetohet kështu:

E kam përkthyer "brenda trupave të tyre" e jo si R. Blachere ose si profesor Hamidullahu "në barqet e tyre"<sup>78</sup>, sepse fjala batn tregon edhe mesin, brendinë e një gjëje, ashtu si edhe barkun. Kjo fjalë këtu nuk ka kuptim të saktë anatomik. Më duket se në "brenditë të trupave përputhet në mënyrë të përkryer me kontekstin.

Nocioni "i prejardhjes" së përbërësit të qumështit është shprehur në fjalën min, kurse "lidhjet" me bayni, fjala e fundit nuk domethënë vetëm "ndërmjet" ose "në mes", si në dy përkthimet e cekura por, shërben për të shprehur atë se dy gjëra ose dy persona vihen në kontakt.

Nga pikëvështrimi shkencor duhet të bazohemi në njohuritë fiziologjike për ta kuptuar përmbajtjen e këtij ajeti.

Substancat e rëndësishme që sigurojnë ushqimin e organizmit në tërësi përfitohen nga transformimet kimike që bëhen gjatë tërë gjatësisë së traktit të tretjes. Këto substanca vijnë elementet e pranishëm në përmbajtjen e zorrëve. Kur transformimet kimike në zorrë arrijnë deri në stadin e dëshiruar, ato nëpër muret e zorrëve kalojnë në qarkullimin e tërësishëm. Ky kalim kryhet në dy mënyra: ose drejtpërsëdrejti, me anë të asaj që e quajmë enë limfatike, ose tërthorazi, me qarkullim, i cili së pari i dërgon në mëlçi, ku pësojnë ndryshime; prej saj kalojnë në qarkullimin e përgjithshëm. Në këtë mënyrë gjithçka kalon nëpër qarkullimin e gjakut.

Përbërësit e qumështit i tajitin gjëndrat e qumështit. Ato ushqehen me produktet e ushqimeve të tretura (nëse mund të themi kështu), të cilat ua ka sjellë gjaku që qarkullon. Domethënë gjaku luan rolin e grumbulluesit dhe të transmetuesit të materieve të nxjerra nga ushqimet në mënyrë që ushqimet të vijnë deri tek gjëndrat e qumështit, të prodhuesit të qumështit, si dhe te çdo organ tjetër.

Këtu çdo gjë fillon me kontaktimin e përmbajtjes së zorrëve dhe gjakut në murin e zorrëve. Kjo njohuri e saktë zbulon zhvillimet e kimisë dhe të fiziologjisë së tretjes. Kjo nuk është njohur fare në kohën profetit Muhammed a.s.: njohja e saj i përket kohës bashkëkohore. Sa i përket zbulimit të qarkullimit të gjakut, kjo është vepër e Harveit dhe është bërë gati gjashtë shekuj pas Shpalljes së Kur'anit. Mendoj se ekzistimi në Kur'an i ajetit, ajet i cili aludon në këto nocione, nuk mund të ketë shpjegime njerëzore për shkak të epokës në të cilën janë formuluar.

## VII.

### RIPRODHIMI NJERËZOR

Riprodhimi është temë mbi të cilën çdo vepër e hershme e njeriut - sapo të merrej paksa me hollësitat - në mënyrë të pashmangshme shpreh pikëpamje të gabuara. Në mesjetë - edhe në periudhën që nuk është aq shumë e largët - riprodhimi ka qenë i veshur me lloj-lloj mitesh dhe besytish. Por nuk ka mundur të jetë ndryshe pasi për t'i kuptuar mekanizmat e saj të ndërlikuar njeriu ka qenë dashur që ta dijë anatominë, të zbulojë mikroskopin dhe të lindi të ashtuquajtura dituri themelore në të cilat janë ushqyer fiziologjia, embriologjia, obstetrika etj. Në Kur'an është krejtësisht ndryshe. Libri në shumë vende evokon mekanizma preciz dhe përmend faza shumë të sakta të riprodhimit, dhe me rastin e leximit nuk orfon asnjë dëshmi të pasaktë sado të vogël. E gjithë kjo është shprehur me terma të thjeshtë, të lehtë për të kuptuar nga shkalla e zhvillimit të njeriut dhe krejtësisht në përputhje me atë që do të zbulohet shumë më vonë.

Riprodhimi njerëzor, i evokuar në dhjetë ajetet e Kur'anit pa ndonjë renditje, është shprehur me anë të dëshmimeve prej të cilave secila ka të bëjë me një apo më shumë pyetje të veçanta. Duhet t'i rigrupojmë këto ajete në mënyrë që të krijojmë një pasqyrë mbi tërësinë. Këtu, si edhe në shumë tema të shqyrtuara, komentimi do të jetë më i



lehtë.

RIKUJTIMI I

## DISA KONCEPTEVE

Është e domosdoshme të rikujtojmë disa koncepte që kanë qenë të panjohura në epokën e Shpalljes së Kur'anit dhe në shekujt e pastajmë. Riprodhimi njerëzor sigurohet e një sërë procesesh, të përbashkët për sisorë, në fillim të të cilit është fekondimi në kanalën e vezores të një vezoreje të shkëputur nga vezorja në mes të ciklit menstrual. Agenci fekondues është sperma e njeriut ose, më saktë, spermatozoidi, sepse është e mjaftueshme vetëm një qelizë e farës: dmth që të sigurohet mbarësimi është e nevojshme sasia më e vogla kësaj fare të lëngët e cila përmban spermatozoide të panumurta (me dhjetra milionë për njëherë). Lëngun e prodhon testisi dhe ai menjëherë vendoset për t'u ruajtur në sistemin e rezervuarit dhe të kanaleve që në fund dalin në rrugët urinare: gjëndrat plotësuese, të shpërndara përreth këtyre të fundit, i shtojnë spermës sekretin plotësues pa elemente mbarsuse. Vendosi e vezës së mbarësuar bëhet në vend të saktë të organeve gjenitale të femrës: ajo zbret nëpër vezëpërçues në mitër dhe zë vend brenda saj ku çerdhohet duke u përzjerë dhe mbështjellur me jargë dhe në muskulin e placentës dhe me ndihmën e saj pas formimit të placentës. Nëse qeliza vezë është përforcuar për shembull, në vezëpërçues e jo në mitër, atëherë shtatzania do të ndërpritet.

Sapo të bëhet i kapshëm nga syri, embrioni duket si një figurinë e vogël fëmije, në të cilën duket një figurinë e papërfillshme e qënies së njeriut. Këtu ajo zhvillohet në fazën e njëpasnjëshme, që sot njihet mirë dhe nga e cila do të dalë skeleti i trupit të njeriut: sistemi i eshtrave, me muskuj rreth tij, sistemi nervor, sistemi i qarkullimit, barku etj.

Këto nocione do të shërbejnë si elemente krahasimtare me atë që mund të lexohet në Kur'an mbi riprodhimin.

RIPRODHIMI

NJERËZOR NË KUR'AN

Nuk është gjë e lehtë të krijojmë një pasqyrë mbi përmbajtjen kur'anore të kësaj teme. Vështirësia e parë rrjedh nga shpërndarja në

tërë Librin e dëshmimeve që kanë të bëjnë me të, e për ç'gjë kemi tërhequr vërejtjen që më parë; por kjo nuk është vështirësia kryesore. Ajo që edhe më shumë mund ta mashtrojë studiuesin, edhe këtu, është problemi i leksikut.

Me të vërtetë, në epokën tonë akoma janë të përhapura përkthimet dhe komentimet e disa fragmenteve, të cilat, me rastin e leximit, mund t'ju krijojnë shkencëtarëve një pasqyrë krejt të shtrembër të Shpalljes Kur'anore lidhur me temën në fjalë. Kështu pjesa më e madhe e përkthimeve evokon formimin e njeriut prej "mpiksjes së gjakut", "të ngjiturit". Një përshkrim i tillë është krejtësisht i papranueshëm për shkencëtarin e specializuar në këtë lëmi. Kurrë njeriu nuk ka pasur prejardhje të tillë. Në paragrafin që trajton vendosjen e vezës në mitrën e nënës do t'i shohim shkaqet përse njohësit e shkëlqyeshëm të arabishtes pa kulturë shkencore kanë bërë gabime të tilla.

Një konstatim i tillë na bën të mundur të mendojmë se si është me rëndësi të dorës së parë njohja e gjuhës dhe njohja e shkencës në mënyrë që të kuptohet domethënia e kuptimeve kur'anore mbi riprodhimin.

Kur'ani që në fillim thekson transformimet e vazhdueshme që i pëson embrioni deri na mbarim të shtatzanisë në mitrën e nënës.

"O ti njei po ç'të mashtroi ty kundrejt Zotit tënd që është bujar e i urtë? I cili të krijoi, të përsosi dhe të drejtoi. Të formësoi në formën që Ai dëshiroi." (S82 - A6-8)

"Nuk ka asnjë gjallesë në tokë dhe as shpendë që fluturojnë me dy krahë e që nuk i janë ndarë në grupe (të ndryshme), sikurse edhe ju (Zoti i krijoi i pajisi si juve). Asgjë nuk kemi lënë pasdore nga evidenca. Më në fund te Zoti i tyre do të tubohen." (S6 - A38)

"Kur Ai ju krijoi në disa etapa." (S71 - A14)

Përveç kësaj vërejtjeje tepër të përgjithshme, teksti kur'anor tërheq vëmendjen në shumë çështje që kanë të bëjnë me riprodhimin dhe duket se mund të sistemohet si vijon:

1 - Mbarësimi bëhet në saje të një sasive tepër të vogël të lëngut.

2 - Natyra e lëngut fekondues.

3 - Vendosja e vezës së fekonduar.

4 - Evolucioni i embrionit.

## 1. MBARËSIMI BËHET NË SAJË TË NJË SASIE TEPËR TË VOGËL TË LËNGUT

Njëmbëdhjet herë Kur'ani e përsërit këtë nocion, duke përdorur shprehje të tilla si vijon:

"E krijoi njeriun nga një pikël (uji)..." 80 (S 16 - A4).

Jemi të detyruar që fjalën arabe nutfat ta përkthejmë me fjalën pikë (spermë), pasi në frëngjishtë nuk ka fjalë plotësisht të përshtatshme. Duhet të themi se kjo fjalë rrjedh nga folja që do të thotë dridhet, pikon; ajo që shërben për të shënuar atë që mund ta zërë vedra pasi më parë e kemi zbrazur. Ajo, domethënë, shënon një sasi tepër të vogël të lëngut, nga ku rrjedh kuptimi dytësor i pikës së ujit, këtu pikë e spermës, sepse në një ajet tjetër fjala është e lidhur me fjalën spermë.

"A nuk ka qenë ai një pikë uji që derdhet?"<sup>81</sup> (S75 - A37).

Këtu fjala arabe maniyy tregon spermën. Një ajet tjetër tregon se pikë për të cilën bëhet fjalë është vendosur në vend të sigurt (quarar), që, shihet qartë, tregon organet gjenitale.

Zoti thotë: "Pastaj atë e bëmë pikë uji në një vend të sigurt" (S23 - A13).

Duhet thënë se cilësori i cili shpreh këtë vendosje të sigurtë (makín) mezi përkthehet. Ai shpreh kuptimin: i shkëlyeshëm, i lartësuar, vend i fortifikuar shumë mirë. Sido që të jetë, bëhet fjalë për vendin e rritjes së njeriut në organizmin e nënës. Por është posaçërisht me rëndësi ta theksojmë kuptimin e "sasisë tepër të vogël të lëngut" që është e nevojshme për fekondim, gjë që është plotësisht në përputhje me atë që e dimë në kohën tonë.

## 2. NATYRA E LËNGUT MBARËSUES

Kur'ani këtë lëng që e siguron mbarësimin e përmend me cilësorë të tillë që është interesant të studiohen:

a) "Sperma", siç e thamë pak më parë (S75 - A37)

b) "lëngu që hidhet": "Njeriu është krijuar prej lëngut që hidhet" (S86 - A6)

c) "lëng i keq" (S32 - A8; S77 - A20).

Cilësori i keq (mekin) si duket mund të interpretohet jo në aspektin e cilësisë së vetë lëngut, por para së gjithash në funksion të faktit se ai hidhet në fundin e aparatit urinar duke e huazuar kanalin nëpër të cilin del urina.

d) "Përzjerja" ose "ajo që është përzier" (amzâg): "Ne njeriun e krijojmë nga përzjerja e farërave..."<sup>82</sup> (S76 - A2).

Shumë komentues, si profesor Hamidullahu, në këtë përzjerje shohin elementin mashkullor dhe femëror. Kjo vlen edhe për shkrimtarët e dikurshëm të cilat nuk kanë mundur të kenë dijeni mbi fiziologjinë e mbarsjes, e sidomos për atë se cilat janë kushtet biologjike të saj te femra; ata kanë menduar se fjala evokon lidhjen e thjeshtë të dy elementeve.

Por komentuesit bashkëkohor, siç është ai i Muntahabit, të cilin e boton Këshilli i Lartë i Punëve Islamike në Kajro, e korrigjon këtë mënyrë të të menduarit dhe vëren se pika e spermës është "lidhje e elementeve të ndryshme". Komentuesi i Muntahabit nuk ndalet në hollësira, por, sipas mendimit tim vërejtja e tij është shumë e drejtë.

Cilat janë ato elemente të ndryshme të spermës?

Farat e lëngëta përbëhen nga sekrecione të ndryshme që prodhohen nga këto gjëndra:

a) testisët (sekrecione të gjëndrës seksuale mashkullore që përmban spermatozoidët, qeliza të zgjatura me bisht të gjatë që notojnë në lëngun ujor)

b) gjëndrat seminale: këto organe, rezervuarë të spermatozoideve, të vendosur afër prostatës, gjithashtu kanë sekrecionet e tyre pa elementë mbarësues

c) prostata: ajo sekreton një lëng e cila jep spermës një pamje kremi dhe aromë karakteristike

d) gjëndrat plotësuese të rrugëve urinare: gjëndrat e Coëperit ose të Mçryeut sekretojnë lëng të trashë kurse gjëndrat e Littreut sekretojnë jargë. E tillë është prejardhja e këtyre "përzjerjeve" për të

cilat flet Kur'ani. Por kjo nuk është e tëra. Kur Kur'ani flet për lëngun mbarësues ai na njeh me faktin që pasardhësit e njeriut janë të siguruar me diçka që mund të nxirret nga ky lëng. Ky është kuptimi i ajetit 8, surja 32: "...E (All-llahu) pasardhësit e tij (njeriut) i krijon prej thelbit të lëngut të keq"<sup>83</sup>.

Fjala arabe e cila këtu është përkthyer me "thelb", kvintesencia (sulâlat), domethënë lëndë e nxjerrë, që ka dalë nga ndonjë tjetër, pjesa më e mirë e një sendi. Sido që të jetë përkthyer bëhet fjalë për pjesën e një tërësie.

Ajo që e shkakton mbarësimin e vezës dhe e siguron riprodhimin është një qelizë me formë shumë të zgjatur, madhësia e së cilës shprehet me numra në përmasa prej 1/10.000 milimetra. Vetëm një element nga miliona të tilla që i hedh njeriu në kushte normale arrin të depërtojë në vezore<sup>84</sup>; një numër i madh do të ngelet rrugës dhe kurrë nuk do ta kalojë rrugën e cila shkon nga vagina deri në vezore, nëpër zbrazëtinë e mitrës dhe kanalet e vezores. Domethënë, një pjesë tepër e vogël e nxjerrë nga një lëng shumë kompleks, sa i përket përbërjes së vet do ta shprehë aktivitetin e vet.

Prandaj si të mos habitemi nga kjo përputhje e teksit kur'anor dhe njohurive shkencore që i kemi arritur mbi këto fenomene në epokën tonë.

### 3. VENDOSJA E VEZËS SË MBARËSUAR NË ORGANET GJENITALE FEMËRORE

Veza e cila është fekunduar në vezore zbret për t'u vendosur brenda mitrës: kjo quhet vendosje e vezës. Kur'ani e emëron mitrën ku vendoset veza e fekunduar:

"...Ndërsa atë që dëshirojmë ne e përqëndrojmë në mitër deri në një afat të caktuar..." (S22 - A5).

Përforcimi i vezës në mitër realizohet nga zhvillimi i vastakëve, zgjatime të vërteta të vezës, të cilat, si rrënjët në tokë, do të thithin nga gryka e këtij organi atë që është e nevojshme për rritjen e vezës. Këto prodhime e bëjnë që veza të ngjitet fort tek mitra. Njohja e tyre i takon kohës bashkëkohore.

Kjo ngjitje përmendet pesë herë në Kur'an. Së pari në dy ajetet e para të sures 96:

"Lexo, në emër të Zotit tënd, i cili krijon (çdo gjë). Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur (diçka që ngjitet)".

"Diçka që ngjitet" është përkthimi i fjalës "alak" ky është kuptimi i saj i parë. Kuptimi i nxjerrë nga ky, "mpiksje gjaku" haset shpesh nëpër përkthime: kjo është një pasaktësi për të cilën duhet tërhequr vërejtjen: njeriu nuk ka kaluar asnjëherë nëpër fazën e mpiksjes së gjakut. Po kjo vlen edhe për një përkthim të dytë: "përputhje". Kuptimi i parë ishte "diçka që ngjitet", që i përgjigjet në tërësi realitetit të vërtetuar mirë.

Ky kuptim rikujtohet në katër ajete të tjera, të cilat evokojnë transformimet e vazhdueshme nga faza e pikës së spermës e deri në fund të shtatzanisë.

"Ne ju krijojmë prej dheu, pastaj prej uji, pastaj prej një gjaku të ngjizur (diçka që ngjitet)..." (S22 - A5)

"Më pas, atë pikë uji e bëmë copë gjaku, e atë gjak të ngurtë e bëmë copë mishi, e atë copë mishi e shndërruam në eshtra, edhe eshtrave ua veshëm mishin, pastaj atë e bëmë krijesë tjetër (me shpirt). I lartë është Allahu, mëi miri Krijues." (S23 - A14)

"Ai (Allahu) është që ju krijoi juve (të parin tuaj) prej dheu, pastaj prej një gjaku të ngjizur (diçka që ngjitet), mandej ju bën të lindeni si foshnjë më vonë të arrini pjekurinë..." (S40 - A67)

"Anuk ka qenë ai një pikë uji që derdhet. E pastaj u bë gjak i trashë, e Ai e krijoi dhe epërsosi?" (S75 - A37,38)

Organi në të cilën zhvillohet shtatzania është shënuar në Kur'an, si e kemi parë, me fjalën që në arabishte gjithnjë përdoret për shënimin e mitrës. Në disa sure ai quhet "vend i sigurtë" (surja 23, ajeti 13 siç u citua më sipër, dhe surja 77, ajeti 21).

#### 4. EVOLUCIONI I EMBRIONIT NË BRENDEËSINË E MITRËS

Ashtu siç është përshkruar në Kur'an, ai i përgjigjet në mënyrë të përkryer asaj që ne dimë sot për disa etapa të zhvillimit të embrionit dhe nuk përmban asnjë argument që do të mund t'a kritikonte shkenca bashkëkohore.

Pas "diçka që ngjitet" (shprehje për të cilën pamë se deri në ç'masë është e bazuar), Kur'ani thotë se embrioni kalon nëpër fazën e mishit (mish i përtypur), pastaj zhvillohet indi ashtëror që është i mbështjellur me mish (i përkufizuar me fjalë të ndryshme nga fjala paraprake, e cila do të thotë mish i freskët).

"Më pas, atë pikë uji e bëmë copë gjkau , e atë gjak të ngurtë e bëmë copë mishi, e atë copë mishi e shndërruam në eshtra, edhe eshtrave ua veshëm mishin, pastaj atë e bëmë krijesë tjetër (me shpirt). I lartë është Allahu, më miri Krijues." (S23 - A14)

Mishi (si i përtypur) është përkthim i fjalës mudgat, mishi (si mish i freskët) është përkthim i fjalës lahm. Këtë dallim të saktë duhet ta theksojmë. Embrioni në fillim është masë e vogël që nuk shihet me sy dhe në një fazë të zhvillimit të tij duket si mish i përtypur. Sistemi skeletor (eshtror) zhvillohet brenda kësaj mase në atë që quhet mezenhim. Eshtrat e formuara janë të veshur me masë muskulore për to përdoret fjala lahm.

Dihet se gjatë zhvillimit të këtij embrioni disa pjesë duket krejt jo propocionale në krahasim me atë që më vonë do të jetë individ, kurse pjesët e tjera mbesin propocionale.

A thua ky nuk është kuptimi i fjalës muhal-lak që do të thotë "përpjestimisht i formuar", që është përdorur në ajetin 5 të sures 22 për ta evokuar këtë fenomen?

"Ne ju krijojmë... prej diçkaje që ngjitet... nga copa propocionale dhe jo propocionale e mishit..."87 (S22 - A5).

Kur'ani gjithashtu evokon fenomenin e shqisave dhe të barkut:

"edhe Ai është që ju pais me dëgjim, me të parët eme zemër, e pak send është ajoqë ju falenderoni." (S32 - A9).

Ai bën aluzion në formimin e gjinisë.

"Dhe Ai është që krijoi llojet- mashkullin dhe femrën. Nga pika e farës që hidhet." (S53 - A45,46).

Formimi i gjinisë (seksit) është evokuar edhe në suren 35, ajeti 11 dhe në suren 75, ajeti 39. Kemi thënë se të gjithë këto argumente të Kur'anit duhet të krahasohen me njohuritë e vërtetuara në kohën bashkëkohore: përputhja e tyre më këtë është e qartë. Por është gjithashtu shunmë e rëndësishme t'i krahasojmë me besimet e

përgjithshme të zakonshme për këtë lëndë që kanë qenë në kohën e Shpalljes së Kur'anit, në mënyrë që ta kuptojmë deri në ç'masë njerëzit e asaj kohë kanë qenë larg asaj që për këto probleme të kenë pikëpamje të ngjashme me këto të shrehura në Kur'an. Nuk ka dyshim se ata atëherë nuk kanë ditur të interpretojnë këtë Shpallje si e kuptojmë ne sot, sepse neve na ndihmojnë njohuritë e shkencës së sotme bashkëkohore. Në të vërtetë vetëm gjatë shekullit XIX do të krijohet një mendim më i qartë lidhur me këto çështje.

Gjatë tërë mesjetës mitet dhe spekulimet e pabaza kishin zënë vend në themelin e doktrinave nga më të shumëllojshmet: ato kanë qenë në qarkullim edhe disa shekuj më vonë. A thua dihet se etapa bazë në historinë e embriologjisë ka qenë pohimi i Harvejit, më 1651, që "çdo gjë e gjallë vjen nga veza" dhe se embrioni formohet gradualisht, pjesë-pjesë? Por, në këtë epokë, në të cilën shkencë që po lindte ka shfrytëzuar zbulimin e vonshëm të mikroskopit për çështjen për të cilën po bëhet fjalë, edhe më tej është diskutuar mbi rolet reciproke të vezëve dhe spermatozoidëve. Natyralisti i madh Bufoni i ka takuar klanit të ovistëve, ndër të cilët Bonneti ka përkrahur teorinë mbi futjen e embrionit: kështu vezorja e Evës, nënës së gjinisë njerëzore, i ka përmbajtur farët e të gjitha qënieve të gjalla, të futura njëra me tjetrën. Kjo hipotezë ka arritur një farë autoriteti në shekullin XVII.

Më shumë se një mijëveçar para kësaj epoke, në të cilën kanë qenë në qarkullim doktrina fantazioze, njerëzit e njohën Kur'anin. Argumentet e tij mbi riprodhimin njerëzor janë shprehur me terma të thjeshta të njohurive bazë, për zbulimin e të cilave njerëzve do t'u duhej aq shekuj.

## KUR'ANI DHE EDUKIMI

### SEKSUAL

Epoka jonë beson se ka bërë shumë zbulime në të gjitha fushat. Ajo konsideron se ka sjellë risi në lëndën e edukimit seksual dhe mendon se hapja e të rinjve ndaj problemeve të jetës është sukses i botës bashkëkohore, meqë shekujt e kaluar, në këtë pikëpamje, kanë qenë të njohur për terrin e madh në të cilin kanë qenë, e për të cilin shumë veta thonë se janë përgjegjëse fetë, pa e preçizuar cili.

Mirëpo krejt atë që kemi thënë paraqet dëshmi se para 14 shekujsh,



çështjet teorike, nëse mund të thuhet kështu, që i takojnë riprodhimit njerëzor, kanë qenë pjesë e njohurisë njerëzore aq sa ka qenë e mundur një gjë e tillë, duke pasur parasysh se nuk ka pasur të dhëna anatomike dhe fiziologjike që do t'i bënin të mundshme shqyrtimet më të gjera, prandaj për shkak të kuptimit është dashur të përdoret një gjuhë e thjeshtë që i është përshtatur kapacitetit të të kuptuarit nga dëgjuesit e predikimit.

As aspektet praktike nuk janë heshtur. Në Kur'an ka shumë hollësira mbi jetën praktike në përgjithësi, mbi sjelljet që duhet të kenë njerëzit në shumë raste të jetës së tyre. Nuk është lënë anash as jeta seksuale.

Dy ajete në Kur'an i përkasin marrëdhënieve seksuale në kuptimin e plotë të fjalës. Këto janë evokuar me shprehjet që lidhin dëshirën për saktësi me pastërtinë e domosdoshme. Kur e bëjmë përkthimin e tyre dhe komentimet shpjeguese, habitemi me ndryshimin në mes tyre. Një kohë të gjatë isha në mëdyshje rreth përkthimit të këtyre ajeteve. Këtë që po e propozoj ja kam borxh doktor A. K. Giraud, profesorit të dikurshëm të Fakultetit të Mjeksisë në Bejrut.

"(Njeriu) është krijuar prej lëngut i cili hudhet nga lidhja e pjesëve të jashtme të trupit të mashkullit dhe të femrës"88. (S86 - A6,7).

Zona seksuale e trupit të njeriut është shënuar në tekstin e Kur'anit me fjalën sulb (njëjës). Zona seksuale e femrës është shënuar në Kur'an me fjalën tarâib (shumës).

Ky përkthim i cili më duket se është më i ploti. Ky ndryshon prej përkthimeve të përkthyesve francezë dhe anglezë, si: "(Njeriu) është krijuar nga lëngu që hudhet - që del ndërmjet boshtit kurrizor dhe gjoksit". Ky, më duket, më shumë është një variant e shpjegimit, se sa përkthim. Ky në fund të fundit, është pak i kuptueshëm.

Sjellja e njerëzve në marrëdhëniet e tyre intime me gratë në raste të ndryshme është shprehur qartë.

Më parë jepet udhëzimi për periodën e të përmuajshmeve, në ajetet 222 dhe 223 të sures 2; All-llahu ia jep këtë urdhër të Dërguarit:

"Të pyesin ty për menstruacionin (haidin). Thuaj: " Ajo është gjendje e neveritur, andaj largohuni prej grave gjatë menstruacionit dhe mos iu afroni atyre (për marrëdhënie) derisa të pastrohen. E kur të pastrohen, atëherë afrohuni atyre ashtu siç ka lejuar Allahu. Allahu i do ata që pendohen dhe ata që ruhen prej punëve të ndyta e

të neveritëshme." (S2 - A222)

"Gratë tuaja janë si arat tuaja, dhe arat tuaja lëvroni si të doni, para së gjithash përgatituni ju vetë"89. (S2 - A223)

Fillimi i fragmentit ka domethënie shumë të qartë: formalisht janë të ndaluara mardhëniet seksuale me gruan që ka menstruacione. Pjesa e dytë evokon lëvrimin që për mbjellësin është punë paraprake për hedhjen e farës, e cila do të mbijë dhe do të nxjerrë bimë të re. Këtu nëpërmjet figurës është theksuar në mënyrë indirekte se është me rëndësi të kihet ndër mend qëllimi i fundit i mardhënies seksuale: rikrijimi. Përkthimi i fjalisë së fundit është marrë prej Blansherit: ajo përmban urdhrin që me sa duket ka të bëjë me parapërgatitjet për mardhënie seksuale.

Udhëzimet që janë dhënë këtu janë shumë të përgjithsuara. Rreth këtyre ajeteve është ngritur problemi i kontracepcionit: as këtu, as edhe në ndonjë vend tjetër, Kur'ani nuk aludon në të.

As aborti nuk evokohet, por shumë fragmente mbi transformimet e vazhdueshme të embrionit, që i kemi cekur më sipër, janë mjaft të qarta që njeriun ta konsiderojmë të krijuar që në fazën e "diçka që ngjitet". Në këto kushte, respektimi absoluti personit të njeriut, gjë që në Kur'an bëhet shpesh, ka për pasojë dënimin radikal të abortit. Kjo është, në fund të fundit, pikëpamje e të gjitha religjioneve monteiste në epokën tonë.

Gjatë muajit të agjërimit të ramazanit mardhëniet seksuale janë të lejuara të kryhen natës. Ajeti që i përket ramazanit është si më poshtë:

"Natën e agjërimit u është lejuar afrimi te gratë tuaja, ato janë prehje për ju dhe ju jeni prhje për ato... Tash e tutje bashkohuni me to dhe kërkoi atë që ua ka caktuar Allahu..." (S2 - A187)

Përkundër kësaj, nuk ka kurrëfarë përjashtimi për haxhinjtë në Mekë gjatë ditëve festive të haxhit.

"... ekush e bën (ta filloi të zbatojë) haxhin në këta muaj, nuk duhet afruar gruas..." (S2 - A197)

gjatë kësaj kohe ndalimi është formal, ashtu siç janë edhe ndalimet

e tjera: gjuetia grindjet etj.

Menstrucioni është evokuar në Kur'an edhe me rastin e ndarjes (shkurorëzimit). Libri shprehet kështu:

"E ato gratë tuajatë cilave u është ndërprerë cikli mujor (menstrucioni) nëse nuk e ditur, koha e pritjes së tyre është tre muaj, e ashtu edhe ato që ende nuk kanë pasur menstruacion. Ndërkaq për shtatzënat afati i pritjes së tyre është derisa të lindin. E kush i frikësohet Allahut, Ai atij ia lehtëson punët." (S65 A4)

Koha e pritjes për të cilën bëhet fjalë është koha prej paralajmërimit të ndarjes (shkurorëzimit) deri në çastin kur ky bëhet i plotëfuqishëm. Gratë për të cilat thuhet se "e kanë humbur shpresën për pastrim mujor" kanë arritur deri në menopauzë. Për ato është paraparë shtyrja e kuptueshme prej tre muajsh. Pas kësaj, këto gra mund të martohen përsëri.

Gratë që nuk kanë pasur ende të përmuajshme, duhet ta presin kohën e shtatzanisë. Për gratë shtatzëna, ndarja është e plotëfuqishme vetëm pas mbarimit të shtatzënisë.

Të gjitha këto dispozita janë në përputhje të përkryer me të dhënat fiziologjike. Përveç kësaj, në Kur'an mund të gjenden - në tekstet që e rregullojnë vejërinë - dispozita ligjore të njëjta dhe të kuptueshme.

Edhe në argumentet teorike të riprodhimit të njerëzimit, si edhe në udhëzimet praktike që janë formuluar mbi jetën seksuale të çifteve, vërejmë se asnjë formulim që e kemi paraqitur këtu nuk është në kundërshtim me njohuritë bashkëkohore, as me çfarëdo qoftë tjetër që mund të rrjedhë logjikisht nga ato.

TREGIME KUR'ANORE DHE BIBLIKE

## I.

### PASQYRA E PËRGJITHSHME

Në Kur'an ka një numër të kosiderueshëm temash, të cilat janë shënuar më përpara në Bibël. Këto janë, para së gjithash, tregime mbi profetët: Nuhun(Noa), Ibrahimin( Abrahamin), Jusufin (Josifin), Iliasin (Ilian), Junusin (Jonas), Ejjubin (Job), Musain (Moisiun); mbi mretërit e Izraelit, si : Shaulin, Davudin (Davidin), Sulejmanin (Solomon), t'i përmendim vetëm tregimet kryesore të përbashkëta mbi mbretërit e Izraelit, duke lënë anash ato që nuk thonë asgjë më shumë vetëm se kujtojnë. Këtu hyjnë, gjithashtu tregimet edhe më specifike mbi ngjarjet e mëdha të mbinatyrshme, siç janë p.sh krijimi i tokës dhe i qiellit, krijimi i njeriut, Përmbytja, Dalja e Musait. Këtu është edhe gjithë ajo që ka të bëjë me Isanë (Jezusin), me nënën e tij Mejremen (Marien), kur është fjala për Besëlidhjen e Re.

Në çfarë mendimesh mund të na cysin temat që janë trajtuar në dy Shkrimet në funksion të njohurive bashkëkohore, te të cilat mund të arrihet krahas teksteve të shenjta?

### PARALELJA KUR'AN - UNGJIJTË

### DHE NJOHURITË BASHKËKOHORE

Kur është fjala për paralelen Kur'ani - Ungjijtë, së pari duhet të themi se anjëra nga temat e Ungjijve që janë kritikuar në pikëpamje shkencore - e që i kemi përmendur në pjesën e dytë të këtij libri - nuk është shënuar në Kur'an.

Isai a.s., në Kur'an është objekt i shumë referencave. Këto për shembull, janë: paralajmërimi që i bëhet babait të Mejremes për lindjen e saj, paralajmërimi i Mejremes për lindjen e çuditshme të Isait a.s., natyra e Isait a.s., profetit të nivelit më të lartë, cilësitë e tij prej Mesiu (Mesiha), Shpallja , të cilën ua drejtoi njerëzve duke e vërtetuar dhe përshtatur Teuratin (Torën), predikimi i tij, nxënësit e

tij apostuj, çuditë, ngritja e tij definitive tek All-llahu, roli i tij në Ditën e Gjykimit etj.

Surja 3 dhe 19 në Kur'an (që mban emrin Mejreme) i kushton pjesë të gjatë familjes së Isait a.s. Ato tregojnë për lindjen e nënës së tij, Mejremes, për rininë e saj, për paralajmërimin e Mejremes për mëmësinë e çuditshme të saj, Isai a.s. quhet "Biri i Mejremes", kurse fillimi i brezit të tij është dhënë në lidhje qenësore me nënën e tij, gjë që është logjikisht e përkryer, pasi që Isai a.s. nuk kishte baba biologjik. Kur'ani ketu nuk pajtohet me Ungjijtë sipas Mateut dhe Lukës, të cilët siç e kemi treguar, kanë dhënë pasardhës meshkuj.

Sipas gjinisë së nënës, Isai a.s. në Kur'an është futur ndër pasardhësit e Nuhut, Ibrahimit dhe të babës së Mejremes ( Imran në Kur'an):

"All-llahu e zgjodhi (pejgamber) Ademin, Nahun, familjen e Ibrahimit, familjen e Imranit mbi popujt e tjerë (të asaj kohe). Që janë pasardhës të njëri tjetrit. All-llahu dëgjon gjithçka dhe i di të gjitha. (S3 - A33-34)

Kështu Isai a.s. është pasardhës i Nuhut dhe i Ibrahimit nga nëna, Mejremja, dhe nga babai i saj, Imrani.

Në Kur'an nuk janë shënuar gabimet nominale të Ungjijve që kanë të bëjnë me fisin e Jezusit (Isait a.s.), me pamundësinë e renditjes gjenealogjike nga Besëlidhja e vjetër, kur është fjala për fisin e Abrahamit (Ibrahimit), që e kemi shqyrtuar në pjesën e parë dhe të dytë.